

YMER
MINXHOZI

NASTRADINI NË JERUSALEM

satirë



8SH-77

M 78

Ymer
Minxhozi

NASTRADINI
NË
JERUSALEM

satirë

33967

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»



MINISTRI I DREJTËSISË

E martë, ora 9

E para e dha alarmin sekretarja Azula. Ajo u fut me nxitim në zyrën e padronit të saj Ugo Eksi.

— O tmerr! E rrëmbyen Merin, zotëri!

— Cilën Meri, moj?

— Vajzën tuaj, zotëri!

— Kush?... Kur?...

— Tani njoftuan. Sapo doli në rrugë, dy njerëz me maska në fytyrë e futën në automobil dhe u zhdukën. Shërbyesja Dundo ka rënë pa ndjenja në trotuar. Bobo, të shkretët ne! Policinë, zotëri, njoftoni policinë!

Sekretares i merrej fryma dhe qe bërë dyllë e verdhë në fytyrë.

Eksi, i tronditur, u ngrit nga karrigia, mori telefonin dhe kërkoi shefin e policisë kriminale.

— Alo! Policia? Jam unë, Eksi. Po, po, ai vetë. Dua direkt shefin tuaj. S'është?! Ku djallin qenka?! Dëgjo këtu! Sapo më grabitën vajzën. Kush? Atë duhet ta dini ju. Si quhen grabitësit?!... Ç'thoni, more?!... Në djall vajtën, unë prandaj ju mora, se nuk e di kush janë e nga shkuan... Meri e quajnë, 8 vjeçe. Ju thashë një herë, sapo e grabitën. Me dadon e vet qe. Asgjë s'di. Nuk i kam unë listat e kriminelëve, atë i njihni ju...

Ai lëshoi receptorin dhe vajti u përplas në kolltuk.

— Këta janë maskarenj, më pyesin mua se kush qenë, nga ishin, ku shkuan.

Eksi gulçoi duke marrë frymë me zor. Koka i varej në gjoks dhe duart i dridheshin.

— Tonikun! — urdhëroi me gjysmë zëri.

Sekretarja i solli me të shpejtë paketën me pluhurin në ngjyrë të verdhë. Ndjeu se në rremba iu derdh një rrymë e vrullshme dhe gjaku i vërshoi në faqe. Po e merrte veten, se po bëhej i aftë të sulmonte, por hovin e tij e ndërpreu zilja e telefonit. Në anën tjetër dëgjohej një zë i ngjirur dhe i ndryshuar:

— Ti je gërdalla Ugo Eksi? Po? Dëgjo këtu dhe mos më ndërprit. Në qoftë se dëshiron ta shohësh edhe një herë të gjallë vajzën tënde, atëherë sonte, në orën njëzet e katër zero zero, kalo në autostradën numër tre, vetëm, natyrisht, dhe ndalo në kilometrin njëzet e katër. Në të djathtë është një reklamë e firmës «ESSO». Aty ke për të hedhur një çantë, nga ato të nxënësve të shkollave, me tre milionë dollarë në të. Do të

ecësh edhe dy kilometra dhe do të ndalosh te restoranti «Kënaqësia». Aty do ta gjesh vajzën tënde të dashur. Të paralajmëroj se, po njoftove policinë ose ndonjë person tjetër, Merin tënd nuk do ta shohësh kurrë më. Gudbaj!

Zëri, një zë i çjerrë, në anën tjetër të telefonit, u zhduk, ndërsa Ugo Eksi qëndroi edhe për disa çaste me receptorin te veshi, i ngrirë dhe pa ditur ç'të thoshte. Tre milionë! Bashkëpronari i gazetës më të madhe të vendit, bashkëpronari i kantierit të ndërtimit të anijeve dhe i dy uzinave për prodhimin e kuzhinëve, kandidat për guvernator në zgjedhjet e ardhshme, u dashka t'u bindet disa të panjohurve dhe të hedhë tre milionë në mes të rrugës, si hedhim një bisht cigareje. Lëshoi dorezën e telefonit mbi tryezë dhe vajti e u përplas përsëri në kolltuk. Doreza e telefonit lëshoi një krismë të thatë kur ra mbi xhamin e tryezës dhe sekretarja, që ishte larguar në dhomën përballë, u kthye e tmerruar, duke pandehur se pronari i saj ia hoqi vetes me revole.

— Ugo!

Eksi kishte mbyllur sytë. Duart i vareshin në të dyja anët e kolltukut. Tani atij i kishin ikur impulset që i dha paketa me pluhurin e verdhë dhe kishte rënë në atë gjendje që quhet as gjallë, as vdekur.

— Ugo!

— Tre milionë, Azula!

Këto fjalë ai i nxori me vështirësi dhe iu duk se dikush po e godiste në kokë.

— Kurajë, i dashur! Çdo gjë do të rregullohet. Meri do të kthehet përsëri.

— Tre milionë! — belbëzoi Eksi me buzët e zbardhura.

— Duhet vepruar shpejt, i dashur, nuk i dihet

kësaj pune, merr përsëri në telefon, kushedi,
— e këshilloi sekretarja.

Ugoja tani nuk dëgjonte asnjë fjalë.

E mërkurë, ora 2 e mëngjesit

Ugo Eksi u kthye në shtëpi bashkë me të bijën, Merin. Dadajo Dundo e priti atë në hyrjen e jashtme me ulërima. Përsëri fatkeqësi! Gjatë mungesës së tij, në shtëpi ishte futur një bandit me maskë dhe kishte rrëmbyer djalin gjashtëvjeçar, Luisin. Banditi kishte lënë këtë copë letër për zotin Ugo:

Gomarit me zile, Ugo Eksi! Mos kujto se u shpëtove thonjve të mi. Akoma kam punë me ty. Në qoftë se e do fort djalin tënd dhe dëshiron të të kthehet shëndoshë e mirë, sot në orën dy-mbëdhjetë të ditës kalo me automobil nëpër autostradën numër një, i vetëm, natyrisht, dhe në kilometrin pesëdhjetë e tre, pa e pakësuar shpejtësinë, do të hedhësh një valixhe të zezë me tre milionë dollarë brenda. Në kilometrin pesëdhjetë, fiks në orën trembëdhjetë, do të ndalosh për t'u furnizuar me benzinë. Aty do të gjesh edhe një veturë tjetër që do t'ju japë shenjë. Do të ecësh pas saj derisa të ndalet te një parullë e madhe «Shell». Aty bashkudhëtari do t'ju takojë me djalin. Paralajmërojmë se çdo gjë duhet të mbetet midis nesh. Po qe se vihet re lëvizja më e vogël e dyshimtë në vendet e caktuara, pasojat do të jenë siç i di vetë. Kaq. Gudbaj!

— Të njoftojmë policinë? — pyeti dadoja me zë të dridhur e duart të kryqëzuara në gjoks.

— Në djall me gjithë policinë! — gërthiti Eksi. — O perëndi! Përsëri tre milionë! Edhe vetë banka e Morganit po të isha... Po, këtij i

thonë falimentim, i thonë nënshtrim, i thonë fund!

Meri, që sapo ishte liruar nga banditët, ishte strukur te dadoja Dundo dhe s'po kuptonte se çfarë ndodhte. Eksi pa orën dhe thirri:

— Telefonin!

Sakaq shërbyesja solli telefonin nga salloni në dhomën e gjumit. Kordoni i gjatë e ndoqi pas si një gjarpër uji.

— Jo, nuk më duhet! Është tepër vonë...

Në orën dymbëdhjetë të ditës Eksi kaloi nëpër autostradën numër një, lëshoi valixhen me tre milion dollarët në kilometrin pesëdhjetë e tre, pa e pakësuar shpejtësinë e makinës, dhe fiks në orën trembëdhjetë u ndal në kilometrin pesëdhjetë. Gjithçka eci sipas grafikut dhe ai u kthye në shtëpi së bashku me djalin gjashtëvjeçar.

Pas një dite e një nate kaq të bujshme, u ul përsëri në kolltukun e tij të thellë të veshur me lëkurë ngjyrëkafe. Ai e ndjeu veten të dërrmuar, por jo të mundur. Deri atëherë në këshillin e drejtorëve të korporatës së tij Ugo Eksi kishte pasur votën vendimtare, ndërsa tani ai ishte pretendent pa gjashtë milionë dhe në plan të parë dilte partneri tjetër, Benjamin Talmone. Eksi tani ishte i detyruar t'i nënshtrohej partnerit të tij, sa herë të shtroheshin probleme në këshillin e drejtorëve, ku votat ndahen sipas rezervave bankare të secilit. «Po, — mërmëriti — zgjedhjet e ardhshme! Unë humb paratë, duke bërë pazar me grabitësit, ndërsa të tjerët... Me gjashtë milionë mund të isha bërë gjashtë herë ministër apo guvernator, ndërsa nga ky çast, Benjamin Talmones i hapet rruga drejt majës së piramidës...».

— Marie! Telefonin!

Shërbyesja solli përsëri telefonin me atë kordonin që zvarritej si gjarpër.

— Alo, Hans?... Po, unë jam. Kam nevojë për ty.

Pas dy orësh, Ugo Eksi me mikun e tij të vjetër Hans Lupo, ministër i Drejtësisë që prej një viti, u ulën për të ngrënë drekë. Ministri, një mesoburrë shulak e këmbëshkurtër, kishte një fytyrë të akullt që nuk mbahet mend kollaj, sepse nuk kishte asnjë shprehje apo tipar të veçantë. Sytë e tij, të futur thellë, ishin melankolikë dhe të shqetësuar, e qeshura e tij fillonte dhe mbaronte te buzët, pa arritur të përhapej në pjesët e tjera të fytyrës.

Eksi vështroi tryezat përreth dhe pastaj i pëshpëriti mikut të tij:

— E more vesh?

— Më erdhi shumë keq.

— Tani e ke radhën ti.

— Nga e di ti?

— Jo, jo, të më ndihmosh.

— Janë tepër të fshehtë djajtë. Nuk futen në kurth. Kanë organizim të tmerrshëm. Nuk i kap dot.

— Dëgjo, ka ardhur çasti të bësh diçka për mua, sepse... pa mua ti nuk do ta shihje as me binokël kolltukun e ministrit. Të mos ishte gazeta ime, ato historitë e tua me baletin e gjelbër nuk do të kishin përfunduar mirë... Apo jo?

— Ashtu është. Për këto të jam mirënjohës.

— Sot nuk më duhet mirënjohja, por duhet t'i japësh një goditje të paqme partnerit tim, Beniaminit, i cili tani është kthyer në kundërshtar. Kupton?

— Kundërshtar? Ju jeni bashkëpronarë...

— Pikërisht, pse jemi bashkëpronarë, jemi

dhe kundërshtarë. Ai tani del mbi mua. Gjashtë milionët e mi shkuan e vanë. Tani Talmonia do të më trajtojë si një varfanjak. Kupton?

— E çfarë duhet të bëj?

— Atë që do të të them unë.

Ugoja vështroi përsëri rreth tryezave më të afërta.

— E kishe porositur më parë këtë tavolinë, apo e zure tani? — e pyeti ministri i Drejtësisë.

— Jo, e zgjodha tani, krejt rastësisht.

— Atëherë fol! Tavolinat e porositura më parë nuk më pëlqejnë, zakonisht ato kanë tartabiqe... Po të dëgjoj.

Ugo Eksi çoi dorën te mjekra dhe e uli zërin aq shumë, sa bashkëbiseduesi i tij mezi po e ndiqte.

— Për djalin e tij të vetëm, trashëgimtarin e pasurisë, Talmoni është gati të paguajë të paktën dhjetë milionë dollarë. Kupton? Ke mundësi të organizosh marrjen e këtyre dhjetë milioneve?

— Unë?!

— Sigurisht ti, jo unë. Ti me djemtë e tu... Apo tani që u bërë ministër ke hequr dorë...

— Natyrisht.

— Mos m'i shit mua ato. Ne njihemi bashkë prej kohësh.

Hans Lupoja heshti, ndërsa miku i tij i vjetër nuk ia ndante sytë, sikur të përpiquej ta hipnotizonte.

— Thuhet se ai Beniamini e ka kthyer shtëpinë në kështjellë dhe djalin e ruan me tre veta të armatosur, — tha nëpër dhëmbë ministri Lupo.

— Shtigjet t'i gjej unë, — ia ktheu Eksi.

E premte, mëngjes

Të gjitha gazetat e vendit, në faqe të para e me shkronja të mëdha, botuan lajmin e bujshëm për grabitjen e djalit njëzetetrevjeçar të industrialistit Benjamin Talmone, ndërsa po kthehej nga vila e tij verore. «Në kohën e ngjarjes, thuhej në njërin nga këto njoftime, vetë Talmonia kishte qenë për drekë te kolegu dhe partneri i tij Ugo Eksi. Numri i grabitësve nuk dihet, por dihet se tri rojat personale të Alen Talmones u zhdukën njëkohësisht. Në vendin e ngjarjes grabitësit lanë një letër, ku kërkohen dhjetë milionë dollarë për lirimin e pengut. Ata kanë dhënë një afat prej njëzet e katër orësh. Në letër shkruhet tekstualisht: « Nëse sonte në darkë nuk paguhen dhjetë milionët, jo vetëm do ta zhdukim 23-vjeçarin Alen, por veshët dhe hundët e tij do t'i dërgojmë të atit në zarf, me postë!» Është e papërfytyrueshme, — vazhdonte njoftimi në gazetë, — që i ati ta durojë një gjë të tillë. Në këto raste është më mirë të paguash për lirimin e fëmijës sesa t'i harxhosh paratë për të blerë rroba të zeza. Hëpërhë vetëm kaq mund të thuhet. Nesër do t'i japim lexuesit hollësira më të plota.»

E diel, ora 20

— E po, shëndet e punë të mbarë, djema! — thirri Hans Lupoja duke ngritur gotën. — Një javë me të vërtetë e mbarë. Gjashtëmbëdhjetë milionë me tri të qëlluara! Mos harroni se kësaj radhe i duhet dhënë diçka edhe zotit Eksi. I morëm gjashtë, t'i kthejmë një, apo jo? Si thua ti, Santa Barbara?

— Ju jeni ministri i Drejtësisë, zoti Lupo, më mirë se ju nuk e di askush drejtësinë, — u përgjigj ai që thirrej Santa Barbara dhe që kishte marrë pjesë në të tria grabitjet e javës.

— Çështë e vërteta, zoti Eksi u tregua mjaft i sjellshëm me ne. Tani bëni llogarinë, Dingo, — urdhëroi ministri i Drejtësisë.

SHPREHJA E SIMPATISË

Për zotin Sebastian Krap tregonin historira të çuditshme. Bile dikush thoshte se të vish në Mafoni e të mos takosh zotin Krap është një humbje e vërtetë. Fama i kishte ardhur jo nga bëmat e tij, por, në të kundërt, ngaqë ai nuk kishte bërë asgjë për njëzet vjet me radhë. Vetëm kishte fjetur!

Krapi kishte qenë pronar i një pijetoreje në afërsitë e një porti ushtarak dhe nuk ankohej kurrë për mungesë klientësh. Gjysmën e kohës rrinte i dehur. Në sytë e tij të vagëlluar gjithçka lundronte si në një gjysmëmjegull. Ndaj një ditë pranvere të vitit 1940, pikërisht në çastin kur vendi i tij hyri në Luftën e Dytë Botërore, pronari i pijetores mbeti i plagosur rëndë. Shumë autorë artikujsh e kujtimeve për operacionet ushtarake të Mafonisë thanë se Krapi ishte i plagosuri i parë i vendit në këtë luftë, megjithëse u plagos jo në front, por në birrarinë e tij. Ngaqë iu morën këmbët, shkoi e përplasi kokën në qoshen e banakut dhe ra pa ndjenja.

Ndoshta kjo ngjarje nuk do të kishte hyrë në histori, sikur të mos kishte ndodhur pikërisht në çastin kur klientët e tij ushtarë vunë këmbën në një vend të huaj. Është kjo rastësi që i shtyu autorët e kujtimeve të luftës të thonë se Krapi

është i plagosuri i parë i vendit të tij. Krapin e shtruan menjëherë në spital, dhe ai nuk arriti të mësonte se lufta kishte filluar. Ai ra në atë që quhet gjumë letargjik. Mjekët thanë se kanë të bëjnë me një rast të rrallë dhe ky mendim me kalimin e viteve u përforcohej. I sëmurë i tyre merrte frymë, hante, po nuk përmendej. Kjo gjendje zgjati plot njëzet vjet, gjë që u dha mjaft kohë disa mjekëve të përgatiten dhe të mbrojnë teza të reja shkencore rreth gjumit letargjik. Një ditë shtatori të vitit 1960 Krapa lëvizti nga vendi, hapi sytë, shtriu duart e këmbët dhe nxori fjalët e para:

— Ku është Maria?

Të gjithë sa ishin aty vështruan njëri-tjetrin në sy. Kush ishte kjo Marie? Përse atij iu kujtua pikërisht ky emër? Dhe vetëm pas shumë kërkimesh u sqarua se Maria kishte qenë njëra nga kamerieret më për zemër të pronarit të pijetores, por tani kishte kaluar kohë e gjatë dhe kurrkush nuk e dinte se ku ndodhej ajo. E vetmja mikeshë e tij, që kishte mbetur akoma, ishte e shoqja. Sebastiani vështroi si nëpër tym Sofien e tij dhe tha me keqardhje:

— Sa qenke plakur brenda një dite, moj e mjerë!

Mjekët ranë përsëri në hall. Asnjëri nuk guxonte t'i thoshte të sëmurit se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë me të, sepse kishin frikë se nga emocionet ai do të kalonte përsëri në gjumin letargjik. Kështu Krapa nuk arriti ta mësonte menjëherë ç'i kishte ndodhur gjatë atyre njëzet vjetve. Megjithatë, ata e ndienin se kjo s'mund të mbahej e fshehur për një kohë të gjatë, sepse një ditë ai do të dilte në rrugë dhe... gjithçka do ta mësonte nga të tjerët. Prandaj

si mjekët, ashtu edhe Sofia, ishin tepër të shqetësuar.

Dhe ja, më në fund, një ditë Sebastiani u çua dhe doli në rrugë. Gruaja dhe mjekët prisnin me ankth kthimin e tij, prandaj, kur ai u duk te dera e pijetores, të gjithë mbajtën zemrën me dorë. «Tani do të ndodhë katastrofa, ai do të rrëzohet përtokë dhe fati i tij s'dihet.»

Mirëpo asgjë dramatike nuk ndodhi. Fytyra e ish-pronarit të pijetores shkëlqente. Gjithçka dukej në rregull. Ai ngriti dorën përpjetë me përshëndetjen e dikurshme dhe thirri:

— Sa kohë e bukur. Mua po më emocionon me të vërtetë ky tension ushtarak.

Ai mori e ndezi një cigare dhe u kthye nga ata që e prisnin:

— Eh, zotërinj, megjithëse Lufta e Dytë Botërore ende s'ka filluar, gjithçka duket se është gati për zjarr. Asnjë fije frike s'duhet të kemi, unë i pashë me sytë e mi, ne kemi ushtarë trima e të fortë, ata duken më mirë se asnjëherë tjetër, marshojnë për mrekulli, tanke e topa me bollëk. E çfarë tankesh se! Krejt të reja, bile unë nuk i kisha parë ndonjëherë deri më sot. Kjo është një mrekulli!

— Krapa vazhdon të mos e dijë të vërtetën?
— pyeta njërin nga gazetarët që kisha pranë.

I panjohuri u kthye nga unë me mirësjellje dhe u tregua i gatshëm të më jepte shpjegimet e nevojshme:

— Jo. Nuk dëshiron ta mësojë atë në asnjë mënyrë. Është provuar disa herë t'i thuhet se çfarë ka ndodhur, se Lufta e Dytë Botërore është bërë e ka mbaruar prej kohësh, por ai ngulmon në të tijën. Jo, thotë, po të ishte bërë Lufta e Dytë Botërore, gjithçka do të kishte

ndryshuar, ndërsa unë shoh po ata njerëz, po atë atmosferë. Këtu qëndron edhe fama e tij, bile dikush thotë gjenialiteti i tij. Sa veta në këtë botë kanë rënë ose gjenden në gjumin letargjik dhe historia nuk i ka marrë në gjirin e saj, nuk i ka përfillur fare! Ndërsa me zotin Krap puna qëndron krejt ndryshe. Ai vazhdon t'i mbetet besnik gjumit të tij, po njëkohësisht të merret edhe me punë shumë të dobishme e mjaft delikate, që kanë të bëjnë me përsosjen e shoqërisë në të cilën jeton.

Meqenëse Krapin e kisha përpara syve, tregimet për të më dukeshin të pabesueshme. Me fytyrë të fishkur, tërë rrudha, mollëzat e dala si të enjtura, me atë pamje të verdhë e të tejudkshme të lëkurës dhe flokët të ngjyer në bojë gështenje, me supin e djathtë të varur për shkak të tri brinjëve të hequra, me ata sy të vegjël e të lëvizshëm si të miut, ai të krijonte përshtypjen e një qenie anemike që ka ndenjur një kohë të gjatë në mjedise të mbyllura.

Ai hyri në sallë me atë hap të shpejtë që tregonte dëshirë të madhe për të dalë para publikut. Lëvizjet e tij të prera e të llogaritura mirë, buzët e holla e të rrudhosura, mustaqet e vogla e si të dyllosura, hareja e shtirë që i ndehej në fytyrë, si kozmetika mbi fytyrat e grave të moshuara, gjithçka fliste për një njeri nervoz. Në fillim ai la të endej nëpër sallë shikimin e syve të tij të vegjël e të rreptë, nën të cilët vareshin ca qeska të fryra, e këtë e bëri pa asnjë ngutje. Ndalej për të vërejtur i menduar herë një fytyrë, herë një tjetër, me buzë të mbledhura. Duart e verdha, më shumë duar të vdekuri, bënë kontrast me kostumin e zi. Disa prej atyre që ndodheshin në sallë kishin vrenjtur vetullat dhe i hidhnin ca shikime zhbiruese, si të donin

të gjenin ndonjë pikë të dobët te ky tip, që paraqitej kaq i sigurt në veten e vet.

Krapi qëndroi midis dy vetave, që duhej të ishin bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë. Njëri prej tyre, ai në të djathtë, ishte një trashalug veshur me smoking, me një pamje aspak simpatike. Sy të dalë, buzë të trasha e hundën të shtypur, kafka e tij tullë në tri të katërtat e saj ruante ende, në pjesën e prapme, një kurorë flokësh të bardha, të ngritura si furçë dhe laprat e mëdha të mjekrës i vareshin mbi kravatë. Njeriu në të majtë kishte një fytyrë me një ngjyrë jeshile si e shishes së ujit mineral dhe në buzën e poshtme spikaste një e çarë e thellë, shenjë e një plage të hershme. Herë pas here bënte disa lëvizje të prera, a thua se dikush e ngacmonte me majën e gjilpërës në supin e djathtë.

Kur u bind se kishte ardhur çasti më solemn, zoti Krap mori fjalën. Në mes të shkretimave të aparateve fotografike e televizive ai tha se fliste në emër të një grupi sipërmarrësish që ishin ngarkuar me përsosjen e vazhdueshme të mënyrës së jetesës në shtetin e tyre. Ata kishin vendosur të bënin një reformë të re. Sipas tij reforma do të bëhej përmes një agjencie të posaçme me emrin «Shprehja e simpatisë», e vetmja e këtij lloji në gjithë shtetin e Mafonisë.

Organizatori i konferencës së shtypit lexonte disa letra të shkruara dhe vinte e hiqte pareshtur syzet. Ai e afronte aq shumë letrën pranë hundës, sikur të donte t'i merrte erë.

— Qëllimi i agjencisë sonë, — tha Krap, — është të vërë rregull në një fushë shumë delikate, siç është ajo e dhënies së dhuratave nëpunësve qeveritarë, sidomos atyre që zënë poste nga ministër e lart. Sipas statutit të agjencisë, — tha

ai, — të gjitha ata që dëshirojnë t'i bëjnë dhurata një personaliteti qeveritar, kryetari partie politike apo kardinali të kishës, duhet që më parë të konsultohen me ne. Agjencia do të vërë në dispozicion të klientëve të saj katalogë ku rekomandohen të gjitha llojet e dhuratave më të preferueshme për kategoritë më të ndryshme të personaliteteve qeveritare e joqeveritare. Agjencia do të sigurojë edhe dërgimin e dhuratave personave të adresuar, pa rënë fare në sy të publikut, në mënyrë që të evitohen rastet e papëlqyeshme.

— A ka mundësi të shpjegoheni disi më qartë?
— pyeti njëri nga përfaqësuesit e shtypit.

Zoti Krap u mendua pak. Ai hodhi vështrimin diku në drejtim të aparateve televizive që gu-mëzhinin dhe pastaj tha:

— Ta zëmë se ju dëshironi t'i bëni një dhuratë kryeministrit, me anën e së cilës doni ta vini në dijeni se ju keni një simpati të veçantë për të. Në kushtet aktuale është bërë shumë e vështirë ta shprehni simpatinë për kryeministrin, pa e marrë vesh të tjerët, të cilët, nga ana e tyre, ju kanë zili dhe menjëherë do të fillojnë të flasin, të thonë se gjoja ju e bëni këtë për interesa personale, bile do të ketë edhe prej atyre që do të thonë se ju i jepni ryshfet kryeministrit. Duke ia dërguar dhuratën përmes agjencisë sonë, e cila garanton ruajtjen e sekretit, është e garantuar se nuk do të lindë asnjë problem shqetësues. Ne do të hapim edhe kurse për të mësuar mënyrat më delikate e më të sjellshme të dhënies së dhuratave, ose më saktë, për mënyrën e shprehjes së simpatisë për personalitetet e larta të botës politike apo të biznesit. Veç kësaj, — vazhdoi Krap, — mund të ndodhë që ju, ndonëse shpenzoni një shumë të madhe

33907

parashë, prapë të mos jua dijë kurrkush për nder, sepse po atë dhuratë mund t'ia kenë dhënë kryeministrit edhe persona të tjerë. Këtyre anomalive agjencia jonë do t'u japë fund një herë e mirë.

— Më qartë, më qartë! — u dëgjuan përsëri zëra nga salla. — Ka mundësi ndonjë shembull?

— Durim, zotërinj, durim! — u përgjigj përfaqësuesi i agjencisë «Shprehja e simpatisë». Ai ngriti gishtin tregues drejt tavanit. Të pranishmit vetëm atëherë vunë re se zoti Krap vuan-te nga sëmundja e parkinsonit, — atij i dridhej jo vetëm dora, por edhe trupi. Me sa duket ky qe një çast krize, sepse deri atëherë dridhjet e tij nuk kishin rënë në sy.

— Ja, — vazhdoi Krap me zërin që gjithashtu i dridhej, — ta zëmë se njëri nga ju dëshiron t'i bëjë një dhuratë modeste drejtorit të përgjithshëm të doganave, si për shembull t'i dhurojë një jaht të vogël turistik në ngjyrë bojë qielli, që kushton jo më shumë se njëqind mijë dollarë. Për këtë çështje dhuruesi njofton agjencinë tonë dhe nëpunësi ynë brenda disa minutave, me ndihmën e kompjuterit, mëson se sa vaporë apo jahte të tilla i janë dhuruar deri tani drejtorit të doganave dhe çfarë ngjyrë kanë ato. Në qoftë se ai e ka tashmë një vapor si ai që i ofrohet, atëherë agjencia do të propozojë një lloj tjetër dhurate, për shembull, një veturë gjahu apo një aeroplan dymotorësh, kështu që drejtori i përgjithshëm i doganave do t'i jetë me të vërtetë mirënjohës adhuruesit të tij. Ose ju dëshironi t'i dhuroni atij një çek prej një milion. Në këto raste nuk është aspak e hijshme që t'i telefononi zotit drejtor të doganave dhe t'ia thoni troç këtë gjë, sepse ai mund ta marrë

sikur ju po prekni dinjitetin e tij duke i dhënë ryshfet. Jo, zotërinj, kështu nuk bën!

Krapi heshti për një çast dhe e përqendroi vështrimin diku në fund të sallës, puthiti buzët dhe priti se çili do të ishte reagimi i atyre që kishte përpara. Meqenëse asnjëri nuk foli, ai vazhdoi:

— Jo, kështu nuk bën! Ne jetojmë në kohë të tjera. Ashtu siç ka dhjetëra mënyra për të organizuar një ballo me maska, ashtu ka edhe një numër të pafund formash për të shprehur simpatinë. Kam dëgjuar se disa e bëjnë këtë duke hedhur një paketë me monedha bashkë me kartëvizitën nga xhami gjysmë i hapur i veturës së ministrit apo kryeministrit, ndërsa vetura qëndron në stacionin para klubit të natës apo para zyrës. Metodë e vjetruar! Qindra herë e përsëritur e demode! Kush ju garanton se paketa ka rënë pikërisht në dorën e atij që i adresohet dhe jo në duar të tjera? Ose i interesuari, për një arsye ose një tjetër, të bëjë sikur nuk e ka marrë atë dhe gjithçka t'ju shkojë kot? Apo nuk kanë ndodhur raste të tilla? Agjencia jonë u jep fund këtyre dyshimeve dhe anomalive!

Dikush nga të pranishmit e pyeti Krapin nëse shërbimet e agjencisë në fjalë mund të shfrytëzohen edhe nga persona që nuk janë qytetarë të Mafonisë.

— Agjencia jonë nuk është aspak e mbyllur, — shpjegoi ai, — përkundrazi, ajo synon të bëhet sa më parë një firmë shumëkombëshe. Ne parashikojmë që shërbimet e saj të shtrihen në të gjitha sferat kombëtare e ndërkombëtare. Në qoftë se pronari i një uzine të aeroplanëve në Amerikë dëshiron t'i shprehë simpatinë ministrit tonë të Mbrojtjes, atëherë ne menjëherë do ta kë-

shillojmë pronarin e uzinës në fjalë se çfarë i pëlqen ose çfarë mungon në inventarin e ministrit tonë, në mënyrë që ky i fundit të mbetet me të vërtetë i kënaqur. Ka raste mjaft flagrante, zotërinj, të cilat nuk duhet të përsëriten. Ka pasur periudha kur ministrit të Brendshëm i janë grumbulluar aq shumë barka me vela, sa të mund të organizonte me to edhe një garë në shkallë kombëtare. E çfarë vlere ka, në qoftë se kësaj flote i shtohet edhe një varkë tjetër? Asnjë vlerë! Prokurorit tonë të përgjithshëm iu grumbulluan brenda gjashtë muajve pesë vetura të papërshekueshme nga plumbi. Në qoftë se do të ekzistonte agjencia jonë, kjo nuk do të ndodhte dhe prokurori i përgjithshëm, veç një ose dy makinave të tilla, do të kishte edhe një ose dy vila të tjera në periferi të qytetit, nga ato që janë të rrethuara me një sistem të përsosur elektronik sinjalizimi në distancë, si edhe me pishina që e ndryshojnë ngjyrën e ujit tri herë në ditë. — Urdhëroni flisni, — iu drejtua Sebastian Krapit njërit prej gazetarëve që kishte ngritur dorën.

— A mund të na thoni, cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Krapi gërshetoi gishtërinjtë e të dyja duarve dhe me shumë mundim frenoi dridhjet e krahut të majtë. Ai vështroi për një çast tavanin, kafshoi buzën e poshtme dhe u përgjigj shkurt:

— Në zgjedhjet e ardhshme do të vë kandidaturën për president të republikës.

KONGRESI BOTËROR I ANEKDOTAVE

Në kryeqytetin e shtetit Zelulu mbahen pa ndërprerje kongrese e konferenca botërore. E gjithë jeta e banorëve të këtij vendi është e lidhur me mbledhjet botërore. Edhe lindja apo vdekja e njerëzve të shquar të Zelulusë nuk shënohet në kalendarët e zakonshëm, po me datën e njërës prej këtyre mbledhjeve.

Edhe në këto momente në kryeqytetin e Zelulusë po zhvillohen njëkohësisht gjashtë kongrese, konferenca e konkurse botërore. Midis tyre, pa dyshim, vendin e parë e zë kongresi botëror i anekdotave, që është edhe kongresi më i gjatë në historinë e njerëzimit. Kongresi jep edhe çmim për anekdotën më të bukur të vitit, por, siç është vënë re, deri më sot ky çmim është fituar vetëm nga ata që kanë treguar anekdota për çarmatimin.

Pas kongresit të anekdotave vijnë me radhë kongresi botëror për mbrojtjen e qenve shtëpiakë; kongresi ndërkombëtar për luftën kundër molës; konferenca shkencore ndërkombëtare me temën «Përse tymi i oxhakut anon sipas drejtimit të erës?»; kongresi botëror për leshterikët e moçaleve, si edhe konkursi botëror i mjeshtrëve më të shquar të reklamës tregtare (jopolitike).

Kjo e fundit u mbyll me një ceremoni ma-

dhështore, ku mori pjesë pothuajse i gjithë kryeqyteti për të përshëndetur fituesin e çmimit të madh. Fituesin, të hipur mbi një karrocë të zbu-kuruar e të tërhequr nga katër kuaj si ata të Dukës së Edinburgut të Anglisë, e shëtiten në-për rrugët kryesore. Ai ishte fytyrëgjërë, i qe-shur, koka i shkëlqente si sipërfaqja e një kun-gulli nën rrezet e diellit dhe duhej të peshonte të paktën njëqind kilogramë. Merita kryesore e fituesit të konkursit botëror të reklamës tregtare ishte se ai kishte arritur të bindte një tullac të blinte një krehër! Fotografia e fituesit të kon-kursit si dhe e blerësit të krehrit zinin gjysmën e faqeve të para të gazetave më të rëndësishme të Zelulusë.

Në morinë e gjithë këtyre kongreseve e kon-ferencave njeriu e ka të vështirë të orientohet e të gjejë atë më të rëndësishmin, sidomos po të merret parasysh se ato, që të gjitha, janë bo-tërore. Por, sidoqoftë, vendosa t'i marr një in-tervistë zëdhënësit të kongresit ndërkombëtar të luftës kundër molës shtëpiake, e cila është edhe një e keqe mjaft e përhapur dhe për luftën kun-dër saj janë të interesuar pothuajse të gjithë banorët e planetit që veshin rroba leshi.

Zëdhënësi i kongresit botëror të molës i ki-shte shumë qejf intervistat dhe qe bërë shumë i njohur. Edhe nga pamja e jashtme kuptoje se kishe të bëje me një personalitet në modë. Ai u kishte dhënë liri të plotë flokëve, aq sa veshët qenë të mbuluar krejtësisht. Duke vështruar këtë bashkë leshi që lëvizte me lehtësi, mendja më shkoi te mola: po sikur në këtë masë flokësh të futej mola, a është e mundur të nxirren prej andej?

Ai e kuptoi mendimin tim, prandaj nxitoi të më shpjegonte se detyra e kongresit botëror të

molës është të studiojë e të gjejë të gjitha mënyrat e mjetet e përshtatshme të luftës kundër këtij insekti jo vetëm të dëmshëm, por edhe tinëzar. Ai më shpjegoi se mola, megjithëse insekt, hyn në familjen e brejtësve, gjë që unë nuk e kisha ditur gjer atëherë, dhe se ajo ha jo vetëm stofrat, por edhe dokumentet zyrtare, thesarin në banka dhe nganjëherë edhe postet qeveritare, shtoi ai.

— Dhe si e zhdukni atë? — e pyeta zëdhënësin e kongresit botëror.

— Shprehja juaj nuk është e saktë, — m'u përgjigj. — Ne nuk luftojmë vetëm për zhdukjen e saj. Ne përpiqemi ta luftojmë, por njëkohësisht edhe ta zhvillojmë.

— E zhvilloni?

— Po, po.

Unë shtanga. Nuk po kuptoja asgjë. Me se merrej ky kongres botëror: «me shtimin apo luftimin e molës?»

— Më falni, zotëri, — m'u afrua zëdhënësi gjithë mirësjellje, — ka edhe të tjerë që nuk na kuptojnë si duhet. Naiviteti është një sëmundje mjaft e përhapur në kohën tonë, prandaj ne kemi për detyrë t'i sqarojmë gjërat. Dëshironi të vizitoni disa nga laboratorët tanë?

— E po, për hir të sqarimit të gjërave... — rashë dakord.

Pasi udhëtuam nja dyqind kilometra në periferi të kryeqytetit të Zelulusë, mbërritëm në një qytezë të bukur, me shtëpi shumëkatëshe që rrethoheshin nga fusha të gjera të punuara.

— Këto ferma i përkasin trustit shumëkombësh «AG e CO» dhe janë marrë me qira nga kongresi ynë për të bërë eksperimentet, — shpjegoi zëdhënësi. — Dy ditë më parë këtu është përdorur një solucion i ri antimolë. Solucionet e

reja janë aq të efektshme, saqë, po të duam, brenda një kohe shumë të shkurtër mund ta zhdukim molën në të gjithë botën, po, që ta merrni vesh ju, — vazhdoi zëdhënësi, — kongresi ynë ndahet në dy pjesë: gjysma e delegatëve janë përfaqësues të trustit «AG e CO», që ka fushat eksperimentale dhe laboratorët që prodhojnë lëndën antimolë, ndërsa gjysma tjetër e kongresit janë përfaqësues të shoqërisë shumëkombëshe «Kimik korporejshen ltd», që zotëron laboratorët për prodhimin e shumëzimin e llojeve të reja të molës. Ta zëmë se e zhdukëm molën një herë e mirë, ashtu siç thoni ju, atëherë kush do t'i blejë prodhimet e laboratorëve të trustit «AG e CO»?

— A ka mundësi t'i shohim laboratorët e prodhimit të llojeve të reja të insekteve?

— Me gjithë qejf, por, para se të shkojmë atje, ne duhet të kalojmë në karantinë.

— Karantinë?

— Rregull i prerë. Gjatë vizitës në fermat eksperimentale të luftës kundër molës rrobat tona mund të kenë marrë ndonjë grimcë nga helmet e përdorura, gjë që do të dëmtonte kultivimin e insekteve të reja.

— Më falni, — iu drejtova bashkëbiseduesit tim, — ju, personalisht, në cilën gjysmë bëni pjesë, në atë që merret me luftën kundër molës, apo në atë që merret me prodhimin e shumëzimin e saj?

— Unë jam asnjans, zotëri, unë u shërbej të dyja palëve, — tha ai, duke buzëqeshur lehtë.

PËRGJIGJJA

Qytetari Anderson, banor i njërës prej lagjeve periferike të Mançesterit, kishte vendosur të ndihmonte policinë. Për këtë ai nxitoi të vinte në dijeni kryetarin e Bashkisë të qytetit, zotin Klark, me anën e një letre, ku thuhej:

Nuk e kam zakon t'u shkruaj letra autoriteteve të larta, sepse nuk dua t'i pengoj në punën e tyre fisnike për të mirën tonë të përbashkët. Megjithatë unë kam disa gjëra që më shqetësojnë, të cilat nuk mund t'i zgjidh pa u konsultuar me Ju.

Puna është se unë kam dy fëmijë, Xhenin dhe Kellin, të cilët dua t'i edukoj në frymën e kushtetutës angleze. Si njëri, ashtu dhe tjetri, deri në moshën njëvjeçare, sa s'kishin mësuar të ecnin e të flisnin, qenë engjëj të vërtetë. Mendimet dhe veprimet e tyre ishin plotësisht me normat e mirësjelljes. Kështu, deri në atë moshë ata nuk më bënë asnjë pyetje për sistemin tonë demokratik. Mirëpo tani punët kanë ndryshuar. Xheni është bërë dhjetë vjeçe dhe Kelli ka hyrë në të shtatin. Kur bie mbrëmja, ne mblidhemi në strehën tonë dhe secili tregon diçka nga peripecitë e ditës. Unë vetë bredh pas turistëve, se, helbete, ata kanë nevojë për shërbimet e mia dhe pjesën më të madhe të ditës e kalojnë në afërsi të hoteleve. Dezi, gruaja ime, rri në atë që ne e

quajmë shtëpi dhe, ç'është e vërteta, ajo mërzhitet, së ndonjë punë të madhe nuk ka. Ajo nuk ka as ujë për të larë, asgjë për të gatuar, as shtëpi për të fshirë.

Xheni dhe Kelli çohen qëmenatë dhe kthehen po natën. Tërë ditën bredhin në vendet ku hidhen mbeturinat e qytetit. Në këtë mënyrë ata sigurojnë ushqimin e tyre dhe ndonjëherë sjellin ndonjë send edhe për Dezin. Deri këtu duket se puna ecën pak a shumë normalisht për një familje të papunësh si jona. Mirëpo në të njëjtën kohë Xheni dhe Kelli vërejnë dhe në mbrëmje më bëjnë edhe disa pyetje që më vënë në dyshim. Një ditë Kelli më tha:

— Babi, pse ti je pa punë?

— S'jam vetëm unë pa punë, — i thashë.

— Në Anglinë tonë janë tre milionë si unë.

— Po kur do të gjesh punë ti?

— Kur të gjejnë të gjithë, — i thashë.

— Pse, tre milionë veta do të presësh ti në radhë?

— Ndoshta unë s'do të jem nga ata të fundit. Kush e di?

— Po çfarë di ti?

— Unë di se jam pa punë, ja çfarë di unë, ty s'të përket të përzihesh në këto gjëra.

— Babi, do të gjej punë unë kur të rritem?

— u hodh e tha Xheni.

— Mos flisni kështu, bijtë e mi, — u hodha unë, — nuk e shikoni se çfarë po ndodh në botë?

— E nga ta dinë ata se çfarë ndodh në botë?

— u doli në mbrojtje Dezi.

— Po ja, dëgjoni këtu dhe do të kuptoni se çfarë bëhet, — u thashë.

Unë nxora nga xhepi një copë gazetë që e kisha gjetur në stolin e një parku dhe ua lexova. Aty qenë botuar disa shifra të Byrosë Federale

Amerikane të Hetimeve, ku tregohej se çdo vit një milion e tetëqind mijë fëmijë amerikanë ikin nga familjet e tyre dhe humbasin pa nam e pa nishan.

Kjo shifër e preku thellë Dezin. Ajo u hodh menjëherë dhe përqafoi Xhenin e Kellin, sikur të kishte frikë se po i iknin.

Fëmijët morën guxim nga ky idil familjar dhe më pyetën:

— Pse nuk na dërgon edhe ne në shkollë?

— Nuk jeni vetëm ju që nuk shkoni në shkollë, — i ngushëllova unë. — Anglia ka miliona analfabetë. Po të shkoni ju në shkollë, kjo shifër do të ulet dhe Anglia jonë do të humbasë një shifër kaç solide e rrumbullake siç është shifra dy milionë!

— Dy milionë, dy milionë! Ti gjithmonë kështu thua, — u hodh Xheni. — Pse të mos shkojnë këta dy milionë në shkollë?

— Që të shkojnë të gjithë në shkollë, duhen shumë mësues dhe shumë ndërtesa për shkolla, — u shpjegova unë.

— Qyteti ynë ka gjithë këto pallate, — nguli këmbë Xheni.

— Pallatet janë të pronarëve të tyre.

— Ç'i duan pronarët gjithë këto ndërtesa?

— I duan për të grumbulluar para, — u thashë.

— E ç'i duan gjithë ato para?

— I duan për të bërë para të tjera, prandaj ju mos u merrni fare me këto punë, — ua preva shkurt, dhe ata nuk më bënë pyetje të tjera për shkollën.

... Një ditë tjetër Kelli vjen e më tregon se, ndërsa një fëmijë po lustronte këpucët e një xhentëlmeni në hyrjen e një restoranti të vogël, pronari doli nga një portë e pasme dhe i hodhi

një pjatë me supë të nxehtë. Kelli më vështroi me sy të trishtuar dhe sikur po më pyeste se si e gjykoj unë një akt të tillë. Unë i thashë:

— Shyqyr që niveli ynë i jetesës ka vajtur deri atje, sa t'i lejojmë vetes një luks të tillë e t'i vaditim fëmijët e mjerë me supë të nxehtë në një kohë kur për këtë punë zakonisht përdorin thjesht ujë të valuar!

Kelli deshi të më tregonte edhe diçka tjetër për supën dhe ujin e valuar, por ndërhyri Xheni. Ajo tregoi për një rast që paskësh ndodhur këtu në barakat fqinje. Xheni tha se disa njerëz të panjohur paskan regjistruar të gjithë ata fëmijë të racës së bardhë që shoqërohen me fëmijët e racave të tjera. Të nesërmen ata u thirrën në postën e policisë. — Pse t'i kenë thirrur vallë? — pyeti ajo. Unë i shpjegova se ky është një rast i qartë që tregon se në Angli ka barazi për të gjithë. Policia nuk ndjek vetëm njerëzit me ngjyrë dhe irlandezët, por edhe ata englezë që shoqërohen me ta.

Dezi, që deri atëherë po më vështronte me habi, më tha:

— Ti po flet me fëmijët sikur të ishe në polici.

— Ashtu e ndiej veten edhe unë, — i thashë.

Tani unë dua të di, zoti kryetar i bashkisë, nëse u jam përgjigjur drejt pyetjeve të fëmijëve të mi dhe nëse këto përgjigje janë në përputhje me frymën e kushtetutës sonë. Ky është shqetësimi im i vetëm».

Qytetari Big Anderson

* * *

Pas një jave qytetarin Big Anderson e thirrën në postën më të afërt të policisë.

— Ju keni dy fëmijë? — e pyeti sherifi i policisë.

— Dy.

— Me se merren ata?

— Me kazanët e plehrave.

— Zotëri, s'është e mundur të lindin kaq pyetje në kazanët e plehrave.

— Unë kam përmendur vetëm disa prej tyre.

— Kjo do të thotë se ata lexojnë literaturë të ndaluar.

— Ka pak mundësi. Ata janë analfabetë.

— Me kë takohen?

— Ata gjithë kohën janë në kërkim të ushqimit dhe shoqëria e tyre është shumë e larmishme.

— Domethënë ata kanë një shoqëri të dyshimtë, ndërsa ne ende nuk kemi asnjë dosje për ta. Ju na bëtë një sinjalizim të çmueshëm, zoti qytetar Anderson. Mund të largoheni!

KJO KA NDODHUR NË LAVIRA

Kjo ngjarje ka ndodhur në Lavira, kur zëdhënësi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, zoti Tron, po jepte shpjegime rreth gjendjes së bazave të huaja ushtarake në këtë vend. Pasi shpjegoi politikën e qeverisë së vet lidhur me këtë çështje, zoti Tron tha:

— Kështu pra, zotërinj, siç e shihni, miqtë tanë janë aq bujarë e të kujdesshëm ndaj nesh, sa kanë dërguar bijtë e tyre ushtarë për të na mbrojtur dhe për të na siguruar nga çdo e papritur. Ka pyetje?

Njëri nga gazetarët pyeti:

— Mbi ç'kritere janë lejuar bazat e huaja ushtarake në vendin tuaj?

— Ato janë baza e bazave të politikës sonë, — u përgjigj zëdhënësi.

— E keni fjalën vetëm për politikën e jashtme? — vazhdoi gazetari.

— Natyrisht.

— Bazat e vendosura në territoret tuaja, a nuk e prekin politikën tuaj të brendshme? — u hodh e tha një tjetër.

— Ne nuk e kemi zakon t'i futim hundët në punët tona të brendshme, sepse ato na i kanë marrë përsipër të tjerët, — u përgjigj zoti Tron me një ndjenjë të theksuar krenarie.

— A është e vërtetë se ushtarët e huaj nuk i njohin ligjet tuaja?

Këtë pyetje e bëri njëri prej përfaqësuesve të shtypit që merrej me problemet juridike.

Zoti Tron buzëqeshi me ironi, sikur deshi të thoshte: «Sa naivë që jeni!» dhe pastaj u përgjigj:

— Kjo është një gjë krejt e natyrshme, zotërinj. Ligjet tona ne nuk i njohim as vetë. Pse ta pretendojmë një gjë të tillë prej miqve tanë që vijnë nga vende të largëta?

Përfaqësuesi i gazetës, që merrej me anën juridike të problemeve, vazhdoi të pyeste më tej:

— Dikush ka shkruar se ushtarët e huaj gëzojnë më shumë të drejta në vendin tuaj sesa në vendin e tyre! Është e vërtetë kjo?

— Ne jemi një vend shumë mikpritës, — shpjegoi zëdhënësi Tron. — Ushtarët e huaj kanë bërë sakrifica të mëdha, kanë lënë atdheun e tyre për të ardhur te ne për të na mbrojtur.

— A mund të thuhet se territori ku shtrihen bazat e huaja ushtarake është juaji, apo... — vazhdoi të pyeste korrespondenti.

Këto pyetje duket se e bezdisën zotin Tron, prandaj ai u përgjigj shkurt e me ton të prerë:

— Hollësira të tilla juridike mua nuk më pëlqejnë, sepse ato nuk i duhen askujt. Ka pyetje të tjera?

— Më lejoni, zotëri, të bëj disa pyetje të një niveli pak më të lartë. Në radhë të parë, në çfarë ore shkon presidenti për të fjetur?

— Zakonisht në orën 23, — u përgjigj zëdhënësi.

— Edhe mbrëmë po kështu?

— Edhe mbrëmë.

— Është ide e vetë presidentit që ai të flejë pikërisht në orën 23, apo është një sugjerim i këshilltarëve të tij?

— Mund t'ju njoftoj se ky është një vendim i presidentit.

— Mund të na thoni se çfarë i tha ministrit të Jashtëm kur shkoi për të fjetur?

— «Natën e mirë».

— A mund të na thoni nëse sheh ëndrra presidenti dhe, nëse po, mund të na tregoni disa prej tyre?

— Presidenti asnjëherë nuk e ka zakon të më tregojë ato që sheh në ëndërr. Ato mbeten sekret shtetëror.

Njëri nga gazetarët u hodh e tha:

— Marr guximin të bëj një pyetje nga jeta e përditshme. A është e vërtetë se ushtarët e bazave të huaja bëjnë skandale në rrugë dhe prishin qetësinë e publikut?

Zoti Tron u vrenjt. Ai vështroi njëherë në tavan, kafshoi buzën e poshtme dhe pastaj tha:

— Kjo ndodh vetëm atëherë kur janë të dehur.

— Ju lutem, mos më keqkuptoni, — vazhdoi gazetari që bëri pyetjen. — Unë nuk e kam fjalën për të dehurit.

— Mua nuk më ka qëlluar asnjëherë të shoh ndonjërin esëll, — u përgjigj shkurt zëdhënësi dhe pa orër, gjë që donte të thoshte se koha e caktuar për konferencën e shtypit kishte mbaruar.

Por mbarimi nuk paskësh qenë në dorën e zotit Tron. Një shishe u përplas në murin anësor të sallës dhe krisma e thatë e qelqit që u thye i rrëqethi të gjithë të pranishmit. Ajo erdhi aq papritur, sa njerit prej tyre iu duk se në sallë shpërtheu një bombë.

— Atentat! — thirri dikush dhe secili gjeti strehim nën tryezën e vet. Të gjithë u fshehën si me komandë dhe salla u boshatis, sa hap e mbyll sytë.

— Hahaha! Oh, sa më bëtë për të qeshur!... hahaha! Më falni, zotërinj, një shishe... asgjë... Çohuni, zotërinj, çohuni me guxim, pa dashje...

I dehuri heshti për një çast. I pari e nxori kokën nga poshtë tryezës zoti Tron. Pas tij, një nga një, edhe të tjerët. Ata vështronin me habi e njëkohësisht të lehtësuar njeriun që qeshte e gajasej. Njeriu me uniformën e ushtariq të huaj kishte hipur mbi një tryezë dhe mezi e mbante veten.


— Si erdha unë këtu... hahaha!... Unë jam kudo. Baza, zotërinj, jo shaka! Unë baza! Ju çatia! Hahaha!... Çatia pa bazën, fup, bie!... Hahaha! Zotërinj! Ju vetë më thirrët, ë? Ju folët për mua, unë erdha, zotërinj... Ju folët për bazat... bazat sekret, zotërinj! E dini kush jam unë? Unë e di kush jeni ju. Jullafazanë, zotërinj, ja ç'jeni ju... Më falni, zotërinj, më falni, pa dashje. Unë erdha këtu pa dashje. Flisni, zotërinj të nderuar, flisni, shkruani, pse të mos shkruani? Sa më zbavitni!... Kush jam unë? Hahaha! Unë jam baza! Ju çatia. Baza më e rëndësishme se çatia! Hahaha!... Më falni, zotërinj, më falni. Pa dashje... Me të vërtetë, çfarë bëhet këtu?... Nuk është klub kjo sallë? Oho, qenka sallë mbledhjesh. Sa qesharakë! Vazhdoni, zotërinj, vazhdoni, ju lutem... Baza jam unë... Aha, pse kam ardhur unë këtu! Në djall të venë të gjitha zyrat e sallat e mbledhjeve. Konjak, zotërinj, më jepni konjak!

I dehuri zbriti nga tryeza dhe, duke i tërhequr këmbët zvarrë e me kapelën në dorë, iu drejtua portës.

— Mirupafshim, zotërinj të nderuar... Vij prapë unë. Ju shkruani, zotërinj, shkruani. Baza sekret... Unë jam këtu... Baza më e madhe se çatia... E shikoni revolen, zotërinj?... Hahaha!

U trembët, ë? Mos u trembni...! Sa më zbavitni!
Hahaha!

Kur uniforma e huaj qe larguar përfundimisht nga salla, zoti Tron deshi të pyeste edhe një herë nëse korrespondentët kishin ndonjë pyetje tjetër, por të gjithë ishjin të qartë, edhe për bazën, edhe për çatinë.



ËNDËRR NË SHKALLË EVROPIANE

Qytetari i Evropës së Bashkuar Hans Jonis Karkareli kishte parë një ëndërr të jashtëzakonshme dhe si të tillë nuk mund ta mbante brenda rrethit të ngushtë familjar e shoqëror, sepse ajo kishte të bënte me interesat e përgjithshme të komunitetit. Prandaj ai, sapo u zgjua, e pa të udhës t'i drejtonte këtë letër kryeministrit:

Zoti kryeministër!

Po e them që në fillim se nuk po ju shkruaj për të më gjetur punë, sepse kjo nuk është detyra juaj, por desha t'ju njoftoj se kohët e fundit kam parë një ëndërr mjaft të çuditshme. Natyrisht njeriu nuk e ka në dorë të shohë apo të mos shohë ëndrra, sepse në gjumë është i pavetëdijsëm, por, megjithatë, unë dua që edhe në gjumë të jem në rregull me ndërgjegjen time, si një qytetar i denjë i Evropës së Bashkuar.

Kështu, një natë, pasi kisha parë në mbrëmje

një emision televiziv kushtuar vizitës suaj në Amerikë, në gjumë e sipër (për fat të keq nuk më kujtohet se në cilën orë e në cilën minutë) pashë në ëndërr sikur edhe unë u bëra një personalitet i lartë shtetëror dhe u nisa për një vizitë në Amerikë. Atje më pritën me trumbeta e ceremoni të mëdha. Sapo zbrita nga aeroplani, dikush më zgjati dorën dhe m'u prezantua si presidenti amerikan, por unë, edhe pse në ëndërr, e mblodha veten dhe nuk e besova, pasi edhe në gjumë m'u kujtua se presidenti ishte shtruar në spital, i plagosur nga një plumb që kishte marrë gjatë një përsëritjeje me publikun.

Siç është bërë zakon në këto raste, për mua, si mysafir i lartë, menjëherë organizuan një konferencë shtypi. Aparatet fotografike shkrepnin në të katër anët dhe kamerat televizive më kishin marrë në shenjë, si të isha mis Evropa. E gjithë kjo u pasua me një breshër pyetjesh:

— Si sillen ata ushtarët tanë të bazave amerikane atje në Evropë? — Kjo qe pyetja e parë që m'u drejtua nga një korrespondent, të cilin unë nuk e kuptova se cilës gjini i përkiste, sepse gjysmën e fytyrës nuk ia shihja dot për shkak të flokëve.

— Shumë mirë, — u thashë unë, — bile më mirë sesa mund të mendohet. Ata, ushtarët tuaj, edhe gjënë më të shtrenjtë që kanë me ne e ndajnë. Për shembull, marihuanën. Në saje të tyre, — vazhdova unë, — te ne opiumi ka marrë një përhapje të gjerë, sidomos te vajzat dhe djemtë e moshave trembëdhjetë e katërmëdhjetë vjeç.

— Tjetër, ndonjë shembull tjetër, — thirri dikush.

— Ata ushtarët tuaj janë njerëz me temperament të zjarrtë, fantastikë; ata, për hir të dë-

frimit, s'e kanë për gjë të qëllojnë me revole kudo që janë, në lokalet publike e sidomos në orët e vona të natës. Kjo gjë na e bën jetën mjaft të gjallë.

— Bravooo! — thirrën disa korrespondentë njëherësh. Pastaj njëri prej tyre pyeti:

— Ne shpeshherë i qëllojmë me revole presidentët tanë, po ju pse nuk i vritni tuajt?

— Unë nuk iu përgjigja direkt, sepse, në të vërtetë, nuk e di nëse bëjmë mirë apo keq që nuk i vrasim edhe ne presidentët tanë.

— Nuk e di, ndofta duhet të bëjmë edhe ne si ju, — thashë dhe mblodha supet.

Përgjigjja ime, ndonëse e lëkundur, shkaktoi entuziazëm dhe aprovim në sallë, bile disa edhe duartrokiten.

— A lejohen gangsterët atje, në vendet tuaja, të mbledhin kongreset e tyre? — më pyeti një korrespondent me gjyzlykë të errët në formë katrori.

— Si nuk lejohen, — i thashë. — Ne i zgjedhim ata edhe në parlament, bile u japim edhe poste ministrash, natyrisht, po t'u pëlqejë, sepse ne, pa pëlqimin e tyre, nuk bëjmë asgjë.

Këtu e ndjeva menjëherë se e shkela, sepse të pranishmit nuk u kënaqën nga përgjigjja ime. Njëri u hodh e tha:

— Ministër apo senator nuk është ndonjë post kushedi se çfarë, prandaj ju qenkeni prapa, ne i bëjmë ata edhe presidentë!

— Po gjendja ekonomike si është atje te ju? — dëgjova një zë të trashë që nuk e di se nga më erdhi.

— Të gjithë treguesit kanë shënuar rritje këto kohët e fundit, — u përgjigja unë dhe si shembull u përmenda faktin që tani, për të blerë një kilogram mish, japim dyfishin e parave që

nevojiteshin një vit më parë.

E gjithë salla fishkëlleu në shenjë miratimi dhe kënaqësie.

— Cilat janë çështjet që e preokupojnë sot komunitetin tuaj? — vazhdoi të pyeste i njëjti person.

— Ne, — thashë unë, — nuk kemi asnjë çështje që na preokupon, me përjashtim të fatkeqësisë që zuri kalin më të preferuar të mbretëreshës së Anglisë. Ai ka thyer këmbën dhe tërë komuniteti evropian është në merak nëse kali do të mund të marrë pjesë në garat e ardhshme të vrapimit në hipodromin e Montekarlos.

Kjo përgjigje bëri përshtypje të madhe. Ai që drejtonte konferencën e shtypit u çua e tha se i gjithë shtypi amerikan do të marrë pjesë në shqetësimin tonë, duke ndjekur hap pas hapi gjendjen shëndetësore të kalit të mbretëreshës.

— A rriten patat andej nga ju? — pyeti një nga korrespondentët më të afërt të Shtëpisë së Bardhë, i cili, me sa dukej, merrej me rritjen e shpendëve.

Nuk e kuptova se ku rrihte kjo pyetje, prandaj as nuk desha t'i përgjigjesha, por përsërita atë që e thonë shpesh diplomatët: «No koment». Mirëpo shoqëruesi zyrtar m'u afrua të veshi dhe më shpjegoi se një përgjigje pozitive për këtë pyetje kishte shumë rëndësi, sepse të gjithë anëtarët e kongresit ishin të interesuar në mënyrë jetike për gjuetinë e patateve. Atëherë unë u ngrita e thashë se në gjithë planetin nuk mund të gjendej një zonë tjetër më e përshtatshme, sesa Evropa e Bashkuar, për gjuetinë e patateve, bile jo vetëm të patateve, por edhe të bretkosave, sidomos të bretkosave me bulçi të mëdha.

Kjo shkaktoi një entuziazëm të përgjithshëm

dhe unë e ndjeva veten tamam në lartësinë e një personaliteti që jep konferenca sktypi.

Dikush më bëri një pyetje krejt të papritur. Ai deshi të dinte se sa batanije përdor kryetari i komunitetit tonë në dhomën e gjumit. Unë këtë nuk e dija me siguri, sepse nuk më ka qëlluar asnjëherë të hyj në dhomën e tij të gjumit (kur s'ke vetë dhomë gjumi, s'ka ç'të duhet dhoma e tjetrit). Mirëpo edhe këtu shoqëruesi im i kujdesshëm më erdhi përsëri në ndihmë dhe më shpjegoi se kjo ishte një pyetje thjesht simbolike, pasi fjala ishte të dinin nëse kryetari ynë përdor xhaketa ose veshje të tjera të papërshekueshme nga plumbat. Atëherë unë u thashë se ne nuk disponojmë edhe aq shumë veshje të tilla, prandaj kërkova që ato të na jepen me kredi nga Amerika.

— Po krizat, si i përballoni? — u hodh e tha dikush.

— Këtë ne e kemi zgjidhur shumë lehtë, — u përgjigja unë. — Futim pambuk në vesh dhe mbyllim sytë. Kur gjërat nuk i sheh e nuk i dëgjon, ato menjëherë pushojnë së ekzistuari.

Kjo përgjigje shkaktoi ovacione. Dikush thirri me të madhe dhe kërkoi që pikërisht kështu të veprohet kudo. Mua, nga zhurma e duartrokitjeve dhe e fishkëllimave, më doli gjumi. Pashë se isha bënë qull në djersë. «Shyqyr që shpëtova», thashë me vetë, por, pasi u qetësova, menjëherë më shkoi mendja te ju, zoti kryeministër, sepse mendova: «Vallë, u përgjigja mirë dhe ashtu siç i takon një qytetari të denjë të Evropës së Bashkuar?» Ju lutem, përgjigjuni, zoti kryeministër, sepse jam tepër i preokupuar të di nëse e kreuva detyrën time siç duhet.



MINJTË NËN JASTËK

Bruks e Vuks vendosën t'i shkruanin një le-
tër presidentit për t'i shprehur miratimin e tyre
lidhur me krijimin e forcave të ndërhyrjes së
shpejtë.

Letra thoshte:

Zoti president i SHBA!

*Ne jemi jo vetëm bashkatdhetarë me ju, por
edhe banorë të të njëjtit qytet. Megjithëse nuk
na ka qëlluar të shohim nga afër ndonjë president
të Shteteve të Bashkuara, ne jemi në dijeni për
ekzistencën e tij. Ndërsa ju me siguri nuk dini
asgjë për ekzistencën tonë. Kjo nuk vjen nga pa-
kujdesia juaj, por thjesht sepse shtëpitë tona, që
përbëjnë atë unazë pothuajse të padukshme të
kryeqytetit, nuk kanë sesi të bien në sy që nga
majat e grataçielave. Le që shtëpitë tona nuk
gjenden në asnjë libër adresash. Njëherë pro-*

vuan të vënë numra edhe në vendbanimet tona, që quhen me emrin e përbashkët bidonvile, por ata fluturuën si me magji. Teneqetë dhe kartonat që përbëjnë muret, çatitë dhe dyert tona zhduken herë pas here nga zjarret dhe nga erërat.

Kur morëm vesh se ju keni caktuar disa miliardë dollarë për të krijuar reparte të ndërhyrjes së shpejtë, ne u gëzuam pa masë. «Presidenti filloi të mendojë seriozisht edhe për ne dhe tani s'na mbetet veçse të presim ndërhyrjen e shpejtë!» thamë. Ne shpesh jemi objekt i sulmeve të pabesa a të papritura, sidomos të minjve. Këta janë aq të pabesë, saqë, po t'u qepën, ja mishin, ja leshin, ta heqin me siguri. Ata sulmojnë natën dhe ditën, në formacione të rregullta dhe me reparte të kufizuara apo thjesht me ushtarë të veçuar e me snajperë të sprovuar. Me pak fjalë, si t'u vijë për mbarë. Ne jemi të bindur se tani që u krijuan forcat e posaçme për ndërhyrje të shpejtë, gjendja do të ndërrojë. Ne kemi marrë të gjitha masat e nevojshme që, sapo të bëhemi objekt i sulmit të papritur ose sapo të vëmë re se përgatiten sulme masive kundër nesh, të njoftojmë menjëherë repartet e ndërhyrjes së shpejtë në Pentagon.

Nderimet tona, zoti president!

Qytetarët Bruks e Vuks.

Letra e qytetarëve Bruks e Vuks e preku pa masë presidentin dhe ai u përgjigj menjëherë: Të nderuar qytetarë Bruks e Vuks!

Më vjen shumë mirë që ju i miratoni me gjithë shpirt masat e marra nga unë për krijimin e forcave të ndërhyrjes së shpejtë, por njëkohësisht më vjen keq që ju nuk e kuptoni se ato forca ne i kemi krijuar për të mbrojtur miqtë dhe interesat e Amerikës në pika të ndryshme të globit e jo për t'u marrë me minjtë! Ju duhet

ta merrni me mend se bëhet fjalë për gjëra tepër serioze dhe jo për minj apo tartabiqe. Pa forcat e ndërhyrjes së shpejtë ne nuk do të mund të mbajmë në fron as sulltanin e Omanit, as juntën e Salvadorit, nuk do të mund të mbrojmë as ngushticën e Hormuzit në detin e Persisë. Ju do të thoni se mjaft i kemi tërë ato forca që janë shpërndarë në të katër anët e botës. Jo, jo, mos u gaboni të mendoni kështu. Ndonjëherë ngjarjet zhvillohen me aq shpejtësi, sa që, kur kujtohen forcat e bazave tona të lëvizin, e ka marrë ferra ura-tën. Gatishmëria jonë duhet të jetë në atë shkallë, sa ushtarët tanë të flenë në aeroplanë me motorë të ndezur, bile të mos flenë fare. I dridhen këmbët sulltanit të Omanit, apo sundimtarit të Jordanisë? Ushtarët tanë ua hipin helikopterëve dhe u shkojnë menjëherë në ndihmë. «Mos u dridh, — i thonë mbretit, — se na ke pranë!» Duket ndonjë vapor i ndonjë fuqie tjetër diku në Mesdhe apo në detin e Kuq? Ne menjëherë prapa tij, oh, më falni, desha të them se ne duhet të jemi atje përpara tij. Unë besoj se tani e kuptoni, të dashur bashkatdhetarët e mi, se forcat tona të ndërhyrjes së shpejtë kanë të bëjnë me ruajtjen e nderit të Amerikës, pra ato meritojnë t'u japim edhe kafshatën tonë të fundit!

Presidenti R.

Qytetarët Bruks e Vuks e kuptojnë gabimin e tyre dhe nxitojnë për të kërkuar ndjesë:

Zoti president R.

Ju kërkojmë ndjesë për letrën tonë. Ne deri tani paskemi qenë krejt në errësirë. Vetëm letra juaj na ndihmoi të kuptojmë se forcat e ndërhyrjes së shpejtë nuk qenkan krijuar për të na

mbrojtur nga minjtë e bidonvileve tona, por për të mbrojtur sulltanin e Omanit. O perëndi, çfarë ngatërresë e pafalshme! Por, të jeni i sigurt, zoti president, se gjithçka është bërë padashur dhe as që na ka shkuar ndër mend t'i krahasojmë minjtë me ndonjë mbret apo me atë sulltanin që ju e keni marrë në mbrojtje. Dhe, meqenëse fjala qenka për mbrojtjen e nderit të Amerikës, ne jemi gati që, për hir të ruajtjes së fronit të sheikëve të naftës, të nënshkruajmë një pakt mossulmimi me armiqtë tanë më të afërt — minjtë. Edhe sikur pala kundërshtare të mos e pranojë nënshkrimin e një pakti të tillë, ne do ta respektojmë atë në mënyrë të njëanshme, sepse, për një amerikan, minjtë nën jastëk janë shumë më të këndshëm sesa rënia e ndonjë mbreti saudit apo humbja e ngushticës së Hormuzit, që qenka kaq pranë brigjeve tona. Ne tani e kuptojmë fare mirë se ju, zoti president, shikoni shumë larg, bile aq larg, sa që nuk mundeni kurrësi të shikoni se çfarë ndodh këtu afër. Ne na emocionoi sidomos thirrja juaj për të dhënë edhe kafshatën e fundit!

Qytetarët B e V.

ÇDO LIGJ KA EDHE PËRJASHTIME

I pari e mori fjalën përfaqësuesi i akuzës, i cili bëri këtë paraqitje:

— Këtu para jush, zotërinj gjykatës, keni vjedhësin 32-vjeçar, të quajtur Peter Pirson, qytetar i Montanës. Ai akuzohet për vjedhje bankash në mënyrë të përsëritur.

— I akuzuari Pirson, e pranoni se keni kryer krimet? — pyeti kryetari.

— Çfarë krimi, zotërinj! Vjedh bankat dhe asgjë tjetër!

— Zotërinj gjykatës! Unë, si përfaqësuesi i akuzës, dua t'ju tregoj edhe mjetet me të cilat i akuzuari i ka kryer krimet e tij. Ja, këto që shihni këtu, të gjitha të tijat janë.

— I akuzuar, i pranoni ju këto?

— Po, këto vegla më kanë shërbyer dhe shpresoj të më shërbejnë përsëri.

— Fjala i jepet avokatit të të akuzuarit, zotit Kinsbruk.

— Unë s'kam asgjë për të thënë, pasi vetë i akuzuari ka disa argumente që dëshirojnë t'i paraqitë personalisht.

— I akuzuari Peter Pirson, çfarë keni për të thënë?

— Para pesë vjetësh ju më dënuat me dhjetë vjet burg sepse kisha grabitur pesëdhjetë mijë

dollarë në një bankë. Me sa vjet burg dëshironi të më dënoni kësaj radhe?

— Edhe tani ju një shumë të tillë keni grabitur; i pandehur Pirson, dhe po me atë nen do të dënoheni. Krejt logjike, apo jo?

— Këtu s'ka asnjë logjikë, zotërinj gjykatës. Pesë vjet më parë, me pesëdhjetë mijë dollarë blihej dy herë më shumë sesa sot.

— Sipas jush, tani duhet të dënoheni me gjysmën e afatit që parashikon ligji? Po?

— Me gjysmën, në mos me një të tretën.

— Ligji është ligj, zoti Pirson.

— Mirë, zoti gjykatës, edhe ashtu le të bëhet. Por kini parasysh se edhe unë po aq para do t'ju jap, sa edhe para pesë vjetësh për lirimin tim. Mos më thoni pastaj jo inflacioni, jo çmimet...

— Ah, po, më falni, zoti Pirson. Unë desha të them se çdo nen ka edhe përjashtimet e veta.

KOLOMBI NË «TOKËN E RE»

— Dorën, zoti Kolomb! — urdhëron përfaqësuesi i policisë së portit, duke iu drejtuar të porsaardhurit në «Tokën e Re.»

Kolombi i zgjati miqësisht të dyja duart.

— Jo të dyja! — thotë përfaqësuesi i policisë. — Mua më duhet vetëm gishti tregues i njërës dorë.

— Gishti! Gishtat janë të ngjitur me dorën, zotëri! — përgjigjet Kolombi i habitur. — Çfarë ju duhen gishtërinjtë e mi?!

— Ky është rregulli ynë i brendshëm, — thotë polici me ton të prerë. — Të gjithë bano-rët e këtij vendi kanë në zyrat tona dosjet e tyre...

— Oho! Po unë s'jam qytetar i këtij vendi. Sapo zbrita në tokën tuaj.

— Aq më tepër. Prej nga vini, zotëri?

— Nga Spanja.

— Direkt nga zoti Franko?

— Ai ka vdekur prej vitësh, zotëri.

— Kjo do të thotë se ju nuk e gëzoni besimin e tij?

— Nuk e kam takuar asnjëherë.

— E qartë. Kjo do të thotë se ju nuk bëni pjesë në spanjollët e besueshëm! Mbushni këtë formular dhe këtu në qoshe do të lini shenjat e gishtit tregues!

Kolombi plotëson formularin, lë shenjat e gishtit tregues, del në trotuarin e gjerë buzë detit dhe ecën i menduar për zbulimin e bërë.

— Po kjo? — pyet lundërtari një kalimtar të rastit, kur pa një grua me përmasa gjigante që ngrihej mbi një pedestal. Gruaja mbante në dorë kërcënueshëm një fener në formën e topuzit.


— Kjo është liria amerikane, — përgjigjet vendasi.

— Liria? Kaq e madhe?! — habitet Kolombi duke vështruar skulpturën që zotëronte të gjithë hapësirën e portit.

— Po, — vazhdon vendasi. — Skulptori e ka përfytyruar lirinë në përmasa jonatyrale. Në natyrë, ç'është e vërteta, ajo është shumë më e vogël, desha të them jo dhe aq...

Banori vendas nuk arrin ta përfundojë frazën. Pishtari në formën e topuzit i bie në kokë dhe ai humbet ndjenjat. Kolombi mundohet ta sjellë në vete, por pa sukses.

— Eh, — rënkon Kolombi, — duhej apo s'duhej zbuluar ky vend?



Ora tregon mesnatën. Megjithatë shumica e tryezave janë ende të zëna. Lundërtari i madh Kolombi, i lodhur nga rrugët e gjata, gjen një vend të lirë dhe ulet diku në qoshe të sallës.

Në kafene futet me bujë një klient i ri. Ai mban një kapelë të ulur deri mbi sy. Kalon përmes tryezave dhe i drejtohet arkës. Arkëtarja, një bjonde me flokë të prerë shkurt dhe sy të qarkuar me dy rrathë, njëri me ngjyrë jeshile dhe tjetri portokall, lëshon një klithmë therëse. Pronari i kapelës së ulur deri në sy nxjerr revolen nga xhepi i prapmë i pantallonave dhe gërthet me zë të çjerrë:

— S'ka nevojë për panik. Mua nuk më duhen të gjitha paratë. Të voglat mund t'i mbani për vete.

Të gjithë sa janë në kafene kthehen andej nga erdhi zëri. I panjohuri, në njërin dorë mban revolverin dhe në tjetrën mbledh dollarët që i jep arkëtarja. Të pranishmit e vështrojnë këtë skenë dhe asnjëri nuk lëviz nga vendi.

— Gjepura! E vë me bast se ky djalosh s'ka marrë sonte më shumë se nja treqind dollarë, — thotë ai që rrinte përballë Kolombit.

— Ç'është kjo Grabbitje? — pyet zbuluesi i Amerikës.

— Po. Për besë, ju eci. Patët rastin të shikoni një grabitje të vërtetë, pa paguar asnjë dollar. Në kinema për këtë do të paguanit para.

— Por... dikush nga ne duhet t'i shkojë në ndihmë kësaj gruaje fatkeqe, — thotë Kolombi i shqetësuar.

— Gruan nuk e kërcënon asnjë rrezik. Ajo do të jetë e siguruar, — i përgjigjet tjetri.

— Çfarë sigurimi, zotëri! Atë po e grabitin.

— Ne në Amerikë të gjitha arkëtalet i kemi të siguruara në rast grabitjeje. Kjo është më fitimprurëse sesa të luftosh me grabitësit.

Kolombi vështron me habi.

— Po, po, zotëri. Çështja e sigurimit këtu është vënë në binarë të gjerë. Amerikani i mesëm sigurohet me kënaqësi të madhe. E nesërmja është plot me të papritura. Çdo gjë mund të shembet brenda disa minutave.

— Dhe ju jeni të siguruar nga të gjitha të papriturat?

— Pikërisht, madje në vendin që keni zbuluar ju, njeriun e sigurojnë edhe komplet edhe pjesë-pjesë. Veç pjesët e sipërme e veç të poshtmet.

— Më falni, po nuk ju kuptoj, — thotë lundërtari i madh.

— Fare thjesht, zotëri. Në qoftë se jeni futbollist, çdo këmbë juaja mund të sigurohet për një shumë të majme. Po të jeni yll kinemaje, atëherë vlerat më të mëdha i merr pjesa e sipërme e trupit.

— Po në qoftë se nuk je as futbollist, as yll kinemaje?

— Atëherë me sigurimin tuaj merret një shoqëri tjetër e posaçme, shoqëria e varrimeve. Me se merreni ju, zotëri?

— Hëpërhë jam i papunë.

— Aha, për të papunët nuk do të mund të gjeni asnjë shoqëri sigurimi.

— As ajo e varrimeve?

— Me të papunët merret policia, zotëri, po edhe ajo nuk i disiplinon dot të gjithë.

Kolombi i hedh një vështrim sallës, që kishte filluar të boshatisej dhe del në rrugë të madhe.

Në Avenjunë e Pestë kishte ndodhur një aksident. Një kalimtar plak që flakur nga parafanga e automobilit në trotuar. Kolombi e pa viktimën dhe menjëherë pyeti veten:

«Do të jetë vallë i siguar ky fatkeq?»

Sakaq rruga oshëtiu nga sirenat e makinave të ndihmës së shpejtë. Policët, me shkopinjtë prej gome në duar, larguan sehirxhinjtë dhe u hapën rrugë makinave. Ato ishin tri vetura me ngjyra të ndryshme.

«Sa mirë, — mendoi me vete Kolombi, — këtu me të vërtetë qenka organizuar si duhet ndihma e shpejtë.»

Nga veturat zbritën me vrap tre djem të rinj, ndërsa një i katërt i priste pa lëvizur nga vendi.

Njëri prej atyre që zbritën, iu afrua viktimës dhe i foli me të madhe te veshi:

— Zotëri, nënshkruajeni me të shpejtë këtë letër! Nënshkruajeni dhe menjëherë do t'ju dërgojmë në spitalin tonë, që është më i miri në qytet, me dritare nga ana e diellit, me park luksoz; ju sigurojmë qetësi të plotë. Gazetarëve u ndalohet të hyjnë. Nënshkruajeni...

Njeriu i shtrirë në trotuar merrte frymë me zor dhe sytë i kishin perënduar.

— Në qoftë se dëshironi me të vërtetë të jetoni, zgjidhni vetëm spitalin tonë, — ndërhyri i dyti. — Dhomat janë me dush dhe me televizor. Vetëm njëqind dollarë në ditë! Kurrkund tjetër nuk do të gjëni një çmim kaq të ulët, pothuaj qesharak.

Përsëri njeriu i shtrirë në trotuar nuk po jepte përgjigje. Atëherë i afrohet i treti:

— Ej, zotëri, eja në vete! Spitali ynë është

krejt i elektrifikuar. Elektrokompresa... gjithçka e saktë, si sahati.

Viktima rri mospërfillëse ndaj ofertave që i bëhen. Agjentët e spitaleve u larguan pa nënshkruar asnjë kontratë. Policët i hodhën viktimës një çarçaf të bardhë prej plastmase, ndërsa Kolombi u largua për në dhomën e hotelit, ku kishte fjetur edhe një natë më parë.

Në mëngjes në dhomën e tij bie zilja. Para portës qëndron një mesoburrë me faqe plot shëndet. Ai buzëqesh si një engjëll dhe fillon të flasë ngadalë, me një zë të mekur, sikur zëri t'i dilte nga fundi i dheut:

— Në këtë botë gjithçka është e përkohshme dhe e kotë, zotëri. I përjetshëm është vetëm shpirti. Jeni dakord me mua, zotëri i nderuar?

Kolombi përgjigjet me një gjest të papërcaktuar, me qëllim që t'i japë kohë vetes për të mësuar se kush ishte ky njeri: ndonjë i marrë apo ndonjë agjent që merret me rekrutimin e anëtarëve të rinj në ndonjë sekt mistik. Megjithatë i panjohuri vazhdon të buzëqeshë dhe pastaj, me një ofshamë të thellë, shton:

— Gjithçka rrëshqet, asgjë s'është e përjetshme, duhet pranuar kjo, zotëri.

Pas kësaj përgatitjeje shpirtërore, i panjohuri hyn drejt e në temë:

— Ju propozoj të blini një pronë të palëvizshme, zotëri. Dëgjomëni mua. Pamje e mreku llueshme. Lëndinë e lulëzuar. Qetësi e garantuar.

— E ç'më duhen lëndinat dhe pamjet e mreku llueshme, kur çdo gjë është e përkohshme dhe e kotë? — u përgjigj zbuluesi i Amerikës.

— Ajo që ju propozoj unë, zotëri, është e përjetshme. Firma jonë merret vetëm me shitblerjen e parcelave për varrezat.

— Firma juaj qenka tepër interesante, — thotë Kolombi, — por unë ende nuk kam vendosur t'i laj hesapet me këtë botë.

Kolombi mbyll derën e dhomës.

Sa do të dëshironte ai që, bashkë me derën e dhomës, të arrinte të mbyllte gjithçka që po i shikonin sytë dhe po i dëgjonin veshët. Por ishte tepër vonë!

NË KABINETIN E MILIONERIT...

Milionerin Top Big e gjeta në kabinetin e tij. Gjysmë i shtrirë e gjysmë i përgjumur, në një shezlong, ai të jepte përshtypjen se po jetonte në kufirin midis jetës e vdekjes. Përshëndetja ime nuk e gjallëroi pothuajse fare shprehjen e fytyrës së tij. Duart e kryqëzuara mbi bark mbetën ashtu dhe nuk lëvizën aspak, edhe pse në dhomë kishte hyrë një njeri i huaj. Buzët e tij të holla e të qepura fort pas njëra-tjetrës të krijonin përshtypjen e një qenieje jo vetëm të pakënaqur, por edhe që e ka vështirë të flasë.

Kur u gjenda para tij, ai bëri një lëvizje me kokë, të cilën unë e deshifrova kështu: «Hajt, flisni! Çfarë dëshironi nga unë?»

Prandaj, pa e zgjatur, hyra drejt e në temë:

— Po afron Viti i Ri, — i thashë, — si e vlerësoni vitin që po kalon?

— Nuk kam asnjë simpati të veçantë.

— Përse jeni zemëruar me të?

— Së pari, ai është sjellë me njëfarë ashpërsie me ne, gjë që është manifestuar nëpër rrugë. Së dyti, ai po ikën duke lënë një zëvendës të cilit unë nuk i besoj hiç.

— Si, nuk i besoni Vitit të Ri që po vjen?! Ai ende nuk ka ardhur, nga e njihni ju atë?

— Unë, përgjithësisht, nuk u besoj viteve, desha të them kohës.

— Mendoni se koha punon kundër jush?

— Këtë nuk e them unë. Ajo gjithmonë na vë përpara fakteve të kryera:

— A mendoni se koha duhet të kthehet pas?

— Në mos u ktheftë pas, të paktën të gozhdohet në vend.

— Keni shumë argumente kundër kohës?

— Argumente kam plot, por puna është se ajo nuk i pranon ato.

— Domethënë se ajo do të vazhdojë të ecë. Atëherë, a mund t'ju bëj edhe disa pyetje të tjera?

— Natyrisht, shpejt e shpejt. Koha ikën dhe s'dihej çfarë sjell me vete.

— Po taksapaguesit, a kanë të njëjtin mendim me ju për kohën?

— Unë mendoj se ata kanë plot arsye ta presin me gëzim e optimizëm Vitin e Ri, sepse parashikohet që ata të japin një kontribut edhe më të madh në lulëzimin e shoqërisë sonë.

— Parashikoni ta zhdukni papunësinë vitin e ardhshëm?

— Në mos gabohem, ju jeni ai që më keni intervistuar edhe vitin e kaluar?

— Unë.

— Me sa më kujtohet, këtë pyetje ma keni bërë edhe vitin që shkoi. Mua nuk më pëlqen kur çdo vit më bëjnë të njëjtat pyetje. Keni të tjera?

— Ju jeni një nga figurat më të mëdha në qeverinë tuaj. Çfarë masash parashikohet të merren vitin e ardhshëm për perfeksionimin e mëtejshëm të sistemit shëndetësor?

— Para së gjithash, do të zhvillohet industria farmaceutike për shtimin e medikamentëve qetësuese. Neve shpeshherë na ndodhin gjëra të pa-

pëlqyeshme, si për shembull pushim zemre në castin e pagimit të taksave e të qirave. Ne do të përpiqemi t'i evitojmë këto raste në maksimum. Ilaçet tona qetësuese do t'u shpërndahen falas të gjithë taksapaguesve, bashkë me kuin-tancën e llogarisë. Ato do t'u jepen falas edhe grave shtëpiake në të gjitha rastet kur ka ngritje çmimesh.

— Viti i ardhshëm, pa dyshim, do të sjellë edhe shpikje të reja teknike. Dhe ju, në fillim, thatë se do të donit të ndalnit kohën? Nuk do të dëshironit shpikjen e një makine që ndalon pikërisht rrjedhën e saj?

— Tani është tepër vonë. Viti i Ri erdhi dhe askush s'na garanton se pas tij s'do të vijjë edhe vite të tjera.

— Pra, ju mendoni se ecja e kohës është e paevitueshme, ashtu si për shembull edhe kriza?

— Kriza?! Cila krizë? Ju dëshironi të më shkaktoni krizën e zemrës? Ju ndaloj të flisni gjepura të tilla, djalosh!

— Më falni për shqetësimin, zotëri, por unë mendova se ju e njihni krizën. Unë jam gati të mos e botoj këtë intervistë, po qe se ajo ju shkakton shumë emocione.

— Intervistën botojeni, djalosh, por duhet të jeni më i kujdesshëm në bisedë, për të mos thënë më i kulturuar. Ç'mjeshtër i fjalës jeni ju, kur s'jeni në gjendje të zëvendësoni një emër apo fjalë me diçka tjetër më të përshtatshme?

— Si?

— Ja, për shembull, a nuk do të tingëllonte më bukur e më saktë, në qoftë se në vend të fjalës «krizë» do të përdornit fjalët «Gjendje jo-alarmante»?

— Keni plotësisht të drejtë, zoti Big, — i tha-
shë unë. — Ju jepni një recetë të mrekullueshme
dhe tregoni rrugëdalje të vërtetë, jo vetëm për
krizën, por edhe për shumë fatkeqësi të tjera që
mund t'u ndodhin njerëzve. Ja, ta zemë se ju
merrni një telegram ku thuhet se ju ka vdekur
vjehera. Ju, sigurisht, nuk do t'ia thoni gruas
troç e pa ceremoni: «Dëgjo këtu, Laura! Ti ta-
ni nuk ke më mama!» Përkundrazi, ju do t'i flis-
ni asaj afërsisht kështu: «Laura e dashur! Mama-
ja jote është jo krejtësisht e gjallë. Ajo ka bërë
një pushim të shkurtër në rrugën e gjatë të je-
tës. Gjendje joalarmante!» Apo jo?

Bashkëbiseduesi im tashmë nuk po i ndiqte
fare fjalët e mia. Kishte rënë në një gjendje «jo-
krejtësisht të gjallë». Sytë i kishte gjysmë të ha-
pur, po, me siguri, nuk shikonte. Nisi të gërhis-
te. Unë përfitova nga kjo «gjendje joalarmante»
dhe u largova.

DUEL NË EKTRANIN BLU

Spektatorët e televizionit qenë njoftuar me kohë për duelin e madh që do të zhvillohej në ekranin blu, midis kryetarit të Partisë Kristian-demokrate dhe atij të Partisë Socialkristiane. Ata do të ballafaqonin para kombit programet e partive të tyre dhe do t'u tregonin zgjedhësve se si duhet të jetë qeveria e ardhshme.

Në orën e caktuar perdja u hap. Në studion e televizionit qëndrojnë përballë njëri-tjetrit dy rivalët kryesorë të dramës dy burra të veshur shik, me fytyra të lëmuara e të púdrosura, tamam si ata që reklamojnë sapunin. Ata i buzëqeshin njëri-tjetrit me një mirësjellje të ëmbël e të studiuar deri në hollësinë më të vogël dhe pastaj futin dorën në xhep për të nxjerrë fjalimet e tyre. Kryetari i Kristiandemokrates, zoti Shulc, nxjerr nga xhepi fjalimin e vet dhe e vë mbi tryezë. Rivali i tij nga Partia Socialkristiane, zoti Pulc, fut dorën herë në njërin xhep e herë në tjetrin dhe, sa hap e mbyll sytë, vrenjtet në fytyrë. Ai e ka harruar fjalimin në shtëpi!

— Mos u shqetësoni, i nderuar koleg, — i thotë zoti Shulc rivalit të vet Pulc, — fjalimin tim unë e kam në dy kopje dhe njërin mund t'ju jap juve me gjithë qejf.

— Ju jam shumë mirënjohës, zoti Shulc, — përgjigjet i lehtësuar kundërshtari nga Partia

Socialkristiane. — Ju falënderoj, gjithashtu, edhe në emër të telespektatorëve, të cilët po presin me padurim të mësojnë programet tona të kundërta. Prandaj fillojmë.

— Kush do të flasë i pari, — pyet Shulci.

— Flisni ju, — përgjigjet Pulci. — Unë dëshiroj të flas i fundit.

— Aaa! Këtu nuk mund të lëshoj pe. Ai që flet i fundit, fiton supremaci mbi kundërshtarin, sepse lë përshtypje më të freskët te dëgjuesi. Unë ju dhashë fjalimin, prandaj duhet të më lejoni të zgjedh radhën, — ngul këmbë ai i Kristiandemokrates.

Çështja se kush do ta lexonte fjalimin i fundit mori zjarr. Mirëpo, kur debati arriti në pikën më të rrezikshme, kryetari i Socialkristianes bëri një lëshim në interes të unitetit të kombit: ai propozoi që paragrafi i fundit të lexohej në kor nga të dyja partitë.

Arritja e këtij kompromisi, në interes të kombit, bëri që punonjësit e televizionit që ndodheshin në studio të merrnin frymë lirisht. Ndërsa një spektator, që po e ndiqte me vëmendje këtë skenë, pyeti shokun që kishte pranë:

— Mirë, po ndryshimet midis dy partive ku shkuan?

— Ndryshimet dihen që prej kohësh dhe s'ka nevojë të përsëriten, — përgjigjet tjetri. — E vure re si u paraqitën zoti Shulc dhe zoti Pulc?

— Po!

— Atëherë do të kesh vënë re se partia e zotit Shulc e vë Krishtin para, ndërsa partia e zotit Pulc, prapa. Çfarë ndryshimesh të tjera kërkon ti?!

NGJASHMËRIA

— Ç'kemi, Abraham, si e kalove sot? — e pyeti pemëshitësi Isak djalit e vet dhjetëvjeçar, kur u kthye nga shkolla.

— Zhurmë e madhe, baba, — u përgjigj djalit. — Kur po vija për në shtëpi, në rrugën «Goldman» qenë grumbulluar mijëra njerëz dhe thërritnin «kriminelin», «vrasësin», «turp». Demonstruesit kishin rrethuar një veturë dhe nuk e lirin të kalonte. Disa qëlluan dhe me gurë. Policia mezi e shpëtoi atë që ishte brenda.

— Policia shpëtoi kriminelin?!

— Po, po, policët ishin bërë gardh rreth makinës së kriminelit dhe u kishin vënë gjoksin demonstruesve që thërritnin «vrasësin në litar!»

— Si e quanin vrasësin?

— Nuk e di, unë dëgjoja vetëm fjalët kriminel e vrasës. Dikush thoshte se ai ka vrarë qindra veta, duke djegur shtëpi me gjithë njerëzit brenda. Çfarë nuk thoshin për të. Njëri thërriste Libani, të tjerë Galilea.

— Mos ka qenë gjeneral Sharoni, ministri i Mbrojtjes?

— Nuk e di. Ndoshta Sharoni ishte, por...

— Po si ishte në pamjen e jashtme?

— Me trup mesatar, sytë i kishte si të maces.

— A, jo. Nuk mundet të ketë qenë Sharoni, ai

është trupmadh dhe fytyrën e ka si të kalit. Si the? Sytë si të maces?

— Po, sytë si të maces, e pashë fare afër, se turma më mori me vete dhe më përplasi te gardhi i policëve, pranë makinës së kriminelit.

— Do të ketë qenë gjeneral Navoni. Të gjithë thonë se Navoni e dha urdhrin t'i thernin me bajonetë fëmijët e një shkolle në kampin palestinez.

— Ai që pashë unë, nuk mbante rroba ushtarake, qe veshur civil.

— Atëherë do të ketë qenë ministri Gug ai që para disa muajsh zhduku një fshat të tërë në Galile. Ai ka një kokë katrore dhe veshë të mëdhenj.

— Kokën nuk e kishte dhe aq katrore, më duket, megjithëse ishte si bullafiq, me dy gusha dhe sy të futur thellë si të derrkucit.

— Ti po më ngatërron fare, Abraham. Ai që më përshkruan ti është ambasadori amerikan, që e pamë mbrëmë në televizor.

— Ndóshta. Sot unë e pashë pa kapelë. Edhe gjyzlykët ia kishin thyer. Në duar mbante skeletin e tyre.

— Kishte dhe gjyzlykë?

— Po, me skelet ari.

— Po ndonjë shenjë tjetër karakteristike?

— Ishte veshur me kostum të ri blu; buzët të fryra si petull, dhëmbët pak të dalë... ishte tullac.

— Domethënë edhe me gjyzlykë edhe tullac? Po pse nuk ma the që në fillim, Abraham? Ai ka qenë vetë Begini, kryeministri!



TARTABIQET NËN TRYEZË

— Dëgjo këtu, Kolja! Ti prodhon nga ato marifetet e tua me bollëk për të tjerët, ndërsa nën hundët tona vëlojnë shturja e thashethemet.

— Ashtu është, Vasili Pavloviç, për të tjerët bëjmë, po për vete s'kemi menduar asgjë. Ju jeni drejtori dhe, po të më urdhëroni...

— Që sot! Çfarë duhet pritur? Nga lart është thënë troç: disiplinë dhe rregull! E lexove fjalinë e fundit?

— E lexova, por...

— Çfarë por...? Si thotë ai?

— Dëgjuar e kam, por...

— Keq, Kolja, shumë keq që nuk e ke lexuar me vëmendje. Ti je kryeinxhinier dhe, kur flet udhëheqja e lartë, në këtu poshtë duhet t'i vëmë gishtin kokës. E kupton?

— E kuptoj, shoku Glebov. Ju jeni drejtori...

— Drejtori, drejtori, po ti duhet të bësh prozime konkrete. Pastaj di unë...

— Çfarë konkretisht, shoku Glebov?

— Konkretisht, instituti ynë projektton dhjetëra lloje aparatësh të fshehta dëgjimi. Po? Prodhon! Pse t'i përdorin të tjerët, e ne të mos i shfrytëzojmë për të vënë rregull në shtëpinë tonë? Duhet apo s'duhet të kemi rregull në shtëpinë tonë?

— Duhet, shoku drejtor, patjetër duhet, por kemi frikë se aparatet e dëgjimit e të shikimit s'do të na ndihmojnë. Ato do të vihen në mënyrë të fshehur, apo jo?

— Në fillim fshehur, pastaj edhe hapur, si të jetë e nevojshme...

— Ku mendoni t'i vëmë, Vasili Pavloviç?

— Kudo: në hyrje, në dalje, në mensë, kudo që flitet e punohet. Më kupton?

Të nesërmen e kësaj bisede në institut filloi instalimi i aparateve të fshehta të dëgjimit e të shikimit.

Pas një jave, drejtor Glebovi, thërret kryeinxhinierin, i cili duhet t'i raportojë për rezultatet e vëzhgimeve.

— Ej, kryeinxhinier, çfarë tregojnë ato marifetet e tua? Pa na thuaj njëherë, çfarë flitet e dëgjohet?

— Cilin shirit dëshironi të dëgjoni, shoku drejtor?

— Cilin të duash, Kolja. Merri me radhë.

— Ja, ky shirit është marrë në tryezën numër 4, në mensë, dhe në mëngjes. Është biseda e dy teknikëve të mesëm Alehin dhe Jurkov:

— E, Jura, do flasësh nesër në mbledhjen vjetore? Plasja drejt e në fytyrë, t'i vijë mendja vërdallë.

— Je në vete?! E di ç'do të thotë të kritikosh drejtorin tonë?

— Jura, ti grua s'ke, fëmijë s'ke çfarë mund të të bëjnë...

— Komplot! — thirri Vasili Pavlloviç. — Ço-je menjëherë në instancat më të larta dhe...

— Ka edhe më, Vasili Pavlloviç, ta dëgjoj-më edhe më tej?

— E dëgjojmë, e dëgjojmë, por edhe kaq mjafton. Duan të më sulmojnë në mbledhje, kurdisin komplot prapa krahëve...

— Mirë, Aljoshë, do të flas! Çfarë të duan le të më bëjnë, po nga t'ia filloj?

— Mjastojnë vetëm dy-tri gjëra. E para, rushfeti prej një mijë rublash nga tre vetat që nisi jashtë shtetit për eksperiencë, e dyta, dy nipat e tij që marrin rrogën këtu, ndonëse nuk i ka parë kurrkush të vijnë në punë, e treta...

— Mjaft, Kolja, stop. Zhduke!

— Të mos e dërgoj lart?

— Zhduke të thashë, dhe thuaji shokut Vasili-iev, që merret me këto punë, t'i thërresë veçmas, e di vetë ai. Vazhdojmë me incizimet e tjera!

— Këtu është tryeza numër 5, në kohën e drekës, dje. Emrat do t'i gjejnë më vonë.

— E more vesh ti?

— Çfarë?

— Kanë filluar të kontrollojnë pasaportat në-për qytet.

— Pse?

— Për të gjetur ata që ikin nga puna.

— Sigurisht, kur të shket nga duart ekonomia, duhet të kapesh te policia.

— Policia tani është vënë në krye fare, në Kremlin.

— Mbylle, Vasja...

— E qartë, Kolja. Ndaje mënjanë. Ata marrin nëpër gojë udhëheqjen e lartë. Dërgoje ku duhet. Tjetrin...

— Ky shirit është incizuar në byronë teknike. Edhe ata llapin shumë, shoku drejtor.

— Kundër kujt?

— Kundër të gjithëve.

— Pa ta dëgjojmë njëherë.

— Ore, kanë filluar të vënë tartabiqe edhe te ne.

— Çfarë tartabiqesh?

— Ata pra, magnetofonat e vëzhgimit.

— Aha, kush ta tha?

— Vania i kishte parë mbrëmë kur ishte dezurn.

— Ku, në dhomën e dezurnit i kishin vënë?

— Atje i kanë vënë me kohë. Mbrëmë i kishte parë në sallën e mbledhjeve.

— Mos e bisedo me njeri... Çfarë do të hash ti?

— Mjaft, kryeinxhinier! — u hodh drejtori.

— Ju kam thënë edhe herë të tjera, ju s'dini të punoni. Pa i instaluar akoma, e morën vesh të gjithë. Ndaje mënjanë dhe dërgoje lart!

— Mirë, shoku drejtor, po atje mund të mendojnë keq për institutin tonë. Do të thonë se qenka qelbur puna në institutin e shokut Glebov.

— Edhe ashtu mund të thonë, po ne zbatojmë urdhrat. Po pse të mos thonë edhe kështu: Ja një drejtor i dalluar! Shoku Glebov e ka gjendjen në dorë në të gjitha drejtimet. Ai di se ç'bëhet e ç'thuhet në institutin e tij dhe jo si disa të tjerë, që e marrin vesh komplotin vetëm kur u pëlçet.

— Kjo është e drejtë, sigurisht. Mos vallë duhen njoftuar edhe ata të gazetës të shkruajnë diçka? Ja një përvojë e përparuar.

— Pse të mos shkruajnë? Ne zbatojmë direktivat. Dhe direktivat duhet t'i zbatojnë të gjithë.



GRINDITJE ME GJURIM E FAMILIARIT

Një njëvojë të Pëlmës ndodhi një punë
je e jashtëzakonshme. Sekretari i parë i parti-
së revisioniste të vojvodës Bozinski, u shpall
me famullitarin e kishës Popinaki.
Një gjatëkohë të ashpër, midis tyre u zhvill-
hua ky dialog:
Popinaki — O do të bësh ashtu siç të thashë,
e tani nuk do të të pranohet më meshën e mëbrëmjes!
Bozinski — Në qoftë se ti nuk më pranohet
më meshën e mëbrëmjes, tani nuk të pranohet
kruajtja e kishës.
Popinaki — Po nuk më pagove kruajtjen e kishës,
tani nuk të lejohet mëbrëmja në mënyrë të zakonshme
kruajtja procedurorë të të shpallur.
Bozinski — Po de se e bën edhe këtë, tani
nuk do të botoj në gazetën time meshën tënde.



GRINDJE NË GJIRIN E FAMILJES

Në një vojvodë të Pōlonisë ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme. Sekretari i parë i partisë revizioniste të vojvodës, Bozhinski, u grind me famullitarin e kishës, Popinskin.

Në gjaknxehtësi e sipër, midis tyre u zhvillua ky dialog:

Popinski — O do të bësh ashtu siç të thashë, o unë nuk do të të pranoj në meshën e mbrëmjes!

Bozhinski — Në qoftë se ti nuk më pranon në meshën e mbrëmjes, unë nuk të paguaj kuotën e kishës.

Popinski — Po nuk më pagove kuotën e kishës, unë nuk të lejoj të mbash flamurin me kryq gjatë procesionit fetar të së dielës.

Bozhinski — Po qe se e bën edhe këtë, unë nuk do ta botoj në gazetën time meshën tënde.

Popinski — Ti nuk ma boton meshën time, po unë nuk do t'i pagëzoj fëmijët e tu dhe gruan tuaj nuk do ta pranoj të rrëfëhet.

Bozhinski — Në qoftë se ti nuk m'i pagëzon fëmijët, unë do t'i çoj ata në një kishë të Varshavës.

Popinski — Ti i çon në një kishë tjetër për t'u rrëfyer e për t'u pagëzuar, po unë nuk do t'ju spërkat me ujë të bekuar me rastin e krishtilindjeve.

Bozhinski — Ti nuk më spërkat me ujë të bekuar, por unë do të urdhëroj uzinën e instrumenteve që të mos prodhojë më kryqe metalike.

Popinski — Po bëre këtë, unë do të bëj thirrje për grevë dhe do ta mbyll uzinën fare.

Bozhinski — Po e mbylle uzinën, unë do ta shtroj çështjen tënde në byronë e partisë.

Popinski — Po e shtrove çështjen time në byronë e partisë, unë do të ndërhyj që ti të mos zgjidhesh më sekretar i parë.

Bozhinski — Ti nuk më zgjedh më sekretar të parë, po unë do të ankojem te papa në Romë.

Popinski — Ti i drejtohesh papës në Romë, po unë s'kam për të të marrë kurrë me vete për pelegrinazh në Vatikan.

Bozhinski — Po nuk më more me vete në Vatikan, unë nuk do t'i lejoj as instruktorët e komitetit të partisë të të ndihmojnë si xhakonj në meshën e së dielës.

Popinski — Po qe se ti do të marrësh një masë të tillë, unë nuk do të t'i shkruaj më fjalimet e tua as për 1 Majin dhe as për kongreset e partisë sate.

Këtu Bozhinski u dorëzua!



NASTRADINI NË JERUSALEM

Aty në të ngrysur, në portat e Jerusalemit u paraqit një udhëtar i hipur mbi gomar. Udhë-tari qe veshur me xhybe e çallmë të bardhë dhe ishte pluhurosur nga rruga e gjatë nëpër shkretëtirë.

Te portat e qytetit e ndaluan rojat, të veshura me uniformën verore ngjyrë gri. Ato mbanin në duar disa armë të vogla e të çuditshme, që udhë-tari nuk i kishte parë asnjëherë.

— Kush jeni? — e pyeti komandanti i rojave.

— Hoxhë Nastradini, — tha udhëtar.

— Prej nga vini?

— Nga udhë të largëta.

— Nga cili vend jeni?

— I këtyre anëve jam.

— Prej cilit vend, po ju pyes?! — nguli këmbë njeriu me uniformë të huaj.

— Pse, ky nuk është Jerusalemi i arabëve? Mua këtu më njohin të gjithë, — tha Nastradini me qetësi.

— Jerusalemi s'është i arabëve, — shpjegoi i huaji.

Nastradini heshti për një çast dhe ngriti kokën drejt qiellit. Për herë të parë ai po dëgjon-te edhe për një Jerusalem që nuk qenkësh i arabëve. Dy Jerusaleme, vallë, apo... Hoxha kishte udhëtuar për një kohë të gjatë dhe s'po kuptonte se çfarë kishte ndodhur gjatë mungesës së tij.

— Çfarë kërkonti?

— Asgjë. Dua të bredh nëpër qytet, — u përgjigj Nastradini.

— Është e ndaluar të bredhësh kot nëpër qytet.

Rreshteri vështroi me kureshtje hejbet e varura në të dyja anët e samarit të gomarit dhe gjithçka iu duk e dyshimtë.

— Çfarë ka në ato torba?

— Gjëra të domosdoshme për një udhëtar si unë, — tha Nastradini.

Rreshteri u dha shenjë me dorë dy ushtarëve që rrinin në gatishmëri. Ushtarët vrapuan drejt Nastradinit dhe i vunë hekurat në duar.

— Ç'është kështu? — thirri Nastradini me zemërim.

— Do ta marrësh vesh.

— Po gomari?

— Gomari sekuestrohet për nevojat e ushtrisë izraelite! — i thanë ushtarët.

«Për allah, s'po marr vesh asgjë, — tha Nastradini me vetë. — Ku janë arabët, xhanëm?»

Nastradinin e futën në një makinë ushtarake. Nga një dritare, e vogël me rrjetë teli ai shihte minaret, rrugicat, të gjitha të njohura për të dhe aty-këtu ndonjë banor me çallmë. Kur iu afruan

pazarit të qytetit, i cili qe i mbyllur, ai pa një grumbull njerëzish që thërritnin dhe tundnin flamurë e parulla. Pa makina zjarrfikëse, policë me helmata e maska në fytyrë, tanke, që kishin bllokuar të gjithë sheshin.

Të nesërmen, si Nastradin që ishte, mundi t'u ikte rrojave të burgut dhe u gjend në mes të qytetit. Këtë radhë i veshur me kostum evropian. Zuri të shëtiste rrugicave të ngushta, shihte nëpër vitrina shtamat, qypat, qilimat, ibrikët e bakrit, xhybet, çallmat... Po, ky ishte Jerusalemi që ai e njihte prej kohësh.

Nastradini dëgjon hapin e rregullt të patrullës që i vjen nga pas. Njëri nga policët i vë dorën në sup.

— Më falni, amerikan jeni?

Hoxha ktheu kokën. U zbeh në fytyrë, por aty për aty e mblodhi veten.

— Po, amerikan. Turist.

— Na vjen keq, zotëri, por nuk lejohet... — tha njëri nga policët me mirësjellje.

— Çfarë nuk lejohet?

— Ne kemi përgjegjësi për jetën tuaj. Të dilni kështu i vetëm nëpër rrugë në një qytet armiqësor si ky...

— Më falni, po... pse armiqësor? Nuk është qyteti ynë ky?

— Kur keni ardhur, zotëri?

— Dje.

— E po është e kuptueshme. Ju nuk e njihni vendin, prandaj flisni kështu. Ne kemi përgjegjësi për sigurimin e miqve që vijnë nga Amerika.

— Po unë...

— Jo, jo, zotëri, në asnjë mënyrë nuk ju lëmë dot vetëm. Këtu mund të ndodhin gjëra të tmerrshme. Ju lutemi, kthehuni menjëherë në hotel.

— Ju falënderoj për kujdesin, ja tani po kthehem, sa të blej disa llokume tek ai arabi me kanisler në trotuarin tjetër, — tha turisti.

— Llokume?! Në asnjë mënyrë! Sidomos llokumet janë tepër të rrezikshme. Me llokume janë hedhur në erë shtabe e kazerma të tëra kohët e fundit. Ju kujtoni se blini llokume, por ato mund të jenë dinamit!

— Dinamit?! Sa i tmerrshëm qenka llokumi i këtushëm! — tha Nastradini turisti.

— Tepër i tmerrshëm! Ju nuk i njihni arabët. Gjithçka këtu është e rrezikshme.

— Atëherë, si rrini ju këtu?

— Me ndihmën tuaj, zotëri, me ndihmën e ushtarëve e të armëve tuaja. Po dhe ata...

— Edhe ata sikur nuk e ndiejnë veten mirë, ë... Kam marrë vesh se atje në Liban...

— Kërdia është bërë. Ja, me ato llokumet që dëshët të blinit ju. Oh, ç'na kanë parë sytë.

— Mos duhet hedhur poshtë edhe kjo?

— Çfarë është ajo?

— Ja, kjo kuti e vogël me arabeska të gdhendura në metal. Ma dha një arab i mbështjellë me çallmë dhe u zhduk. Na, tha, merrë. Dhe u zhduk papritur të marrë as paratë.

— Hidhe tutje, zotëri! Po merrni veten më qafë. Bombë me sahat!

Policët ia mbathën me vrap dhe u strukën në qoshen e dyqaneve njëkatëshe.

«Gjenë mirë, — tha me vete Nastradini, — kjo do të thotë se Jerusalemi vazhdon të jetë arab.»

LITARI

Aeroporti ndërkombëtar i Londrës.

— Përshëndetje, koleg! Nga vjen kështu?

— Nga Libani.

— Vapë e madhe, ë?

— Ç'ti bësh. Detyra e korrespondentit kështu e ka.

— Ç'të reja kemi andej?

— Ç'pyet!

— Si mendon, koleg, ç'kanë ndër mend të bëjnë më tej izraelitët në Liban?

— Thonë se ushtria e tyre qëndron dhe do të qëndrojë atje për të ruajtur rregullin.

— Për këtë punë sikur janë dërguar trupa amerikane, apo jo?

— Trupat amerikane kanë shkuar atje për të ruajtur trupat izraelite.

— Po amerikanët, kush i ruan?

— Thonë se pikërisht për këtë qëllim qenka dërguar atje ushtria italiane.

— A thua janë të kënaqur amerikanët me mbrojtjen e ushtrisë italiane?

— Besoj se po, pasi edhe vetë italianët ruhen nga repartet e ushtrisë franceze.

— Po francezët, kush i mbron?

— Francezët ruhen nga reparte të posaçme të ushtrisë angleze.

— Jam kurioz të di se kush është ngarkuar me ruajtjen e anglezëve?

— Ata i mbron ushtria izraelite.

— Ju po më vërtitni në një rreth të mbyllur, i dashur koleg.

— Në të kundërt, mua më duket se kjo është një lojë mjaft e hapur.

— Që këtu ka një lojë, e kuptoj, po cilat janë rregullat e kësaj, këtë nuk e kam shumë të qartë.

— Atë ta shpjegoj unë. Kjo është një lojë e thjeshtë me litar.

— Hidhen mbi të?

— Jo, secili pjesëmarrës e hedh litarin në qafë të vet dhe pastaj të gjithë tërheqin njëri-tjetrin.

DITA JUBILARE

Mëgjithëse kjo ishte një ditë jubilarë, festive, zëdhënësi i bisedimeve për çarmatimin në Gjenevë, njëfarë Tamtam, të jepte përshtypjen e një njeriu që sapo është zgjuar nga gjumi. Fytyra e tij shprehte një gjendje shpirtërore as luftë as paqe.

— Si po vazhdojnë bisedimet tuaja? — e pyes.

— Janë ndërprerë!

— Gjatë këtyre njëzet muajve, çfarë rezultatesh janë arritur?

— Më mirë ejani në shtator! — ma preu shkurt.

«Më la për vjeshtë», thashë me vete dhe iu drejtova përsëri zëdhënësit:

— Mos vallë kjo do të thotë se në shtator do të shpallen rezultatet?

— Në shtator do të fillojmë nga e para.

— Po rezultatet e njëzet muajve?

— Cilat rezultate?

— Mbledhjet tuaja, fjalimet...

— Më falni, zotëri, ju po më dukeni disi naiv, — tha zëdhënësi me mirësjellje dhe duke fshirë sytë. — Në qarqet e bisedimeve tona edhe optimistët më të mëdhenj mendojnë se për rezultate konkrete as që mund të flitet përpara, të paktën, njëzet vjetve. Ndërsa ju i dashkeni gjërat për njëzet muaj!...

— Po në qoftë se raketat për të cilat bisedoni tani, pas njëzet vjetve do të jenë zëvendësuar me të reja...

— Aq më mirë për bisedimet tona. Kjo do të thotë se ne ia kemi arritur qëllimit. Raketa të reja, bisedime të reja.

— Më falni, po unë s'po kuptoj: e cni ju pas raketave apo raketat ecin pas jush?

— Sigurisht në ecim pas raketave. Si mund të ecet përpara tyre?

— Tani kam një pyetje jozyrtare, — i thashë. — Si e vrisni kohën këtu, në brigjet e liqëneve të Gjenevës, a nuk mërziteni?

— Ky është një problem i përhershëm për ne. Për më tepër askush nuk na e qan hallin!

— Pse nuk mërreni me gjah?

— Ne e kemi krejt të ndaluar përdorimin e armëve.

— As të ftohta?

— Vetëm grepat për zënieën e peshkut.

— A kapni gjë?

— Nuk ankohe mi. Në konstatojmë se peshq ka boll, nga të gjitha llojet.

Pasi i shoshitëm të gjitha llojet e peshqve që bien në grepat e bashkëbiseduesve të Gjenevës, shkova të takoja zëdhënësin e secilit delegacion, veç e veç.

Në fillim iu drejtova zotit Bam, zëdhënës i delegacionit amerikan. Ai u mundua të më shpjegonte qartë dhe shkurt, me këto fjalë, platformën e tij:

«Mua më digjet zemra për armatimin. Dhe dashuria ime për armët vjen nga dëshira për t'i hedhur poshtë ato. Armatimi dhe çarmatimi janë të lidhura aq ngushtë, sa pothuaj janë e njëjta gjë. E si mund të çarmatoshesh, kur nuk ke armë

për t'i hedhur poshtë? Shumë lehtë mund të thuhet: kufizoni raketat, shkurtoni raketat, hiqni raketat! Mirë, të gjitha do të bëhen! Por, ama, na lini njëherë t'i prodhojmë e t'i vendosim ato dhe pastaj t'i heqim, t'i shkurtojmë e të bëjmë çfarë të dëshironi ju. Si u hiqkan raketat, kur ato nuk i kemi vënë akoma? Si mund të thuhet se rrepa është e hidhur, pa e provuar shijen e saj?

Pastaj... po ekuilibri? As pehlivani në tel nuk qëndron dot po nuk ruajti ekuilibrin. Si thoni ju, zotëri, pala kundërshtare të ketë një mijë e një raketa, ndërsa unë vetëm një mijë? Në asnjë mënyrë. Po, le t'i zhdukim të tëra! Ne jemi plotësisht dakord që tri ditë pasi pala tjetër t'i ketë zhdukur të gjitha raketat e veta, t'i zhdukim edhe ne raketat tona. A ka mirëkuptim e vullnet më të mirë se ky?»

Zëdhënësi sovjetik, gospodin Bum, e parashtrroi qëndrimin e vet në këtë mënyrë:

«Po ta hapni zemrën time, ju nuk do të gjeni atje asnjë armë. S'di të fshehta unë. Armët as që dua t'i shoh me sy, prandaj gjithnjë i gropos në tunele e në puse të thella. Unë jam kundër raketave, topave, kryqëzorëve dhe gjithçkaje që bën bum, por, ama, edhe unë nuk mund të heq dorë nga ekuilibri. Jam plotësisht dakord me propozimet e palës tjetër: tri ditë pasi t'i ketë shkatërruar raketat e veta pala amerikane, jam gati t'i shkatërroj edhe unë të miat. Ka propozim më konkret e më të arsyeshëm?»

Gospodin Bumi buzëqeshi i kënaqur. Dukej qartë se ai po priste edhe komentet e mia. Unë i thashë:

— Përderisa të dyja palët kundërshtare janë dakord t'i zhdukim apo kufizojnë raketat tri ditë pasi ta ketë bërë këtë veprim pala tjetër, perspektiva është shumë e qartë!

PAMJE E ÇUDITSHME

Nëpër rrugët e Tel-Avivit po kalonte një procesion i jashtëzakonshëm. Qe shfaqur pamja më e çuditshme dhe më e frikshme që mund të mendohet. Dy ushtarë kalonin përmes qytetit duke mbajtur një barelë. Ushtarët kishin këmbë, kishin trup, kishin uniformë dhe armë, por nuk kishin koka. O qiell e tokë! Si ishte e mundur?! Pushkët me bajoneta zgjatëshin mbi supet e tyre, ndërsa vendi, ku dikur kishte qenë koka, rrafshohej me supin!

«Si është e mundur që ata të ecin pa kokë? Ku e kanë kokën? Oh, pa dale njëherë! — thirri dikush me lemeri. — Ata i paskan kokat, po jo mbi supe! Kokat i kanë vënë mbi barelë dhe po i transportojnë diku. Për ku kështu? Me siguri atje ku çohen të gjitha kokat e prera! Njeriu transporton kokën e vet të prerë! A ka gjë më të llahtarshme?...»

— Abram! Abram!

Koloneli Abram Leshkoviçi shtyu derën me forcë dhe u gjend në dhomën e gjumit të zotërisë së tij. Kryeministri Menahem Begin gulçonte me të madhe, pulsi i rrihte me forcë e mezi ngopej me frymë. Fytyra i shprehte lebeti.

— Ku jemi, Abram? — thërriste Begini dhe fjalët i thoshte të shkëputura.

— Në dhomën e gjumit, zoti kryeministër. Qetësohuni, asgjë s'ka ndodhur.

— Shkuan?... kaluan?... u zhdukën?...

— Cilët, zoti kryeministër?

— Ushtarët me koka të prera... barela...

— Të gjitha kokat e prera i kemi zhdukur, zoti kryeministër. Ju lutem, mos u shqetësoni!

— Ata ecin... ata kalojnë nëpër rrugë... O perëndi! Ishte ëndërr apo...

— Ëndërr, zoti kryeministër, ëndërr, me siguri. Këtu s'kemi asnjë kokë të prerë. Ja, të gjithë i kemi kokat, edhe unë, edhe ju, edhe rojat, ja...

— E pamundur! Unë i pashë vetë! Ku e kam kokën? O, më dhemb koka!

— Kjo do të thotë se kokën, e keni, zoti kryeministër. Derisa ju dhemb...

— Jo unë, Abram, po ato kokat e prera, çfarë paralajmërojnë ëndrrat me koka të prera?

— Asgjë, zoti kryeministër, asgjë. Koka të prera dhe asgjë tjetër.

— Ku janë tani ata?

— Ata kanë shkuar, zotëri, janë larguar, nuk ju bëjnë asgjë.

— O tmerr! I kishin vënë kokat në barelë dhe...

— Ushtarët e kujt ishin, zoti kryeministër?

— Nuk i njoha. Uniformat nuk dalloheshin mirë. Me siguri ushtarët tanë në Liban do të kenë qenë.


— Në Liban mundet, zotëri. Me siguri në Liban. Atje ua kanë prerë kokat disa ushtarëve, po... duhen parë uniformat. Atje s'janë vetëm ushtarët izraelitë, atje ka dhe amerikanë, anglezë, francezë...

— Ndoshta, ndoshta, po uniformat duhet të

kenë qenë tonat. Prandaj urdhëroj të kontrollohen të gjithë ministrat, shtabet dhe ushtarët nëse i kanë apo nuk i kanë kokat mbi supe.

Begini përsëri ra në kllapi. Atij nisën t'i gu-mëzhinin veshët nga britmat e pakuptueshme dhe zuri të thërriste me të madhe: «Kokat! Ku janë kokat?»

Midis rrëmujës, që i vlonte në veshë, ai dalloj një zë që vinte nga larg e që i tha: «Kokat i keni në torbë, zoti Begin!»



MUZEU I FIGURINAVE PREJ PARAFINE

— Çfarë keni në këtë arkë? — pyeti nëpunësi i doganës në aeroportin e Londrës.

— Vepër arti, zotëri.

— Nga vini?

— Nga Jerusalemi.

— Ndalohet si eksportimi, ashtu edhe importimi i tyre, — tha doganieri.

— Është shitur, zotërinj. Kemi dokumente.

— Kujt i është shitur?

— Muzeut të figurinave prej parafine. Urdhëroni faturën!

— Hapeni arkën!

Doganierët nxorën nga arka një statujë prej parafine të Menahem Beginit, në madhësinë natyrale: shkurtabiq, me kokën tullë, hundë të shtypur, buzë të holla si prej fallxheshe.

— Ju thatë se është vepër arti! — u habitën nëpunësit e doganës.

— Ashtu është, zotërinj. Vepër arti.

— Figurat prej parafinë nuk hyjnë në skulpturat e ndaluara. Çojeni ku të dëshironi, vetëm paguani taksën doganore. Ka kostum?

— Jo. E kemi shitur të zhveshur.

— Po ky këtu?

— Shkopi i tij.

— Original është?

— Jo, origjinali është amerikan, na e mbajtën në Jerusalem për pasardhësin e Beginit, gjeneralin Shamir.

— Përderisa s'është origjinal, për ne kjo s'ka asnjë rëndësi. Paguani dhe kaloni!

Në muzeun e figurave prej parafinë, ishët e epokave dhe origjinave të ndryshme vështrojnë njëri-tjetrin me sy të vagëlluar. Në masën viskoze të parafinës kanë ngrirë Henriku VIII, bashkë me të gjitha gratë e haremit të tij, Uinston Çerçilli dhe ish-presidenti amerikan Truman, që urdhëroi hedhjen e bombës atomike në Hiroshima, Makarturi, që përhapi mikrobet e kolerës gjatë Luftës së Korësë, prostituta, që kanë lënë emër në korridoret e errëta të parlamenteve evropiane, si edhe papa Piu XII.

— Ku ta vendosim? — pyeti njëri nga shërbyesit e muzeut, ndërsa po i shkonte një leckë në fytyrë ish-kryeministrit izraelit për t'i hequr pluhurin.

— Në katin e poshtëm! — urdhëroi kryekujdestari.

— Pranë Hitlerit, karshi Musolinit apo përbri Gëbelsit?

— Pranë Geringut! — tha kryekujdestari.

— Aty është tepër ngushtë, zotëri. Në të dy krahët e Geringut janë vënë dy ish-komandantë të Paktit të Atlantikut— Rixhuej dhe Grynter.

— Më duket se ka një vend bosh në qoshen midis papës dhe Makarturit.

— Po ky e paska njërën këmbë të thyer! — vuri re shërbyesi.

— Ngjiti një këmbë nga ato të rezervës! — urdhëroi kryekujdestari.

— Oho, edhe tjetra qenka në të këputur, ky s'qëndron dot në këmbë!

— Më lodhe, Bim! Hiqja' të dyja këmbët dhe ktheje në bust!

— Po ne të gjitha figurat i kemi në madhësi natyrale, zotëri. Kam frikë se do të duket keq një trup i cunguar, aq më tepër pranë papës!

— Atëherë fute në depo e të presim derisa të sjellin edhe zëvendësin e tij, Shamirin, — u dëgjua zëri i kryekujdestarit, që tashmë kishte kthyer shpinën e po zhdukej në gjysmëerrësirën që mbështille figurinat prej parafine.

— Më falni, zotëri, një minutë, ju lutem, nuk ju kuptova! — rendi shërbyesi pas përgjegjësit të tij.

— Do të bëjmë një shartim të zakonshëm dhe asgjë tjetër, — shpjegoi kryekujdestari në largim e sipër. — Torsin e Bëginit e vëmë mbi këmbët e Shamirit dhe atëherë do të kemi një statujë të plotë. Më kupton?

MONOLOGËT E RINJ

— Fjodor Fjodoroviç! — i drejtohet regjisori Bubnev njërit prej aktorëve. — Pa ta shohim njëherë, ku jemi me monologun e Sobakeviçit?

Aktori kollitet dy-tri herë, merr pozën e duhur skenike dhe fillon:

— Unë jam Sobakeviçi që e njihni të gjithë. Dhe shumë mirë që më njihni, po një gjë nuk e kuptoj: përse kudo më marrin shembull për të keq? Bleva ca muzhikë që as ekzistonin fare në këtë botë dhe vetëm kaq. Prej asaj dites'lenë rast pa më përmendur: frymët e vdekura këtu, frymët e vdekura atje. Në fund të fundit unë me të vdekurit u mora, por, ama, shikoni njëherë se ç'bëhet me të gjallët! S'është gjë hiç të nxjerrësh të ardhura nga të vdekurit, se ata as hanë, as pijnë, as ankohen. Po ta marrësh shtruar, atyre s'kanë ç'u duhen paratë, po si i bëhet hallit kur ua merr rrogat të gjallëve, siç bën drejtori i kombinatit ushqimor të qytetit tonë, Vasili Petroviçi? Do të hysh në punë? Paguaji Vasili Petroviçit tre muaj rrogë. Ndryshe s'të qas as te porta e ndërmarrjes. S'e besoni? Çfarë? Revizioni? Oho, revizioni ka ardhur disa herë, por gjithmonë e gjen në rregull. Di si ta lyejë rrotën Vasili Petroviç. S'ia ha qeni shkopin atij. Pastaj, ku të shkojë më parë revizioni? Drejtori i postës ka dy sekretare tepër në organikë dhe asnjërës nuk ia ka parë kush fy-

tyrën. Rrogat ecin. Drejtori bëri një daçë që të lot tepeleku i kokës! Njëzet mijë rubla doli deficit drejtori i depos së barnave, pse, thoni ju, i hyri ndonjë gjemb në këmbë apo pagoi ndonjë rubël për këtë? Pagoi, sigurisht, por vetëm nja dy mijë, atyre të financës, që erdhën nga qendra. Ja ç'pagoi! Dëshironi të vazhdoj më tej? Vetëm durim të keni e të më dëgjoni! Ju të gjithë e njihni zëvendësdrejtorin e uzinës së radiove, që është baxhanak me...

— Stop! Stop! Stop! — thirri regjisori. — Kujdes tekstin, Fjodor Fjodoroviç! Mos dil jashtë tij. Në kohën e Sobakeviçit nuk ka pasur uzinë radios. Radioja është shpikur më vonë.

— Atëherë sigurisht s'ka pasur radio, po ju vetë na keni thënë ta aktualizojmë shfaqjen.

— E di ti se ç'del nga kjo? — pyeti regjisori.

— E di. Asgjë s'del!

— Po policia nuk i dëgjon këta monologët e tu?

— Unë atë desha të them, që zëvendësdrejtori i uzinës së radiove, duke qenë baxhanak me shëfin e policisë...

— Mjaft, Fjodor Fjodoroviç! Deri këtu. Vazhdojmë me monologun e Nozdrevit. Filloni, Nikollai Vasileviç! Me gjallëri, ë? Nozdrevi është tipi i rrushfetciut me çizme, i papërmbajtur si dallaveraxhi. Filloni...!

— Alo! Ju jeni Aleksei Petroviç? Jam Nozdrevi.

— Stop, Nikollai Vasileviç! E nisët gabim. Edhe ju jashtë tekstit. Ku ka pasur telefon në kohën e «frymëve të vdekura?»

— Më falni, shoku regjisor, forca e zakonit!
— Kështu pra, Aleksei Petroviç nuk ka telefon. Ti je duke biseduar me atë sy ndër sy... Vazhdoni!

— I dashur Aleksei Petroviç, nesër do të vijë te ti Vasja, ti e njeh dhëndrin tim. Ka ca vështirësi për ndërtimin e daçës. I duhet material ndërtimi, ndonjë marangoz, e kupton vetë. S'ke mundësi?! Drejtori i përpunimit të drurit s'paska mundësi të ndërtojë dy dhoma e një verandë prej dërrase?!... Çfarë? Mall shteti? Ne të gjithë të shtetit jemi!... Gjepura! Ngado që të vërtiten, tek unë do të vijnë. Jam apo s'jam prokuror?... Si, ore, s'paske mundësi? Të tjerëve u ke dhënë pa hesap, ndërsa për mua s'paske mundësi? Mirë, mirë, këtu do të jemi! Hë, de, ashtu thua. E dija unë që ti s'e kthen Vasjen tim duarbosh. Dëgjo këtu! Si për vete, ë? Vasja sapo është kthyer nga jashtë dhe ka caktuar një pelice të shkëlqyer për mirëbërësin e tij. E kupton?... S'ke grua? «Kur kështu?!... Do të ta gjej unë. Biondinë, tridhjetë vjeçe, jeton në qendër, me të gjitha pajisjet... Burrin e ka, por e ndaj unë. Mjaf-ton gjysmë fjale nga ti... Duart i bëjnë flori... A, jo, jo, jo! Çfarë qëndisje? Ty s'të shkon kurrë ndër mend... Ajo... Nuk ta them... U bëre kurioz, ë? E po mirë de! Midis nesh! Ajo është parashikuese e shkëlqyeshme e fatit! Ja ç'është! Po jo nga ato të zakonshmet! Fenomen! Ja ç'është. Me letra, me filxhanë, në pëllëmbë të dorës... Sigurisht, edhe zili e kanë, letra kanë ardhur për të, po ti e di, prokuror jam vetë. Po, po, e sulmojnë, por edhe nevojën ia kanë. Klientë të rregullt të saj janë sekretari i parë, ata të komsomolit...

— Stop, stop, stop! — thirri regjisori. — Ne po flasim për «frymët e vdekura», të Gogolit apo për komsomolin? Ç'është kështu?

— Ju vetë na keni thënë se arti është pasqyrë e jetës, tavarish regjisori!

— Perdja! Uleni perden! — thirri regjisori.

MISTER KUKU — SHITBLERËS IDESH

Mister Kuku është sipërmarrës në fushën e botimeve letrare. Ai ka disa skuadra shkrimtarësh të pajuar, të cilët përshkruajnë vetëm ngjarje të krijuara siç thotë ai. Investimet në sipërmarrjen e tij e garantojnë fitimin shumë më mirë se investimet në industrinë e birrës apo të pluhurit të sapunit.

Te mister Kuku paraqiten shumë klientë të kategorive të ndryshme dhe i ofrojnë atij tema dhe ide për vepra letrare. Njëri prej tyre ishte edhe Xhim Shtefeni.

— Mister Kuk! Unë dua të shkruaj një roman bestseller¹⁾.

— Shkrimtar jeni?

— Jo.

— Me se merreni?

— Jam vrasës.

— Tepër interesante! Si rregull, tregimet e vrasësve e kanë të garantuar suksesin.

— Po unë s'di të shkruaj fare.

— Për këtë mos u bëni merak. Nuk dini të shkruani, por, me siguri, dini të tregoni. Me policinë jeni në rregull?

— Atë e kam rregulluar vetë. Jam liruar nga

1) Vepër që bën bujë në «shoqërinë e konsumit».

burgu me garanci. Por më parë desha të di se sa mund të fitoj me tregimet e mia.

— Kjo varet nga disa faktorë. Megjithatë kryesore është se cilin keni vrarë dhe si e keni vrarë. Ju mund të flisni për të gjitha rastet. Ato me siguri nuk i ngjajnë njëri-tjetrit. Në çdo rast është përdorur një teknikë e re. Apo jo?

— Sigurisht. Disa janë bërë me revole, disa me thikë në grykë, disa fare thjesht...

— Shumë bukur. Mjafton të tregoni se cila ka qenë vrasja më pikante.

Xhim Shtefeni hapi sytë. Ç'do të thotë vrasje pikante? Përfaqësuësi i trustit të botimeve «Xhons e Co» u shpjegua më qartë:

— Desha të them nga ato që emocionojnë më shumë, jo një vrasje e zakonshme, me revole, me bombë, por, për shembull...

— E kuptova, — u hodh Xhimi, — ju doni një vrasje të ngadalshme, me opium, me tel apo me një gjuajtje të thikës nga tridhjetë metra larg.

— Shumë bukur. Sidomos fëmijët tërhiqen shumë pas vrasjeve që kanë edhe aventurën brenda, e sidomos pas vrasjeve të mistershme. Një libër i tërë mund të shkruhet vetëm për maskat që keni përdorur, një libër tjetër për thikat e revole, një tjetër se si i hapni bravat e kasafortave... Puna është që ato të përshkruhen në mënyrë të jashtëzakonshme.

— Këtë do ta bëni ju, apo jo? — pyeti Xhimi.

— Sigurisht, ajo është puna jonë. Në trustin tonë punojnë nja gjashtëdhjetë shkrimtarë të pajtuar që merren me këto gjëra. Ju do të na jepni si të thuash, vetëm lëndën e parë, ne bëjmë punën, ndërsa libri do të dalë me emrin tuaj.

— Çfarë do të marr unë konkretisht?

— Kjo do të zgjidhet në mënyrë krejt të përshtatshme. Pranë trustit tonë ju do të keni avokatën personal që do të merret me mbrojtjen e interesave tuaja.

— Dhe konkretisht? — vazhdon të ngulë këmbë vrasësi.

— Para së gjithash, ju keni të drejtën e autorit. Si botues, unë nuk i kursej paratë kur është fjala për historira që e kapin lexuesin për grykë. E kuptoni? Lexuesi duhet mbërthyer në atë mënyrë, që të mos ketë mundësi të lëvizë.

— Sipas mendimit tim, kjo varet nga aftësia e shkrimtarit, të cilin do ta caktoni ju.

— Përkundrazi, kjo varet nga metoda e vrasjes. Në qoftë se ajo do të jetë tepër interesante, atëherë veprën do ta kërkojnë të gjitha revistat, me të cilat mund të lidhen kontrata të veçanta, që do të na japin shuma me pesë dhe gjashtë shifra. Më kuptoni?

— Ju kuptoj.

— Pasi të kemi përfunduar punën me revistat, ne do t'u drejtohem trusteve të gazetave.

— Po me televizionin, çfarë mund të bëhet?

— Edhe me televizionin do të kemi punë. Por atje shkojnë më shumë intervistat. Tani janë në modë intervistat e drejtpërdrejta me vrasësit, jo përmes tregimeve që i ka shkruar dikush tjetër. Pak a shumë kështu do të veprojmë edhe me ata të filmave. Ata pëlqejnë më tepër fshehtësinë e vrasjes, njëjat e pazgjidhshme, misteriozen. Para së gjithash, duhen dhënë dëshmi kontradiktore në gjyq, në mënyrë që çështjet të vijin duke u ndërlikuar nga një seri e filmit në tjetrën. Më kuptoni?

— Sigurisht.

— Më tej, ne do të merremi edhe me letrat që u dërgoje nga burgu bashkëpunëtorëve të fshehtë me të cilët ke kryer vrasjet.

— Unë s'kam shkruar kurrë letra dhe të gjitha vrasjet i kam kryer vetëm.

— S'ka asnjë rëndësi. Letrat i hartojnë shkrimtarët e mi. Me ato ne do të botojmë një libër më vete. Dikur kanë qenë në modë letrat e dashurisë, sot letrat e vrasësve profesionistë kërkojnë tri herë më shumë.

— Këtë as që e kisha menduar.

— Me siguri ju nuk keni menduar edhe shumë gjëra të tjera. Ju mund të mos keni menduar as për botimin e tregimeve të gruas suaj, të cilat mund të shiten veçmas.

— Ajo më ka ndarë prej kohësh.

— Kjo do të thotë se ju dikur keni qenë të bashkuar. Aq më mirë që jeni ndarë, sepse kjo u shton elemente të reja tregimeve të saj. Pastaj, ju me siguri keni pasur edhe mama, edhe gjyshe. Diçka nga historia e tyre, nga peripecitë...

— Ato kanë vdekur prej kohësh.

— Mrekullia vetë. Të vdekurit janë shumë të urtë, prandaj gjyshja juaj nuk do të ketë asnjë kundërshtim, sikur ju të tregoni se si ajo vrau burrin e saj të katërt dhe shkaqet e kësaj vrasjeje i keni mësuar vetëm ju, përmes një testamenti të lënë prej saj në një shishe të vulosur e që ju e keni gjetur krejt rastësisht gjatë punimeve restauruese në themelet e shtëpisë.

— Edhe kjo as që më kishte shkuar ndër mend.

— Vrasjet në kohën tonë janë burim i pashtershëm për letërsinë. Puna është që ato të bien në duar të afta. Ah, sa vrasje mbeten pa u shfrytëzuar si duhet!

NJËZET E PESË HERË DHËNËR

Kolja Busheviçi, djali njëzetetëvjeçar i drejtorit të uzinës së televizorëve në Riga, mezi e pret daljen e çdo numri të gazetës së martesave «Shërbimi i njohjeve» dhe të gjitha lajmërimet e saj i lexon me një dëshirë të papërmbajtur. Në këto lajmërimë disa femra reklamojnë flokët e artë, sytë bojë qielli dhe format e rregullta të trupit, të tjerat reklamojnë karakterin e butë, që mund të përshtatet lehtë, apo aftësitë në fushën e kuzhinës. Burrat, nga ana e tyre, u bëjnë reklamë rrogës, mustaqeve, mjekrës dhe forcës fizike. Me pak fjalë në ato reklama gjen kurdoherë një pasqyrë të pasur flokësh, sysh, trupash, moshash e cilësish të tjera joshëse.

Atë mëngjes, pasi lexoi të dhënat e kandidatëve për martesë, Kolja u ndal tek ajo e Galina Andrejevnes: bionde, 25 vjeçe, me përmasa të rregullta si ato të manekinëve.

«Pa ta provojmë njëherë, — tha ai me vete. — Të dhënat qenkan tërheqëse, edhe po t'i marrim me pesëdhjetë për qind zbritje. Pastaj, sido që të jetë, një takim e vlen.»

Kolja mori telefonin:

— Alo! Galina Andrejevna? Po? Ju flet burri juaj i ardhshëm. Kolja quhem... Po, po, ajo që kërkoja prej kohësh... Ehë... e ndiej se kam gjetur atë që prisja prej kohësh... Po, po, sonte patjetër...

Për Galinën kjo ishte telefonata e tretë pas daljes së gazetës dhe për një çast ajo ra në mëdyshje për orën e njohjes. Sipas radhës së telefonit, apo...? Dukej qartë se Kolja ishte më këmbëngulës se dy të parët, prandaj edhe takimi i parë atij i përkiste.

Njohja, fejesa dhe martesë u bënë njëherësh, që atë natë, në daçën e babait të Koljas, në periferi të qytetit. Kolja pa se nuk ishte gënjyer në parashikimet e veta, prandaj edhe martesën me Galinën vendosi ta zgjaste tri ditë të tëra, ndryshe nga disa martesë të tjera që s'kishin zgjatur veçse një natë. Ditën e katërt ai i tha gruas së tij të nëntëmbëdhjetë:

— Në shpalljen në gazetë ti thoshe se i ke sytë bojë qielli, ndërsa në fakt...

— Pse, nuk të duken bojë qielli?

— Jo, ata anojnë më shumë nga ngjyra e errët. Edhe flokët nuk i ke tamam të artë, ashtu siç është shkruar në gazetë...

— Kolja!

— S'ka Kolja! I do kafshët shtëpiake?

— Ne nuk kemi kafshë në shtëpinë tonë.

— As qen?

— As qen nuk kemi.

— Atëherë ti s'mund të më duash as mua.

— Ti dje më the se më dashuroje marrëzisht.

— Dje kam qenë me të vërtetë i marrë.

— Domethënë ti...

— Njohja u bë, tani s'na mbetet gjë tjetër veçse të falënderojmë ata të gazetës për mundësinë që na dhanë, e kupton? Ke oferta të tjera?

Galina Andrejevna niset në dy takimet e tjera, ndërsa Kolja Busheviçi telefonon në redaksinë e gazetës «Shërbimi i njohjeve».

Në anën tjetër të telefonit u dëgjua një zë

i ëmbël femre. Kolja u mat t'i bënte menjëherë propozim për martesë, por, kur ajo u prezantua si sekretarja e kryeredaktorit, hoqi dorë.

— Dua të botoj një lajmërim për martesë, — tha Kolja. — Ndofta më ecën fati meqenëse po ndërmjetësoni ju. Kam nevojë të njihem me një femër të përshtatshme për kushtet e mia. Ndofta më ndihmoni...

— Shumë mirë keni menduar, — përgjigjet sekretarja e kryeredaktorit. — Ne do t'ju ndihmojmë me gjithë qejf. Na dërgoni lajmërimin, ta botojmë menjëherë.

Të pasnesërmen lexuesit e «Shërbimit të njohjeve» mësuan edhe për kandidaturën e Kolja Bushëviçit. *Jam njëzet e tetë vjeç. Pamjen e jashtme nuk e kam të keqe, bile disa thonë se jam një tip mjaft interesant, po deri tani nuk më ka ecur fati. Nuk vuaj nga ndonjë sëmundje. Jam një e tetëdhjetë i gjatë. Zakonisht mbaj një mjekër mesatare, që mund ta zgjat apo ta heq fare, në varësi nga dëshirat e partneres sime të ardhshme. Do të më pëlqente që ajo të ishte jo më tepër se njëzet e pesë vjeçe, por ky nuk është kufiri i prerë, mund të jetë dhe tridhjetë, mjafton që t'u përputhet shijeve të mia. Nuk më mundon asnjë she një xhelozie, prandaj s'ka asnjë rëndësi sa herë dhe kur është martuar për herë të fundit. Nuk jam nga ata që rendin pas flokëve të artë apo syve bojë qielli, ata mund të jenë edhe me ngjyra të tjera. Siç e shikoni, unë kam nevojë vetëm për paraqitje, prezantim dhe fat të mirë.*

Thirrja aq e hapur dhe e singertë e Koljas gjeti menjëherë përgjigje. Brenda javës ai mori pesë propozime për martesë dhe secila prej kandidateve paraqiste karakteristika të veçanta.

Kolja rrinte shtrirë në kolltukun e dhomës

së gjumit dhe formonte rrathë me tymin e duhanit. Në mjegullën transparente dhe me sytë gjysmë të mbyllur ai shihte pesë gra që prisnin në radhë... «Nëntëmbëdhjetë edhe pesë bëjnë njëzet e katër! — tha Kolja me vete. — Do të dëshiroja që gruaja ime e 25-të të jetë ajo, sekretarja e kryeredaktorit. Le të jetë si të jetë! Sepse më tërhoqi zëri i saj! Edhe po qe se tani për tani është e martuar, deri në fund të muajit me siguri do të jetë ndarë...»

Kolja mori kalendarin dhe shënoi datat e pesë takimeve—martesa që e prisnin. Sa e mrekullueshme kjo gazeta në «Shërbim të njohjeve!» Me të vërtetë një mrekulli. Njëzet e pesë herë dhëndër! Ja, ç'do të thotë, kur gazeta vihet me të vërtetë në shërbim të lexuesit!



A DËSHIRONI TË JETONI?

Kjo pyetje qëndron gjithnjë e varur në të gjitha dyert e dyqaneve të një firme të Nju-Jorkut. Edhe vetë firma ka një emër mjaft origjinal dhe që ka të bëjë me çështjen e lashtë dhe aktuale — të jesh apo të mos jesh? Titulli zyrtar i firmës është: «Të mbetesh i gjallë». Por, që të mbetesh i gjallë, duhet patjetër të vishesh me një xhakëtë të papërshkueshme nga plumbi, që firma në fjalë ta ofron sapo t'i paguhen tre mijë dollarë.

Ju duken shumë? Ata s'janë hiçgjë për një banor të një qyteti ku të shtënat me armë nëpër rrugë dhe dhuna shëtitin lirshëm.

I shtyrë nga reklama, vendosa t'i marr një intervistë pronarit të firmës, zotit Lilian Mejrou;

— Si ju lindi ideja për t'i vënë emër kaq tërheqës e patetik firmës suaj?

— Gjithçka erdhi rastësisht. Një berber kishte vënë në hyrje të dyqanit të tij këtë tabelë: «Që të më ecin punët mbarë, më duhet koka jote». Ide gjeniale, thashë me vete. Edhe mua, që të më ecë puna mbarë, më duhet jeta e të tjerëve!

— Dhe gjithçka po shkon mbarë?

— Pa asnjë ndalesë. Për çudi, unë vë re se të gjithë duan të jetojnë. Dhe, kur është fjala për jetën, njeriu kapet pas fijes së kashtës, jo më pas një xhakete!

— Ju thoni se rrobat tuaja të mbrojnë nga çdo goditje?

— Po zotëri, me garanci.

— Po nga goditja e krizës?

— Cilës krizë?

— Krizës ekonomike, mosshitja e prodhimit.

— Ne këtë lloj krize nuk e njohim. Ne vetë kemi lindur nga kriza, jemi pjellë e saj. Kriza nuk e ha pjellën e vet.

— Po në qoftë se këto rroba i blejnë edhe banditët? Atëherë çfarë do të ndodhte?

— Fare thjesht: banditët — rrobat, ne — paratë.

— Nuk paraqit rreziqe kjo?

— Banditët nuk blejnë gjëra të zakonshme. Për ata kemi përgatitur rroba të kushtueshme: pallto, kostume pesëmijëdollarëshe, të cilat nuk mund t'i blejnë qytetarët e zakonshëm.

— Kjo do të thotë që banditët përsëri janë në avantazh, sepse bëhen edhe më të paprekshëm.

— Ne nuk shikojmë klientin, ne shikojmë kuletën e tij. Blerësi — jetën, shitësi — kuletën!

— Çfarë projektesh keni për të ardhmen?

— Firma jonë i përket së ardhmes. Ajo parashikon të prodhojë modele të reja të mbrojtjes veti si skafandra, parzmorë, helmata e shumë sende të tjera të domosdoshme për të gjithë qytetarët.

— A nuk ka rrezik që qytetet tuaja të duken si kampet e ushtrive të lashtësisë, kur të gjithë banorët të dalin në rrugë me parzmorë?

— Kjo do të duket kështu vetëm në fazën e parë. Për më vonë ne kemi projekte më moderne, për shembull parashikojmë të prodhojmë disa kulla të vogla metalike të cilat mund t'i quajmë edhe tanke të vogla familjare. Ato do të mund të përdoren edhe për të shkuar në dyqan për të blerë bukë, por edhe mund t'i instalosh në korridor para se të shkosh për të fjetur.

— Ju doni të thoni se, në të ardhmen, qytetarët tuaj do të mund të flenë të qetë?

— Natyrisht... Ata do të mund të flenë të qetë në qoftë se do të arrijnë të mbeten të gjallë! — tha pronari dhe ngriti gishtin drejt tabelës së varur në hyrje të dyqanit. Ai i lëshoi këto fjalë me një zë të ngjirur dhe në fytyrë iu vijëzua një si përqeshje prej skeleti.

KAUBOJ I VËRTETË

— Midis jush unë e ndiej vetën si në familjen time, — tha Regani në konferencën e parë të shtypit, si president i SHBA. — Prandaj ju më pyesni për çfarë të dëshironi dhe unë do t'ju përgjigjem si të dëshiroj.

— Me leje?

— Ju lutem, tregoni emrin dhe organin që përfaqësoni, — ndërhyu presidenti.

— Tomas Tauler, i «Nju-Jork herald»-it.

— Ndiej kënaqësi të veçantë që më jepet rasti të njihemi personalisht, zoti Tauler. Pronari juaj është një burrë shumë simpatik e zemërgjerë dhe gazeta juaj ka dhënë kontribut të shquar për zgjedhjen time. Mund të pyesni çfarë të dëshironi, zoti Tauler.

— Zoti president, ju keni luajtur në shumë filma me kauboj dhe vetëm në njërin nga këta, me sa më kujtohet, ju keni vlarë, brenda pesëdhjetë minutave, njëzet e një lëkurëkuqë. A mund të na thoni se si e përfytyroni ju një kauboj të vërtetë?

— Kauboj i vërtetë është një amerikan, i cili di të vrasë jo vetëm lëkurëkuqë, por edhe lëkurëzinj.

— Vetëm kaq?

— Natyrisht jo vetëm kaq. Një kauboj i vërte-

të duhet të dijë ta shalojë mirë kalin dhe të mos i zbresë atij nga kurrizi as natë as ditë.

— A ka mundësi të na sqaroni më konkretisht mendimin tuaj, zoti president?

— Po ja, ta zëmë se ju të gjithë jeni një kope kuajsh, ndërsa unë, si kauboj, zgjedh njërin prej jush dhe i hip në qafë...

— Në qafën time, zoti president, në qafën time... në timen... në timen...

— Zotërinj, mos u nxitoni: unë jam në qafën e ju të gjithëve, — thërret presidenti midis ilaritëtit të përgjithshëm.



FSHATARI DHE KALI

Fshatari Perez de Santos mori kalin dhe shkoi në pyll për dru. Ndërsa po kthehej, i dolën përpara dy njerëz me maska, i vunë revolen në grykë dhe i morën kalin.

Ashtu i pezmatuar për humbjen e kafshës, fshatari Perez shkoi në qendrën e komunës për t'u ankuar.

— Ku është gjykata këtu? — pyeti ai njeriun e parë që takoi.

— Ja, ajo ndërtesa në të djathtë, — iu përgjigj i panjohuri.

Perezi shkon atje dhe kërkon të takojë gjykatësin.

— Gjykatësin e kanë vrarë ka tri ditë dhe akoma nuk e kanë zëvendësuar, — i tha portieri që rrinte te dera e gjykatës.

— Po kryetari i bashkisë, ku e ka zyrën?

— Ai ka një javë që është zhdukur bashkë me gruan e komandantit të xhandarmërisë.

— Atëherë më ndihmoni të takoj shefin e policisë, — u lut Perezi.

— Kam marrë vesh se shefin e policisë e kanë arrestuar dje.

— Pse kështu?

— Thonë se paska vrarë gjykatësin. Qenkëshin grindur ndërsa po ndanin ryshfetin që kishin marrë nga një shoqëri e huaj, që merret me shitblerjen e tokave.

— Ka ndonjë që e zëvendëson shefin e policisë?

— Aha, edhe atë...

— Çfarë, e kanë vrarë?

— Jo, akoma s'ka vdekur. Mbrëmë bëri duel me pronarin e klubeve të natës, senjor Pedro Miguel Sanço de Eskavedon për punën e një femre që quhet Maria Santos de Pedros.

— Kaq e bukur qenka?

— E bukur është, djalli. Tri a katër çifte burrash kanë bërë duel për të deri tani dhe...

— Keq e paska.

— Kush, Maria?

— Jo, kali im. Ma kanë grabitur sot kur po vija nga pylli dhe s'gjej dot njeri që të më ndihmojë.

— Ama për punë kali ke ardhur?

— Po, senjor. Për punë kali. Ma kanë grabitur, ma morën me forcë.

— Me këto punë merret kapiteni i rojave të financës. Shko njëherë edhe atje, ndoshta të ndihmon.

— E ku ta gjej unë kapitenin e rojave të financës? Kushedi ç'mund t'i ndodhë atij derisa ta gjej unë.

— Ec drejt kësaj rruge në të dalë të qytetit,

TRAKTORISTË ME PASAPORTË DIPLOMATIKE

Njëfarë Onxho Bonxho, ministër në qeverinë e një vendi të Afrikës, shkoi në Departamentin e shtetit të SHBA dhe paraqiti kërkesat e qeverisë së tij për kredi. Përfaqësuesi i Departamentit, zoti Dumbing, e priti Onxho Bonxhon me mirësjellje.

— Më falni, po në fillim desha të dija nëse në vendin tuaj ka elementë turbullues ose kryengritës, — pyeti zoti Dumbing.

— Hëpërhë jo, — përgjigjet Onxho Bonxhoja. — Ne sapo kemi filluar të qeverisim.

— Atëherë, përse i doni kreditë tona?

— Kemi shumë varfëri, zotëri. Papunësia ka arritur ku s'mban më. Njerëzit vuajnë edhe për bukë.

— E qartë. Ju keni nevojë, në radhë të parë, për tanke, për një apo dy skuadrilje aeroplanësh gjuajtës reaktivë, pa përmendur këtu armët e lehta.

— Mirë mendoni ju, po kundër kujt do t'i përdorim këto?

— Ju thatë se keni uri e papunësi, apo jo?

— Shumë.

— Kjo do të thotë se ju do të keni edhe kryengritës, në mos sot, nesër. Prandaj patjetër ju

do të keni turbullira të brendshme. Dhe turbullirat përballohen me tanke, apo jo?

— Ashtu është, po ne s'kemi njerëz për t'i përdorur ato.

— Për atë punë ju dërgojmë njerëzit tanë. Me siguri ju s'keni as helikopterë. ,

— Kemi disa, nga ata të tipit të vjetër, po sikur s'kemi ndonjë nevojë të ngutshme.

— Po në qoftë se kryengritësit përparojnë drejt kryeqytetit dhe presidentit tuaj do t'i duhet të ikë, me çfarë do të largohet ai?

— Në qoftë se ikën presidenti, atëherë ne mbetemi fare pa qeveri.

— Qeveria s'është problem. Këtë çështje e zgjidhim menjëherë. Krijojmë një qeveri tjetër. Ju keni edhe bregdet, apo jo?

— Kemi, po nuk e shfrytëzojmë dot, s'kemi anije peshkimi.

— Hëpërhë ju dërgojmë ne një kryqëzor, bashkë me anijet shoqëruese.

— Dakord, po ne s'kemi as admiralë, as...

— Edhe për këtë çështje mos mendoni fare, Kryqëzorët ne i dërgojmë bashkë me admiralin dhe marinsat tanë.

— Po sikur të na jepnit disa anije peshkimi?

— Edhe kryqëzori me peshkim do të merret, sigurisht, por në fillim duhen bombarduar brigjet dhe kryeqyteti. Kur të jenë zhdukur kryengritësit, ne do t'i urdhërojmë marinsat tanë të merren me peshkim. Ju me siguri keni nevojë edhe për kuadro të tjera, apo jo?

— Sidomos për traktoristë...

— Edhe ata jua dërgojmë ne. Bile ata do të jenë më shumë se traktoristë. Të gjithë do t'i pajisim me pasaportë diplomatike, në mënyrë që të keni mundësi t'i përdorni edhe si kuadro në Mi-

nistrinë e Punëve të Jashtme. Ne kemi respekt të madh për vendin tuaj.

— Traktoristë me pasaportë diplomatike?! Ky është një nder i madh që i bëhet vendit tonë!

— Ne këtë e bëjmë për të mbrojtur interesat tuaja.



PANTALLONAT E PLESHTIT

Këshilltari i Shtëpisë së Bardhë, zoti Klark, u thotë kolegëve të tij:

— Është vërtetuar shkencërisht se çdo njoftim për disfatat e trupave të qeverisë proamerikane në Salvador e ngrë tensionin e presidentit mesatarisht dy shkallë.

— Atëherë të zhduket Salvadori! — propozon Xhejms Bekeri.

— Ndërsa unë kam vënë re se presidentit i shkëlqejnë sytë nga gëzimi sa herë flitet për konflikte të armatosura, — ndërhyt Çarlz Diveri.

— Edhe gëzimi i tepërt vepron në nervat dhe e prish ekuilibrin e presidentit. Kjo është një dukuri e njohur, — shpjegon Klarku.

— Sipas jush, presidenti nuk duhet të njoftohet, edhe po të shpallet lufta?!

— Luftërat nuk shpallen, të nderuar kolegë. Shpallja e tyre ka dalë jashtë mode.

— Luftërat paskan dalë jasht mode?! — habitet Çarlz Diveri.

— Nuk thashë luftërat, po shpallja e tyre.

— Unë, zotërinj, personalisht jam për shpalljen zyrtare të luftërave. Unë nuk shoh asnjë lidhje midis modës dhe luftës.

— Megjithatë unë ngul këmbë se luftërat në modë janë të arsyeshme: Në fillim dërgohen disa pako me ilaçe, pastaj dërgohet një ekip i kufizuar këshilltarësh, pas tij niset një kontigjent fare i vogël i trupave të këmbësorisë së marinës që ka për detyrë të mbrojë ekipin e këshilltarëve. Meqenëse jeta e njerëzve tanë është shumë e shtrenjtë dhe duhet mbrojtur deri në fund, pas repartit të parë të marinsave nisen edhe reparte të tjera në ndihmë të tij... Nuk di nëse po shpjgohem.

— Topat nuk e luajnë!

— Kështu pra, gjithmonë sipas modës, në mbështetje të marinsave, lundrojnë dy apo tre kryqëzorë, të shoqëruar, natyrisht, nga disa skuadrilje aeroplanësh gjuajtës reaktive. Ata, për të mos shkelur integritetin tokësor të vendit të dhënë (ta zëmë se ky vend qenka Libani), hedhin bomba nga ajri, por nuk ulen fare nëpër aeroportet e vendit të bombarduar.

— Sipas jush, aeroplanët ngelen në ajër?

— Akoma s'kam mbaruar... Aty afër dërgohet një aeroplanmbajtëse, por edhe ajo kujdeset të mos i shkelë ujërat territoriale të vendit. Më kuptoni?

— Po kur s'ka det aty afër?

— Kur s'ka det, ka tokë, zoti Diver.

— Dhe ju mendoni se të gjitha këto nuk do të quhen luftë?

— Më vjen shumë keq, koleg, por, siç e dëgju-

at, unë nuk e përmenda asnjëherë fjalën luftë.

Këshilltari Bejker pyet nëse duhen ndaluar edhe gazetat që, me komentet e tyre, trazojnë qetësinë shpirtërore të presidentit. Disa ditë më parë, thotë ai, një fejtunist amerikan shkruante hapur se gjoja ne po shkojmë «me shpinë përpara drejt luftës» dhe se në këtë mënyrë ngjajmë me të verbrin, që ecën me sy mbyllur mbi çati...

— Satirikët atë punë kanë, zotërinj, — ia pret Klarku. — Edhe mua më ka qëlluar të lexoj një libër të satirikut Fred Alen, ku thuhet se e gjithë logjika e Pentagonit mund të futet në pantallonat e një pleshti. Tani më thoni, ju lutem, a ka mundësi të futet Pentagoni në pantallonat e një pleshti, në një kohë kur atë nuk e nxë as territori i Shteteve të Bashkuara?


— Është e kotë të merremi me pantallonat e pleshtit, zotërinj, ne jemi mbledhur këtu për të ruajtur nervat e presidentit, — vëren këshilltari Miz. Prandaj unë propozoj që presidentit të mos i jepen as parashikimet e motit, sidomos kur në të bëhen aluzione të rrezikshme politike. Shpesh ne dëgjojmë të thuhet se nesër parashikohet afrimi i një shtrëngate me breshër. Jam i bindur se, pas këtij njoftimi, presidentit menjëherë mendja i shkon te Nikaragua apo Lindja e Mesme. Pse patjetër u dashka të bjerë breshër?

— Të jepet një urdhër i prerë për ndalimin e breshrit e të shtrëngatave, në qoftë se ato vijnë në drejtim të territorit tonë?! — ndërhyjnë Divëri.

— Po në qoftë se nuk arrihet kjo?

— Atëherë të urdhërohen ata të meteorologjisë të bëjnë vetëm parashikime optimiste.

— Kjo është plotësisht e mundur të arrihet!
— ranë dakord këshilltarët e Shtëpisë së Bardhë!



NUMRI 13!

Kur në vendet e Tregut të Përbashkët Evropian u arrit shifra dymbëdhjetë milionë e të papunëve, njëri nga anëtarët më në zë, zoti Pezho, tha:

— Kjo është një arritje e jashtëzakonshme, zotërinj. Ne nuk duhet të lëmë të na ikë ky rekord pa e vënë re.

— Unë propozoj të organizohet një ceremoni solemne, gjatë së cilës t'u jepet punë dymbëdhjetë punëtorëve, një për çdo milion, — u përgjigj zoti Kuper, monopolist i madh i mishit dhe i gjalpit.

— Kjo ceremoni të organizohet në pallatin mbretëror të Anglisë, — propozoi i entuziazmuar

përfaqësuesi anglez. — Unë mendoj se edhe në të ardhmen duhet bërë rregull që çdo i papunë që do të ketë fatin e madh të plotësojë shifrën një milion të quhet punëtor jubilar dhe t'i jepet punë me ceremoni. Kjo do të ngjallte shumë shpresa të të papunët e ardhshëm dhe secili do të synojë të plotësojë milionin.

Kur dëgjoji të gjitha këto, përfaqësuesi i njërit prej vendeve që kishte kontribuar me përqindjet më të larta në plotësimin e dymbëdhjetë-milionshit, nuk u përmbajt dot dhe thirri:

— Ide gjeniale! Kjo do ta kthejë të papunin nga një element eksploziv në një punëtor të kënaqur e plot shpresa. Prandaj të shpërblehet autori i kësaj ideje shpëtimtare.

Aty për aty u vendos të ngrihet çmimi i mishit dhe i gjalpët edhe me dhjetë për qind, pasi autori fillestar i kësaj ideje ishte pikërisht zoti Kuper.

— Tani që çështja e punëtorit jubilar u zgjidh, — thotë kryetari i mbledhjes, — ne duhet të mendojmë se ç'do të bëjmë me pjesën tjetër të të papunëve. Ka propozime konkrete?

— Zotërinj, meqenëse tregu i punës u pasurua shumë, gjë që jep mundësira të mëdha manovrimi, është e nevojshme që ne të vëmë rregull edhe në çmimet. Ne kemi arritur të unifikojmë çmimet e lakrës, të puplave të pulave dhe të mishit të derrit, prandaj nuk na lejohet të mos kemi çmim unik edhe për mallin-njeri.

— Unë jam kundër çmimeve unike në këtë fushë, — ngrihet e thotë përfaqësuesi anglez. — Një pjesë e madhe e mallit tim është me diplomë, ndërsa...

— Aq më keq! — ia pret zoti Pezho. — Të diplomuarit kanë më shumë pretendime. Edhe unë

kam shumë me diplomë; do të doja t'i kisha të gjithë analfabetë.

— Analfabetë kam unë me bollëk, — ndërhyu zoti Paskualino.

Diskutimi merr zjarr.

— I shkëmbejmë dy me një, — thotë dikush.

— Dy analfabetë me një të diplomuar.

— Përkundrazi, dy të diplomuar me një analfabet.

— Vetëm kokë me kokë, asnjë lëshim!

— Zotërinj, t'i lëmë ndërrimet e polemikat e të merremi me çmimet, — ndërhyu kryetari, për të shuar sherrin.

— Unë e përsërit se jam kundër çmimeve unike që pengojnë iniciativën e lirë, — ngul këmbë përfaqësuesi anglez. — Një anglez duhet të shitet të paktën dy herë më shtrenjtë se një italian apo portugez.

— Përkundrazi, çdo gjerman duhet të shitet dy apo tri herë më shtrenjtë se çdo anglez, pa përmendur këtu belgët, — përgjigjet me zë të ashpër përfaqësuesi gjerman.

— Këtu po bëhet diskriminim, zotërinj, në jemi një shoqëri demokratike.

Paskualinoja i thotë këto fjalë me zërin e një të sëmuri që s'mbushet dot me frymë dhe ai ndoshta do të protestonte edhe me shkrim, por papritur ndërhyu njëri nga mbretërit e qymyrit.

— Në keni për të pyetur, unë do të preferoja më mirë një analfabet italian që bën çdo punë që t'i ofrosh, sesa dy të diplomuar anglezë që përpiqen t'i shmangen një pune aq të dobishme siç është fshirja e rrugëve. Këtë e them nga përvoja ime, — tha mbreti i qymyrit.

Problemi i çmimeve unike të mallit-njeri hyn në qorrrokak, prandaj kryetari i mbledhjes paraqiti një propozim të ri. Për të mënjanuar diskuti-

met e papëlqyera, ai mendon se do të ishte më e arsyeshme të organizohej një panair ndërkombëtar për tregtimin e dymbëdhjetëmilionëshit.

— Ne bëjmë tregti të hapur dhe çmimet le të jenë të lira, — tha më pas kryetari. — Sa më i lartë që të jetë numri i të papunëve, aq më i ulët çmimi i tyre. Kushdo mund të paraqitet në panair me një listë në dorë dhe të blejë aq anglezë, italianë, francezë apo portugezë, sa i nevojiten.

— Kjo është një ide e pranueshme, — u dëgjua an disa zëra njëherësh, — por panairi ynë do të mbytet nga malli amerikan. Që ditën e parë atë do ta sulmojnë dhjetë milionë e më shumë amerikanë. Merreni me mend, zotërinj, se ç'do të ndodhte me çmimet tona, sikur këta dhjetë milionë të vinin aty e të shiteshin me çerek çmimi!

Njëri nga ata që kishte heshtur gjatë gjithë këtij debati ngrihet e bën një paralajmërim tjetër edhe më të ashpër:

— Ju përmendët këtu mjaft shqetësime dhe që të gjitha janë të drejta, por nuk u përmend një rrezik tjetër, që mua më duket ende më i madh. Ndërsa po merreni me disa hollësira panairesh, në portat tona po troket numri fatal 13. Së shpejti dymbëdhjetëmilionëshi do të bëhet trembëdhjetëmilionësh. Nuk jam supersticioz, zotërinj, po numrin trembëdhjetë e kam për ters.

— Të ndalohet!

— Të mos pranohet!

— Të mos përfillet!

— Të lihet në heshtje dhe pikë!

Thirrjet në sallë tregonin se të gjithë ishin në një mendje për numrin 13 dhe, aty për aty, u vendos që të lihej në heshtje trembëdhjetëmilionëshi i ardhshëm!



ARTI KËRKON SAKRIFICA

Në faqen e shtatëdhjeteshtatë të njërit prej romaneve «bestseler» të shkrimtarit më në zë amerikan, Mak Baja, vritet personazhi i njëzetetretë. Ai sapo i është paraqitur lexuesit, kur hidhet nga dritarja e katit të nëntëmbëdhjetë të hotelit «Mason», i shtyrë nga bashkëpunëtori i tij i ngushtë, në çastin kur po ndanin paratë e grabitura në një bankë. Dhe, ndërsa po vendosej fati i të njëzetekatërtit, kundër të cilit po injektounin gaz mbytës përmes vrimës së çelësit, autori i romanit mban këtë monolog para adhuruesve të tij:

«Arti kërkon sakrifica, prandaj edhe unë sa-

krifikoj... natyrisht, jo veten time. Të lësh kokën për artin, ose të të ikë koka për artin, nuk është fjalë boshe. Një kolegu ime në Evropë i shkruante aq bukur romanet me historira kriminale sa që edhe vajza e tij, Maria, e frymëzuar nga letërsia e të atit, i dha fund jetës duke ndjekur shembullin e njërit prej personazheve të krijuara prej tij. Ja, ky është art. Prandaj edhe unë shkruaj në atë mënyrë, që lexuesit lënë kokën për shkrimet e mia. Ata lënë kokën, unë marr paratë. Kam llogaritur se në veprat e mia, të paktën pesëqind veta kanë shkuar në atë botë, pa llogaritur qentë e policisë dhe kuaajt e kinemasë, pasi, si rregull, veprat e mia edhe ekranizohen. Heronjtë e mi vriten jo vetëm me armë zjarri, ata hidhen nga kati i njëzetë, mbyten me tuba hekuri e helme, në disa raste hidhen nga shkëmbi me gjithë automobil, bien në thonjtë e egërsirave, zhdukin prindërit e tyre dhe pastaj ia heqin edhe vetes. Po. Njërezit lënë kokën për artin tim dhe vrasja është biznesi im.

Dikush më ka pyetur nëse jam arrestuar ndonjëherë për vrasje. Asnjëherë. Vrasjet e mia mbrohen nga ligji, ato mbrohen e pëlqehen nga prokurori, ato bëhen edhe me porosi nga organe të larta zyrtare. Mua më mbrojnë e më ushqejnë pikërisht ato organe që duhet të më ndjekin. Miqësia ime me policinë lidhet me shumë fije. Ata më ftojnë kudo që ka vrasje. Bile ka raste kur unë mbërrij në vendin e ngjarjes përpara policisë. Lagjet e disa qyteteve të mëdha i njoh më mirë se kuzhinën time. Kam vënë re, për shembull, se në lagjen tetëdhjetë të kryeqytetit, njerëzit helmohen më shumë se kudo gjetkë. Në lagjen shtatëdhjetë e pesë pleqtë dhe të varfrit preferojnë më shumë se çdo gjë vdekjen me hedhje nga dritarja.

Si autor romanesh policore, unë reklamohem gjithmonë nga shtypi. Intervistat e mia janë të preferuara nga redaksitë e gazetave e revistave me tirazh të madh. Veprat e mia të intrigojnë me titullin «Vrasja në Çikago», «Vrasësi i trembëdhjetë», «Klubi i vetëvrasësve», «Unë do ta vras atë», «Ai do të më vrasë mua», «Njeriu që u vra dy herë». Ju do të thoni se njeriu nuk mund të vritet dy herë, por unë e kam vërtetuar me fakte se njeriu mund të vritet jo vetëm dy, por edhe shumë herë, mjafton që të futet në letrat e mia. Romani kthehet në dramë, drama në film, filmi në... Në çdo fazë të re arrihet një kulm i ri i gërshtuar me vrasje të tjera. Gjaku rrjedh rreke dhe ai, nga i kuq, kthehet në të verdhë, në para.

Kur vrava njeriun e parë, në tregimin me titull «Bota e deziluzioneve», u mata disa herë. «Përse ta vras, — thashë me vete, — ai s'më ka bërë asgjë të keqe». «Vrajë, — më thanë, — ndryshe nuk do të bëhesh i famshëm, nuk do të quhesh shkrimtar modern.» Kaq u desh. Në tregimet e mëvonshme nisa të vrisja jo një e dy, por pesë apo dhjetë veta njëherësh. Edhe të mirat më dhjetëfishoheshin.

Tani që ka kaluar kaq kohë, mjerë ai që bie nën penën time. Nuk del i gjallë pothuaj asnjë personazh.

Ju pyesni: përse herë pas here në shtyp shkruhen edhe kritika kundër meje? Gjëpura! Të gjitha shkojnë në favorin tim. Shpesh kritikën dhe protestat në shtyp kundër romaneve të mia janë të shkruara nga vetë unë. Po, po, nga unë. Njëherë, edhe gruaja ime arriti të organizonte një protestë kundër meje. Me ndihmën e shtëpisë botuese që merret me librat e mi, ajo mblodhi disa gra, sigurisht, shoqet e saj, dhe doli në rrugë duke thirrur për demaskimin tim si vrasës let-

rar, si autor që ngjall ndjenjën e krimit. Tehu i kësaj proteste ishte drejtuar sidomos kundër një romani që ishte në shtyp dhe ku tregoheshin fshehtësia dhe prapaskenat e një gruaje, që kishte arritur të vriste e të zhdukte, me metoda krejt origjinale, gjashtëdhjetë ë dy burra, që në takimin e dytë. Pas këtyre protestave u rrit dyfish tirazhi i romanit tim të ri. Vetëkuptohet, edhe të ardhurat.

Cila është kryevepra ime? Famën më të madhe, si vrasës letrar, e fitova me ciklin e romaneve që mban titullin «Ky është detektivi juaj». Secili roman hapet me vrasje dhe pastaj vazhdon me polici e detektivë që vihen për të zbuluar vrasësin. Kështu unë vetë vras dhe po vetë vihem për të zbuluar krimin. Gjatë ndjekjeve vriten të tjerë (policët dhe detektivët vetëm plagosen), ngjarja pjell ngjarjen dhe lindin kështu romane të reja. Në kokë më lëvrijnë vazhdimisht agjentët, vrasësit, viktimat. Ata më ndjekin në çdo hap, bile edhe në gjumë. Disa herë jam shtruar në spitalin psikiatrik dhe kam vënë re se pikërisht atje fantazia ime punon më shumë se kudo. Njëherë, mjekët urdhëruan të më lidhnin me hekura, por kjo qe në favorin tim. Gjatë kësaj kohe më lindi dhe ideja e veprës sime më të shquar, që mban titullin «Vrasja e kapelexhiut», e cila më ka vënë në listën e kandidatëve për Çmimin Nobël. Tani që kam dalë nga çmendina, e ndiej se kam rënë nga krijimtaria. Më duhet të futem përsëri atje, për të kthyer frymëzimin tim, gjë që kam shpresë ta realizoj aty nga fillimi i verës.»

SHTRATI I ZONJËS B

Në ekspozitën vjetore të skulpturës në Londër një grup adhuruesish të artit abstrakt u ndodhën para një të papriture. Ata vunë re se njëri nga objektet e mbështetur pas murit, diku në fund të sallës, paraqiste një trekëndësh të vendosur mbi një bisht të gjatë. Mbi trekëndësh varej një copë thes i lagur. Kjo gjë e nxiti më tepër kureshtjen e pesë apo gjashtë vlerësuesve të artit, që ishin grumbulluar aty e po diskutonin. Si ishte e mundur që kjo vepër të rrinte gjithmonë njëlloj, e lagur? Vepra ishte pa emërtim. Me sa dukej, autori i saj kishte dashur të provonte fantazinë e adhuruesve të artit të tij, prandaj e kishte lënë skulpturën pa titull.

— Çfarë thoni, zotërinj, si do të mund të quhej kjo vepër? — foli njëri, duke iu drejtuar atyre që kishte pranë.

Ai që pyeti, kishte një mjekër mjaft të dendur e të gjatë, që ishte në shpërpjestim me përmasat e vogla të kokës fare tullace.

— Është e qartë se këtu kemi të bëjmë me një enigmë, zotërinj, — u hodh e tha një tjetër nga të pranishmit, pa e hequr çibukun nga goja. Folësi mbante një palë syze të errëta, — unë, për veten time, do ta quaja pa frikë «Enigma».

— Pikërisht se është enigmë, vlerësuesit e

vërtetë të artit duhet ta zgjidhin përmbajtjen, më pas dhe emrin e vërtetë të saj, — shtoi një tjetër. — Unë do ta quaja «Lakuriqi i natës». Shikojeni se çfarë simbolike e hollë është përdorur: krahët në formë kryqi, bishti i gjatë për të mbajtur ekuilibrin, antenat e tij orientuese...

— Ndërsa unë do ta quaja «Gruaja dhe struci», — tha një tjetër.

— E përse pikërisht «Gruaja dhe struci» e jo, ta zëmë, «Simfonia kozmike» ose «Shtrati i zonjës B?»

Këto propozime e nxitën fantazinë e të gjithëve dhe, duke ndërprerë njëri-tjetrin, në veshët e secilit vinin tituj nga më të ndryshmit: «Bukuria që vret», «Diskutim pa zë», «Protesta e epokës», «Shpella pa emër», «Thika», «Diskutim në parlament», «Sfida e heshtur», «Një ditë pas luftës atomike»...

Në këto e sipër dikush vuri re se nga copat e thesit herë pas here binte ndonjë pikë uji në dysheme. Ato pika uji shkaktuan të rrëqethura te të gjithë. Çfarë të ishin vallë? A mos ishin lot? Po. «I urituri», kështu duhej quajtur vepra që kishin përpara.

— Të mos i thjeshtojmë gjërat, të dashur kolegë, — tha i pranishmi me syze të errëta. — Vërtet, këtu kemi të bëjmë me vuajtje, por... me një vuajtje hyjnore. Përpara nesh kemi vetë Krishtin e gozhduar në kryq. Ai po qan!

— Largohuni, ju lutem! — u dëgjua një zë nga prapa shpinës së atyre që ishin grumbulluar rreth skulpturës enigmatike.

Kur adhuresit e artit kthyen kokën pas, sytë e tyre të vagëlluar u ndeshën me ata të një gruaje me rroba pune.

— Mos jeni ju autorja? — pyeti njëri nga ata.
Gruaja nuk foli, ajo kaloi përmes tyre dhe
shkoi drejt veprës së saj.

— Zonjë, ju lutemi, ju jeni autorja e saj?

— Unë! — tha ajo dhe mori shkopin me bisht
të gjatë e filloi të lante dyshe-menë.

PROVA

Gjenerali Grin Vud, njëri nga ata që përgatiti pushtimin e Granadës, po rrinte në verandën e vilës së tij, në periferi të Uashingtonit. Pasi hëngri mëngjesin, gjenerali filloi të shfletonte gazetën «Nju-Jork Tajms». Në faqe të parë, të shkruar me shkronja të mëdha, ai lexoi: «Gjenerali Grin Vud, arkitekti i fitores kundër Grenadës. Trupat e përgatitura prej tij mbuluan me zjarr të gjithë ishullin.»

«Shumë mirë, — mendoj me vete gjenerali. — Në kohë paqeje asnjë gjeneral nuk mund të pretendojë një popullaritet kaq të madh. Me siguri kjo do të ngjallë zilinë e shumë kolegëve të mi. Luftë në kohë paqeje!»

Gjenerali vazhdoi të shfletonte gazetën. Ai e ndali vështrimin te një puro që zinte një faqe të tërë dhe që e reklamonte një zotëri elegant. «Një puro e markës «Lux» të sjell jo vetëm humorin, por simulon edhe lumturinë bashkëshortore.» Faqen përballë e zinte intervista e një firme zjarrfikësish që tregonte rastin më të fundit: një shtëpi e bukur, si ajo e gjeneralit Grin Vud, ishte djegur e tëra nga pakujdesia dhe mungesa e masave paraprake të sigurimit...

— Matilda! — thirri gjenerali shërbyesen e tij. — Eja këtu bashkë me Bobin! Kam një detyrë urgjente për ju.

Zeakja dhe kopshtari Bob u paraqitën te gjenerali, i cili rrinte shtrirë në shezlongun e tij, me duart të lëshuara anash, sikur po bënte banjë dielli.

— Merreni këtë gazetë, lexoni rëndet e zjarrit dhe më propozoni masat që duhen marrë për ruajtjen e vilës sime. Dua të merren masa të forta sigurimi, që të mos na ndodhë asgjë e papritur. E keni lexuar faqen e parë të gazetës?

— Jo, nuk e kam lexuar, — tha Bobi me gjysmë zëri.

— Keq, shumë keq. Aty flitet për mua. Shërbëni këtu dhe nuk dini çfarë thuhet në botë për padronin tuaj. Prandaj lexojeni dhe ejani e më raportoni se çfarë masash keni marrë e ç'duhet bërë ende...

— Si urdhëroni, sër!

Të dy shërbëtorët lexuan me vëmendje gazetën dhe pastaj ia nisën punës për marrjen e masave që urdhëroi padroni. Në fillim ata mbyllën të gjitha dyert e dritaret e shtëpisë, pastaj zhveshën kordonët e lidhjes së korentit elektrik, në dysheme derdhën benzinë e barut, zhdukën kutinë e zjarrfikësit dhe prenë të gjitha lidhjet telefonike.

Pasi kishin marrë të gjitha këto masa, ata shkuan dhe i raportuan pronarit.

Gjenerali brofi në këmbë.

— Keni lojtur mendsh, apo si?

— Na falni, po ne pamë gazetën, lexuam ato që kishit thënë në intervistën me gazetarët dhe...

— Çfarë dhe... more të marrë?!

— Jo, zoti gjeneral, ju vetë thoshit se mënyra më e mirë për t'u mbrojtur është zjarri dhe baruti, prandaj ne... vendosëm ta provonim.

— Ku ta provoni, morë të marrë, në shtëpinë time!?

— Vetëm si provë, zoti gjeneral... ju vetë keni thënë...

— Qërohuni dhe shkoni në çmendinë, atje e keni vendin ju.

— Ne nuk bëme gjë, zoti gjeneral: ju paskeni djegur një shtet të tërë dhe megjithatë...

DASHURI RECIPROKE

Në një ceremoni zyrtare në Shtëpinë e Bardhë presidenti amerikan, tha: «Në Grenada... ne kryem një mision shpëtimi në favor të demokracisë, ne vepruam për çlirimin dhe vendosjen e sovranitetit të saj, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës për të pasur një qeveri demokratike.»

(Nga shtypi)

Kur dëgjoji këtë deklaratë të Reganit, një banor i kryeqytetit të Granadës, këpucari Esperado, i dërgoi atij letrën e mëposhtme:

Deri më sot, si unë, ashtu edhe shumica dërrmuese e bashkatdhetarëve të mi, kemi pasur njëfarë ngatërrese në kokë për lirinë, demokracinë, pavarësinë, të drejtat e njeriut e të tjera si këto. Tani që dëgjuam këtë fjalim, gjithçka po na bëhet më e qartë. E nga ta dinim ne se çfarë është liria e pavarësia, në qoftë se nuk do të na e tregonit ju?


Që të flasim hapur, në fillim kur pamë tanket tuaja duke u vërsulur me zhurmë mbi qytetet e fshatrat tona dhe predhat e topave që na ranë mbi çatitë e shtëpive, të gjithë sa ishim, dolëm nëpër rrugë duke thirrur me të madhe: «Agresion! Fashizëm! Ngrihuni kundër jankive!» Mirëpo tani që e dëgjojmë nga goja juaj se na paskeni pushtuar për të mirën tonë dhe se këtë e paskeni bërë vetëm nga dashuria e madhe për

Grenadën, e shohim se e paskemi pasur krejt gabim.

Bota shkruajnë e thonë se dashuria juaj është dashuri që vret. Kjo s'është aspak e vërtetë dhe këtë e them nga përvoja. Fakti që po ju shkruaj këtë letër, tregon se unë jam ende i gjallë, në një kohë kur mund të isha vrarë si qindra bashkatdhetarë të mi. Dhe unë nuk jam vrarë akoma vetëm sepse ju keni marinsa të sjellshëm e shembullorë. Për këtë të gjithë jemi dëshmitarë, pasi i pamë me sytë tanë se si ata vunë jetën e tyre në rrezik për të na çliruar ne nga... po nga ne. Marinsat tuaj me të vërtetë i thyen dyert e shtëpive tona, por këtë e bënë me shumë mirësjellje dhe me dashamirësi më të madhe sesa rusët në Afganistan. Për këtë ju keni shumë të drejtë. Ushtarët tuaj ma morën djalin tim bashkë me disa moshatarë të tij të shkollës së mesme, po këtë e bënë krejt miqësisht. Dhe pse i morën? I morën sepse ata pengonin përhapjen e demokracisë në ishull. Më vonë pamë se disa prej tyre i lidhën pas makinave dhe i tërhoqën nëpër rrugë, po kjo erdhi vetëm nga kokëfortësia e djemve tanë, që nuk deshën t'u lidheshin duart. Cila është ajo ushtri pushtuese që nuk të tërheq zvarrë nëpër rrugë, po t'i kundërshtosh? Marinsat tuaj kanë ardhur për të sjellë demokracinë dhe pavarësinë e jo për t'i kundërshtuar ne! Aq më tepër kur kjo pavarësi vjen e hipur mbi tanke e aeroplanë!

Tani ushtarët tuaj kanë mirësinë të kujdesen për ne edhe në orët e vona të mesnatës, me ato kontrollet e befasishme nëpër dhomat tona të gjumit, për të mos lejuar që ndokush të na rrëmbëjë demokracinë dhe të drejtat e njeriut, që na i sollët ju me aq bujari e sakrificë. Nuk e teproj kur them se këtë mund ta bëjë ve-

tëm një fuqi e madhe si ju, që është e mbushur me demokraci e të drejta në vendin e vet. Ju keni marrë përsipër çdo gjë që ka të bëjë me ishullin tonë, duke na shpëtuar nga telashet e punëve tona të brendshme. A ka gjë më të këndshme e më të dëshirueshme se kur punët e shtëpisë sate i drejtojnë të tjerët? Ju vërtet na i zhdukët shumë nga djemtë tanë, por ama na sollët demokracinë tuaj. Prandaj ju premtojmë me gjithë zemër se do të përpiqemi t'ua shpërblejmë ushtarëve tuaj, me të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtat ndjenja, gjithçka keni bërë e po bëni ju dhe ata për ne!



QEVERISJA E ROBOTËVE

Që shkenca e robotëve ka ecur shumë përpara, kjo as që mund të vihet në dyshim. Megjithatë deri më sot as që më kishte shkuar ndër mend se këta mekanizma automatikë, të lindur gjash-tëdhjetë vjet më parë, do të ftohen një ditë të luajnë rol në jetën politike e shoqërore. Po ja që disa gazeta perëndimore kanë filluar ta shtrojnë çështjen e pjesëmarrjes së robotëve edhe në sferat e politikës. Disa krerë sindikalistë japonezë dhe amerikanë kanë kërkuar t'i futin robotët në sindikata dhe t'u marrin kuota anëtarësie!

Duke u nisur nga këto arsyetime, mund të arrihet në përfundimin se nuk është e largët koha kur robotët do të paraqiten si një mundësi e shkëlqyeshme në zgjidhjen e shumë problemeve politike që e brejnë botën e sotme, sidomos për

krijimin apo zëvendësimin e qeverive, parlamenteve, partive politike, krerëve sindikalistë, pa përmendur mundësinë e zhvillimit me tri ndërresa të bisedimeve për çarmatimin.

Në disa vende, për shembull, nuk i gjendet karari formimit dhe shformimit të qeverive: në mëngjës formohen, në mbrëmje shpërndahen. Njerëzit bien të flenë me qeveri socialdemokrate dhe gdhihen me qeveri demokrato-sociale. Përdorimi i robotëve do t'i japë fund kësaj anomalie, pasi çështjen kaq të vështirë se ku duhet vënë mbiemri cilësor *demokrat* — përpara apo pas, do ta zgjidhin aty për aty.

Trusti kombëtar që merret me heqjen e vënien e qeverive paraqit një kërkesë në shoqërinë shumë-kombëshe të prodhimit të robotëve, të cilën shkurt e thërresin «shoqëria e teto CIA-s». Këtu çdo porosi pritet me një gatishmëri shembullore.

— Sa kryeministra ju duhen?

— Një!

— Pse vetëm një?

— Tani për tani vetëm një qeveri do të krijojmë.

— Po t'i merrni me shumicë, jua japim më lirë. Merrni një duzinë kryeministrash dhe dhjetë duzina ministrash. Tridhjetë për qind zbritje. I prodhojmë bashkë me programet përkatëse të qeverive të tyre të ardhshme.

— Ku t'i çojmë të gjithë ata?

— I vendosni në një raft diku në korridoret e parlamentit dhe pastaj i hiqni ose i vini sa herë të paraqitet nevoja.

— Po ne duam qeveri të përbëra prej partive të ndryshme, jo qeveri njëngjyreshe, si robotët tuaj, — thotë përfaqësuesi i trustit kombëtar që merret me ngjyrosjen e qeverive.

— Këtë ne e kemi gjithnjë parasysh, — përgjigjet përfaqësuesi i shoqërisë shumëkombëshe që merret me prodhimin e robotëve. — Krijesat tona shquhen jo vetëm për disiplinë të lartë, por edhe për ndjeshmëri të po asaj shkalle ndaj ngjyrave. Ne ato i lyejmë me ngjyrat e partive ku do bëjnë pjesë. E dëshironi qeverinë me ngjyrë të murrme, të verdhë, krejt të zezë, jeshile, apo bjonde? Gjithçka me komandë elektromagnetike! Në qoftë se dëshironi të formoni një qeveri të qendrës së djathtë (pra, as krejt të qendrës, as krejt të djathtë), mjafton të forcohet pakëz ngjyra e zezë (natyrisht, në përmasa të arsyeshme). Po qe se e dëshironi qeveri të qendrës së majtë (natyrisht, me një anim fare të lehtë nga e djathta), atëherë është e qartë se do t'u jepet më shumë vend robotëve përkatësisht me ngjyrë të verdhë e jeshile. Si të dëshironi.

— Po opozita? A mund të ketë qeveri pa opozitë?

— Për këtë mos u shqetësoni, zotëri. Shkenca e robotëve i parashikon të gjitha. Robotët tanë dinë edhe të grinden midis tyre, ata zotërojnë, deri në perfeksion, të gjitha fjalët fyese, madje ata dinë të godasin edhe me grushte, aq sa në këto raste është mirë të mos u ndodhesh pranë.

— Mos vallë kjo do të thotë se ata mund të dalin edhe jashtë kontrollit tonë?

— Ju keni polici, apo jo?

— Policinë e kemi të përgatitur vetëm për ndeshje me qeniet e gjalla, si për shembull me demonstruesit në rrugë, ndërsa me krijesat metalike...

— Atëherë merrni një çelës trefazësh. Ndërsa rrini në verandën e vilës personale në një vend klimatik, kryeministrat, bashkë me minis-

trat e tyre, do t'u binden me përpikmëri lëvizjeve të gishtërinjve tuaj.

— Po në qoftë se qëllon të prishet mekanizmi dhe ata, për një çast, nuk u binden lëvizjeve?

— Ne prodhojmë edhe robotë rezervë. Si rregull ata quhen robotë — kolonelë ose robotë — gjeneralë. Ata mbahen në një vend të veçantë dhe nxirren në skenë sa herë është e nevojshme për të vendosur rregull.

— Shpeshherë na lind nevoja për të krijuar parti të reja politike. Mund të na ndihmoni në këtë fushë?

— O, ne kemi degë të posaçme që merren vetëm me plotësimin e kërkesave të kësaj natyre. E pse të dalësh për të mbledhur nënshkrime, kur mund të porositësh një mijë robotë, tamam aq sa duhen për të krijuar partinë e re politike? Ndonjëherë të duhen vetëm pesëqind votë për të fituar ndaj partisë kundërshtarë. Pritni një faturre në agjencinë e trustit tonë dhe fitoren e keni në xhep...

Natyrisht, hëpërhë kjo lloj tregtie nuk bëhet në një formë kaq të thjeshtëzuar. Por kam besim të plotë se së shpejti krizat qeveritare do të mekanizohen plotësisht, për t'i lënë vend më të gjerë zhvillimit të krizave të tjera, siç janë papunësia dhe inflacioni.

AMERIKA E NËNDHESHME

Në katakombet e Nju-Jorkut, në nëntokën e «Park-Avenysë» dhe të hotelit ultraluksoz «Uolldorf-Astoria», jetojnë koloni të tëra njerëzish pa strehë e pa punë dhe në kushte të papërfytyrueshme. Ata flenë midis kolonave të betonit, mbi gazeta e kartona, ushqehen me mbeturina dhe lëmosha, midis mirave, pluhurit, baltës dhe pa dritë...

(Nga shtypi)

Zoti president i SHBA!

Ju njoftojmë se ne jetojmë pikërisht nën këmbët tuaja. Kjo s'do të thotë se ne e bëjmë këtë nga respekti i madh që kemi për ju, por sepse kështu qenka e thënë në këtë Amerikën tonë: njerëzit rrinë mbi kokat e njëri-tjetrit.

Fytyrën tuaj ne s'e kemi parë kurrë dhe emrin jua ngatërrojmë (Ford, Karter, Regan, apo ndonjë tjetër), sepse ato gazeta që na bien në dorë, janë gjithmonë të grisura, ndërsa televizorin nuk e shohim asnjëherë. Ju mund të pyesni si është e mundur që bashkatdhetarët tuaj, që jetojnë në qytetin me gratacielat më të lartë në botë, nuk paskan parë fytyrën e presidentit të tyre, të paktën në televizor. Kjo për disa arsye: së pari, s'kemi tela për të bërë instalime; së dyti, s'kemi as llamba e as çelësa; së treti, s'kemi televizorë; së katërti, s'kemi as energji elektrike; së pesti... ne s'kemi shtëpi.


Neve, ndonëse jetojmë pikërisht nën këmbët tuaja, na duket se jemi aq larg jush, sa e ndiejmë veten në polin tjetër të globit. Ato dhjetëra metra që na ndajnë nga grataçielat tuaj janë aq të gjata e të papërshkueshme, sa ç'janë të largëta e të porealizueshme premtimet që bëni në fjali-met tuaja të shpeshta.

Ne do të dëshironim t'ju ftonim të zbritnit njëherë edhe në këto tunelet tona, po s'guxojmë, pasi kemi frikë se ju kafshojnë minjtë! Shpesh ata janë aq të papërmabajtur, sa mund të hanë edhe një president të tërë, qoftë ai edhe i Shteteve të Bashkuara të Amerikës! Janë të çuditshëm këta minjtë, mister president! Na kanë thënë se ndonjëherë minjtë vishen edhe me çizme, me borsalina e me frak dhe ulen në kolltukët e atij kongresi që thuhet se ju keni krijuar atje në botën tuaj. Në qoftë se është kështu, atëherë mund t'ju themi se edhe në këtë botë ku jetojmë ne, minjtë thërresin kongreset e tyre. Dhe veç të shikoni se ç'bëhet në këto raste! Asgjë mangët nuk i lënë atij kongresit tuaj.

Mos kujtoni se letra jonë synon të nxitë bujarinë tuaj për të na dhënë ndonjë ndihmë financiare, teknologjike apo ushtarake! Ne s'kemi as ministër financash, as ministër Thesari, as banka që të merren me administrimin e kredive dhe përqindjet e huave tuaja, as uzina për të instaluar teknologjinë tuaj, bile ne s'kemi as baza ushtarake në vendet e huaja, ku mund të dërgonim ndihmën tuaj në raketa e aeroplanë. E gjitha ajo që kërkojmë ne nga ju, është të na dërgoni një delegacion shkencëtarësh, nga ata që punojnë për perfeksionimin e armëve bakteriologjike në Pentagon. E bëjmë këtë kërkesë sepse duam të japim edhe kontributin tonë në sigurimin kom-

bëtar, për të cilin kemi marrë vesh se jeni shumë të preokupuar. Shkencëtarët tuaj do të zbulojnë te ne dy gjëra tepër të dobishme: E para, ata do të habiten me faunën tepër të larmishme të mjediseve tona — kërmij të madhësive fantastike, pleshta të të gjitha llojeve, akrepë të të gjitha zonave gjeografike, insekte të vogla që mund të shihen vetëm me mikroskop, por që janë mjaft aktivë. Me siguri e gjithë kjo ushtri është e gatshme të vihet në shërbimin tuaj dhe s'keni përse të shpenzoni kot për ndërtimin e inkubatorëve. E dyta, përveç aftësive dhe varieteteve të ushtarëve të posaçëm të luftës bakteriologjike, shkencëtarët e Pentagonit do të mësojnë këtu te ne fakte të panjohura deri tani për rezistencën e njeriut ndaj urisë. Përvoja jonë mund të jetë tepër e dobishme, sepse, dukë e përhapur atë në shkallë kombëtare, me siguri do të mund të kursehen shumë fonde, për të cilat ka tepër nevojë Pentagoni. Ne ju sigurojmë se marshimet e të uriturve, që herë pas here vërshojnë në Uashington, s'janë veçse shëtitje turistike, në krahasim me marshimin e urisë në tunelet tona, që gjenden pikërisht nën këmbët tuaja.

Hëpërhë ne vetëm kaq mund të ndihmojmë për rritjen e mëtejshme të fondeve për Pentagonin, për të cilin thuhet se gjithashtu ka uri të madhe.



NE KËRKIM TË USHTRISË SË VDEKUR

— Si do t'ua bëjmë atyre eshtrave, Kuk? — pyeti Bob Fisheri, bashkëpunëtor i Shtëpisë së Bardhë, kolegun e tij, Danil Kuding.

— Eshtrat, kur dhembin, kurohen, Bob, — u përgjigj Kuku me ironi.

— Ti tallësh, i dashur, po mua dhe ty ato na kërkohen.

— Unë s'kam ndër mend t'ia jap eshtrat e mia kurrkujt, koleg. Ti, po të duash, jepi të tuat.

— Lëri ato, Kuk. Si do t'ia bëjmë në të ardhmen? Tani për tani na kërkohet të sjellim eshtra vetëm nga Vietnami, nesër apo pasnesër do të na kërkohet të sjellim eshtra nga Salvadori, Somalia apo Libani. Ec e gjej pastaj se cilat janë të amerikanëve dhe cilat të ushtrive të tjera!

— Lidhur me të ardhmen kam ndër mend të bëj një propozim konkret. Pranë çdo njësie ushtarake të krijohen skuadra të posaçme për mbledhjen e eshtrave. Ato do të merren vetëm me paketimin e të vrarëve, bash në vendin e ngjarjes.

— Po kur nuk arrijnë ta bëjnë këtë? Në Vietnam, për shembull, kjo s'që e mundur të bëhej.

— Po nuk arritën të marrin amerikanë të vrarë, le të marrin të tjerë, mjafton që të përputhen shifrat. Të vrarët kudo njëjloj janë.

— Bukur fort! Ti dashke të na krijosh probleme të reja, të na përziësh kockat e të bardhëve me kockat e zezakëve e të mulatëve...

Ndërsa dy bashkëpunëtorët e Shtëpisë së Bardhë bënin këtë bisedë intime, shefi i tyre, presidenti Regan, po përgatiste fjalimin e tij të tretë për televizionin. Në këtë fjalim ai, midis të tjerave tha se i jepte «përpjesësimin» më të lartë në shkallë kombëtare kthimit të eshtrave të ushtarëve amerikanë të vrarë në Vietnam.»

Ky fjalim i presidentit, ndryshe nga shumë të tjerë të tij, nuk mbeti jashtë vëmendjes. Thuhet se të nesërmen, në adresë të Reganit, u nis kjo letër:

Ju shkruan nëna e ushtarit amerikan Lorens Did, që është vrarë në Vietnam dhjetë vjet më parë. Kur dëgjova fjalimin tuaj, mbeta e shtangur e sa s'më ra pika. M'u shfaq Lorensi, të cilin e përcolla një mëngjes, dymbëdhjetë vjet më parë, dhe nuk m'u kthye më. Ai nuk u kthye as i vdekur, si shumë moshatarë të tij. Tani, pas kaq vitesh, ju thoni se Lorensi im qenka bërë problem kombëtar në shkallën më të lartë. Është e tepërt të them se kujdesi Juaj për Lorensin tim është shumë prekës... Por një gjë mbetet e paqartë për ne. Nga njëra anë thoni se dëshironi të mblidhni eshtrat e të vrarëve, nga

ana tjetër dërgoni të gjallët të lënë kockat ku-
shedi se ku. Djalin e vetëm që më ka mbetur,
Robertin, ju doni të ma dërgoni, me ato korpuset
tuaja të ndërhyrjes së shpejtë, në një vend af-
rikan. Tani ai është zhdukur nga shtëpia, për të
mos pasur fatin e të vëllait, dhe unë jam plotë-
sisht dakord me këtë ikje. Ju, me siguri, do ta
akuzoni familjen tonë për mungesë patriotizmi,
pasi dërgimin e ushtarëve në vendet e huaja e
kërkokan nderi dhe lavdia e Amerikës. Megjithatë
në kokën time tashmë kanë lindur shumë
pyetje: Pse toka amerikane nuk ka vend për
eshtrat e bijve të saj? Pse ne harxhojmë para
për t'i sjellë bijtë tanë në atdhe vetëm pas vdek-
jes dhe nuk harxhojmë asgjë për t'u krijuar ven-
de pune e për t'i mbajtur të gjallë në vendlindjen
e tyre? A është e udhës që presidenti ynë ta käl-
lojë kohën duke gërmuar varre nëpër botë?

PËRVOJA E SENATORIT KUK

Disa parlamentarë socialdemokratë evropianë shkuan në Shtetet e Bashkuara për të përfituar nga përvoja e kolegëve të tyre amerikanë në organizimin e fushatave elektorale. Ata zhvilluan këtë bisedë me senatorin Kuk:

— Zoti senator, është e vërtetë se gjatë zgjedhjeve ju jeni të detyruar të harxhoni një sasi të madhe dollarësh nga fondet personale?

— Për fat të keq kjo është e vërtetë. Secili nga ne është i detyruar që gjatë zgjedhjeve të harxhojë edhe ata pak dollarë që i ka grumbulluar me aq mundime.

— Çfarë motivesh e shtyjnë një senator të bëjë sakrifica të tilla?

— Dashuria për votat, desh të them, për zgjedhjet e lira.

— Ka mundësi të na tregoni diçka konkrete?

— Posi. Çdo senator amerikan, si mesatare, harxhon, nga kursimet e veta, një milion e gjysmë dollarë vetëm për vota.

— Kjo është mesatarja, po rekordin kush e mban?

— Rekordi i takon senatorit Bill Klement. Ai i varfri harxhoi dymbëdhjetë milionë e gjysmë dollarë për t'u zgjedhur për herë të dytë në senat.

—Kaq shumë e donte senatin senatori Klement?

— Ai donte të tregonte se është njeriu që i vlerëson zgjedhjet më shumë se kushdo tjetër.

— Dhe ia arriti?

— Pothuajse.

— Si ta kuptojmë?

— Sepse rekordi i tij vlen vetëm për senatorët e gjallë.

— Pse, ka senatorë të vdekur?!

— Dërisa ka të gjallë, ka edhe të vdekur, zotërinj.

Biseda u duk se hyri në qorrsovak. Mysafirët nga Evropa, ndonëse kishin parë shumë gjëra në vendet e tyre, senatorë të vdekur nuk kishin parë.

— Kjo është e pabesueshme, — tha njëri nga parlamentarët socialdemokratë evropianë.

— Ju keni ardhur në vendin më të lirë të botës, ku liria e zgjedhjeve nuk u mohohet as të vdekurve. — u përgjigj senatori amerikan Kuk. — Unë ju flas me fakte. Të gjithë e dinë se senatori i Teksasit, Xhon Uillson, ka vdekur tre vjet më parë, e megjithatë atje u organizua fushata e tij elektorale dhe ai u zgjodh përsëri në senat.

— E dinin zgjedhësit një gjë të tillë?! — pyeti me habi një parlamentar.

— E dinin dhe 66 për qind e tyre i dhanë votat e veta për Xhon Uillsonin.

— Kjo duket pak si e çuditshme!

— Asgjë për t'u habitur. të nderuar kolegë, — u përgjigj senatori amerikan Kuk, — kjo është fare e thjeshtë. Në moshën 79-vjeçare senatori Uillson e pa të arsyeshme të vdiste, po nuk e pa të arsyeshme të lironte karrigen në senat. Për këtë ai nuk la pas vetëm dëshirën për t'u rizgje-

dhur, por edhe mjetet e tjera të domosdoshme: njëzet milionë dollarë për organizatorët e fushatës së tij elektorale. A mund të hidhet poshtë një kërkesë që mbështetet nga njëzet milionë dollarë?

— Përvojë tepër interesante. Interesante do të qe të bisedonim me zgjedhësit, — thanë delegatët nga Evropa.

Dhe, sapo zbritën në Teksas, ata vendosën të bisedonin drejt për drejt me atë që quhet zgjedhësi i rrugës, një gazetashitës me kapelë kashete e pantallona të bardha. Ai tha se e quanin Donald dhe emrin e senatorit Xhon Uillson e kishte lexuar në të gjitha faqet e para të gazetave. Kur e pyetën se si pranoi të votonte për Uillsonin, ai u përgjigj:

— Me një kënaqësi të madhe.

— Për një të vdekur?

— Po, sër.

— Si është e mundur?

— Sepse çdo senator i vdekur është më i mirë se çdo senator i gjallë, sër. Ju, senatorë jeni?

NESËR DO T'JU PYES PËR SALVADORIN

— Vini re! Unë do të përmend fakte të shkëputura nga mësimet e kaluara, — u tha mësuesi i gjeografisë Dik Simens nxënësve të tij, — ndërsa ju do të përgjigjeni shkurt dhe, natyrisht, me radhë. Ja, për shembull: është një vend që shtrihet në pjesën më të ngushtë midis dy oqeanëve, Atlantik dhe të Qetë. Si quhet dhe çfarë e dallon atë nga vendet e tjera?

— Me leje!

— Fol, Tom!

— Ai vend quhet Panama dhe ka një kanal të madh lundruar që e përshkon mes për mes.

— Nuk është e saktë, zoti mësues! — hidhet nxënësi Kolner Bim, — Panamaja nuk ka kanal. Gazetat tona thonë se kanali i atjeshëm është kanal amerikan.

— Ulu, Kolner! Tomi ka të drejtë, Panamaja ka kanal.

— Atëherë pse ushtarët amerikanë rrinë atje në kanal? — pyet një tjetër.

— Edhe unë mendoj se ajo që thotë Kolneri nuk është e drejtë. Ushtarët nuk rrinë brenda në kanal, siç thotë ai, zotëri, — ndërhyjnë nxënësi Palmer Xhim, — unë e di, ushtarët amerikanë rrinë afër kanalit, po jo brenda në të.

— Po pse rrinë ata afër kanalit dhe nuk futen brenda? — dëgjohej një zë.

— Rinë sepse u pëlqen kanali, — shpjegon mësuesi

— Ua! Edhe kanalin e duan, edhe në kanal nuk futen! — thërret nxënësja Xhina.

— Dëgjoni këtu! — ndërhyt mësuesi Piter. — Unë shoh se për sot ju jeni përgatitur mirë. Po ta vazhdojmë dialogun më tej, ka rrezik që ne të dalim nga gjeografia e të futemi në politikë, pra të hyjmë në territorin e Shtëpisë së Bardhë! Më kuptoni?

— Pse, dhe Shtëpia e bardhë e dashka kanalin? Ç'ka ajo me kanalet? — dëgjohen disa zëra njeherësh.

— Ajo në përgjithësi i do shumë kanalet, — shpjegon mësuesi.

— Edhe ato të ujërave të zeza? — pyet Palmar Xhimi, në mes të ilaritetit të të gjithëve.

— Si të paraqitet rasti, — shpjegon mësuesi. — Nesër do t'ju pyes për Salvadorin. Kujdes!

KUSH E HËNGRI HISTORINË?

— Mama, mama! Hani më ka ngrënë historinë! — thirri Beti nëntëvjeçare që nga kuzhina, kur pa vëllanë e vogël që po mblaçiste copa letre.

E ëma rendi me vrap që nga dhoma e gjumit për të parë se çfarë kishte ndodhur.

— Po ai ka ngrënë tri fletë të tëra! — shpjegoi Beti, duke shfletuar me nxitim librin e historisë.

— Cilat fletë ka ngrënë?

— Disa nga ato që flasin për vitet gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë.

— Çfarë përmbanin ato?

— Vietnamin dhe ca vende të tjera aty rrotull.

— S'ka gjë, mos u shqetëso për to, — i tha e ëma.

— Si s'ka gjë? Ku t'i gjej ato, po të më pyesë mësuesi, çfarë t'i them?

— Nuk të pyet mësuesi, bija ime, nuk të pyet. E di mësuesi se çfarë duhet pyetur dhe çfarë jo.

— Mësuesi di vetëm të pyesë e të vërë nota.

— Mësuesi e di se ato fletë nuk i ka ngrënë Hani. Hani do të ketë ngrënë fletë të bardha.

— Si, fletë të bardha?! Ato më mungojnë, ja...

— Fletët që të mungojnë, nuk do t'i kenë vënë fare në libër, Beti, më kupton?

— Po vitet gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë ku janë?

— Ato kanë ikur, Beti, s'është nevoja të jenë aty. Kur të rritesh edhe ca, do ta kuptosh pse nuk i kanë vënë në librin e historisë. Ne tani jemi në vitet tetëdhjetë, ju nuk duhet të merreni me të kaluarën, Beti. Ta thashë një herë: kur të rritesh, do ta kuptosh.

— Po unë e pashë që i hëngri Hani, mama, — nguli këmbë vajza.

— Hani ka ngrënë tjetër letër, prandaj bindu që ato nuk i ka ngrënë Hani, po historiani dhe Regani.

— E pse e há historinë Regani?


— Këshfu ai harron Vietnamin, që të merret me Libanin.

FYERJA E BEGELIT

Zotërinj gjyqtarë! Para së gjithash dua të them këtu së klienti im i nderuar Menahem Begin e ndien veten mjaft të fyer e të rënduar për të gjitha ato që u thanë në aktakuzë. Me të vërtetë ai ka kryesuar një qeveri, e cila gjatë ekzistencës së saj ka kryer disa inkursione (këtu u tha agresione, por kjo duhet parë nëse duhen cilësuar kështu) kundër territoreve arabe, ku janë vrarë (të paktën kështu u tha në aktakuzë) disa dhjetëra mijëra veta, por të gjitha këto janë bërë në emër të një qëllimi të madh: për të krijuar hapësirën jetike (nuk e di përse kjo hapësirë këtu u quajti perandori), që përshkruhet në vetë biblën e shenjtë. Unë nuk e kuptoj, zotërinj, se si mund të cilësohet krim ecja sipas shkrimeve të shenjta. Ju e dëgjuat vetë të akuzuarin kur u betua disa herë në emër të biblës, bile citoi faqe të tëra. Besoni, zotërinj se ai është një fetar aq i mirë e i devotshëm, sa e mban biblën edhe nën jastëk. Ju e akuzoni atë për terrorist. Unë mendoj se kjo pikë nuk duhet prekur fare, pasi, po të merret parasysh ky kapitull, kam frikë se të gjitha postet e larta në qeverinë e Izraelit do të mbeteshin bosh. Ne nuk duhet të lëmë një vend të tërë pa qeveri, zotërinj!

Këtu u tha se klienti im paska dhënë urdhër

personalisht për vrasjen e më shumë se një mijë fëmijëve, grave dhe pleqve në kampet palestineze Shaba e Shatila, në Liban. Po, zotërinj, kjo është e vërtetë, por duhet mbajtur parasysh se ai nuk do ta kishte dhënë këtë urdhër sikur të mos ishte në postin e kryeministrit të Izraelit. Të gjithë e dinë se të jesh në atë post nuk ke si u shmangesh urdhrave të tilla. Këtë e vërteton e gjithë historia e këtij shteti. Dua t'ju kujtoj të nderuar gjykatës, se edhe paraardhësit e klientit tim kanë dhënë shoeshherë urdhëra si ky që përmendet në aktakuzë, po s'u dënuan nga gjyqi. Atëherë, përse ky qëndrim për klientin tim Begin? Drejtësia duhet guarderi në fund. Jo dikush gradohet e një tjetër dënohet. A janë në dijeni zotërinjtë gjyqtarë se Shamiri, kryeministri i tanishëm, ka qenë shok i ngushtë me klientin tim të nderuar Begin? Ata, që në rini kanë bërë pjesë në të njëjtën organizatë të fshehtë, që merrej me gjuetinë e arabëve. Si është e mundur të dënohet Begini e të gradohet Shamiri? Si është e mundur të dënohet klienti im, në një kohë kur të gjithë bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë janë të lirë dhe në poste të larta? Si është e mundur që trupi gjykues të mos i vërë re këto gjëra? Kjo nuk shkon, zotërinj. Gjykojeni vetë!



A DO TA SULMOJNË MARSIANËT TOKENË?

Planeti i parë që do të hyjë në projektet e specialistëve e të komisioneve që merren me çarmatimin do të jetë Marsi. Kjo vjen jo vetëm sepse ai është fqinji ynë më i afërt, por edhe për shkak se vetë emri i tij u kujton njerëzve luftën. Ta marrësh, hollë-hollë, buzë liqenit të Gjenevës është pjekur tashmë mendimi se, po nuk u përfshi edhe Marsi në planet e çarmatimit, është krejt e kotë të shtrohet kjo çështje këtu në Tokë.

Si rrjedhim, detyra e ardhshme e të gjithë atyre që rrinë të mbledhur në Konferencën e Çarmatimit në Gjenevë do të jetë sqarimi i çështjeve të mëposhtme: Sa ushtarë ka planeti Mars dhe si janë të armatosur ata, përse marsianët harxhojnë qindra miliardë për armatimin dhe cilat janë planet e shtabit të përgjithshëm të Marsit? A përbëjnë ato ndonjë rrezik për Tokën? Të sqarohen deri në fund: 1) Qëllimet e vërteta të banorëve të atjeshëm dhe mundësitë për të sulmuar Tokën; 2) Nëse kanë raketë balistike, llojet e tyre, pushtet ku i kanë fshehur

mbushjet bërthamore dhe nga i kanë drejtuar;
3) Tipat e aeroplanëve e të flotave detare, kapaciteti i aeroplanmbartësve, llojet e nëndetësve, në cilat dete patrullojnë më shumë dhe a u afrohen brigjeve dhe ujërave territoriale të planetëve të tjerë fqinjë.

Gjatë vëzhgimeve me satelitë është vënë re se në Mars ka disa njolla të errëta, që herë duken e herë zhduken. A janë ato baza ushtarake dhe, po qe se janë, të mësohet cili është misioni i tyre. A kanë marsianët baza ushtarake në planetët e tjerë dhe përse i kanë ato? A janë ndarë marsianët në pakte ushtarake kundërshtarë? Të bëhen hetime të hollësishme nëse ka ekuilibër forcash e mjetesh midis këtyre paketeve, apo ndonjëra nga palët ka disa armë më pak se pala tjetër. Kjo çështje e fundit ka rëndësi të dorës së parë, pasi, po qe se nuk ka ekuilibër armësh, ai duhet vendosur menjëherë. Të pyeten marsianët nëse duan t'u dërgojmë armë që nga Toka, me qëllim që të bisedojmë nga pozita të barabarta me njëri-tjetrin, si edhe me partnerët në Afërditë, Merkur e planetë të tjerë. T'u bëhet e qartë banorëve të Marsit se këtu në Tokë do të gjejnë mirëkuptim të plotë në përpjekjet e tyre për paqen e çarmatimin dhe do t'u plotësohen të gjitha nevojat me armë e me këshilltarë ushtarakë. Misioni i përhershëm i atyre të Konferencës së Gjenevës, që mundin, djersën dhe dietat ia kanë kushtuar çështjes së çarmatimit, do të jetë, edhe në të ardhmen, gjetja e një vendi apo tregu ku të hidhen të gj-

tha armët e vjetra. Në qoftë se banorët e Mar-
sit bien dakord me një propozim të tillë, atë-
herë do të bëhet menjëherë propozimi për t'i
pranuar ata si pjesëtarë të botës së tretë këtu
në Tokë.

[The following text is extremely faint and illegible due to low contrast and scan quality. It appears to be a continuation of the document's content.]

MIDIS ANEKDOTËS DHE REALITETIT

Te njëri prej kandidatëve për president paraqitet avokati Xhejms Boll, një njeri i shkathët e plot fantazi, dhe i ofron atij ndihmën e vet për zgjedhjet e ardhshme, natyrisht, në shkëmbim të një posti të lartë në kabinetin e ri.

— Kjo do të varet nga aftësitë tuaja, — përgjigjet kandidati për president.

— Jam gati t'i nënshtrohem çdo prove! — bie dakord avokati.

— Atëherë, fillojmë! Javën e ardhshme ti do të mbledhësh të paktën një mijë veta në një miting paraelektoral.

— Punë që bëhet! — pranon Xhejmsi dhe me të vërtetë në ditën e caktuar ai mbledhi jo një, po dy mijë veta.

— Shumë mirë, bravo! — e përgëzon kandidati. — Prova e parë kaloi me sukses të plotë. Po në qoftë se unë do t'ju kërkoj të mbledhni tre mijë veta, a mund ta bëni?

Presidenti i ardhshëm kryqëzon duart dhe i hedh avokatit një vështrim pyetës.

Të pasnesërmen, në njërin nga sheshet e qytetit u mbledhën jo më pak se tre mijë veta, të cilët thërritnin me sa fuqi kishin. Kandidati për president mbetet i mahnitur. Njeriu që kishte marrë në provë kishte një forcë magjike.

— Po, — tha ai, — ti je pikërisht ai që më duhesh. Unë do të të marr ndihmësin tim të parë, por kam edhe një kërkesë të fundit. Kësaj pyetjeje ti duhet t'i përgjigjesh sinqerisht.

— Urdhëroni, sër! Do t'ju flas fare hapur.

— Dua të më tregosh sekretin e suksesit tënd. Unë vetë, për shembull, nuk arrij të grumbulloj as çerekun e tyre.

— O, kjo është fare e thjeshtë, zotëri, Unë vetëm bëj njoftimin se në sheshin e qytetit do të organizohet një miting kundër jush dhe që të gjithë mbliidhen menjëherë!

Deri këtu kemi të bëjmë me një anekdotë, po realiteti amerikan e kapërcen edhe vetë anekdotën.

Ndërsa avokati Xhejms Boll përdor marifete të shkathëta, për nxjerrjen e njerëzve në miting, ka të tjerë që i nxjerrin votuesit edhe nga nëntoka. Gjatë dueleve paraelektorale, që zhvillohen sa në një qoshe në tjetrën të SHBA, disa gazeta të shtetit Virxhinia Perëndimore shkruajnë me respekt për njëfarë Piter Xhois, i cili vazhdon të marrë pjesë gjallërisht në fushatat e zgjedhjeve, edhe pse ka nëntë vjet që ka vdekur!

Plaku Piter, që jetonte në qarkun Mingo, një ditë prej ditësh i la lamtumirën kësaj bote. Po megjithatë ndjenjën e detyrës qytetare nuk e braktisi. Edhe pse i vdekur, ai mori pjesë tri herë në votime dhe me siguri nuk do të harrojë të votojë edhe në të ardhmen! Dhe është për t'u lavdëruar se plaku Piter gjatë kësaj kohe, në kundërshtim me kohën kur ishte gjallë, asnjëherë nuk ka treguar as lëkundjen më të vogël politike dhe ka votuar gjithmonë për të njëjtën parti. Gjithashtu, prej asaj dite ai nuk

ka marrë pjesë në asnjë demonstratë, nuk ka bezdisur zyrat e të papunëve... Me pak fjalë, ai vazhdon të jetë një qytetar i rregullt e tepër i bindur.

Për fatin e mirë të kombit amerikan, patriotë të tillë, të cilët e shtrijnë dorën që nga thellësia e varrit për të votuar për kandidatët e partive të ndryshme, nuk janë të pakët. Sipas llogarive të gazetarëve, gjatë zgjedhjeve të fundit në qarkun elektorale Mingo votues të tillë të bindur e të pafjalë, si Piteri qenë jo më pak se shtatëmbëdhjetë mijë. Një varrezë e tërë me përmasa gjigante!

Janë të gjitha shanset që numri i kësaj kategorie votuesish shembullorë të vazhdojë të rritet.



LEDI STERLINA

Veshjet e tyre ndryshonin: dikush me rroba të verdha, dikush me kostum plot vizatime të ngatërruara e me portrete kontësh, mbretërisht, princash e presidentësh me mjekra e rendigota, ose me figura ushtarakësh me fytyra të ngrysurë e me helmëta.

Salla ku ata qenë mbledhur ishte thujse krejt prej xhami. Drita e fortë që vinte përmes pasqyrave nxirrte në pah zbehjen e ngjyrave të kostumeve e të figurave. Rrobat dalëboje dhe fytyrat e zverdhura ishin shenja të pagabueshme të sëmundjes aq të përhapur me emrin *zhvlef-tësimus*, një epidemi kjo që prek edhe fronet, edhe qeveritë. Në dritën verbuese fytyrat e princërve, të kontëve, mbretërve e presidentëve merrnin pamje transparente e të lëkundur, ata anonin nga frynte era.

— Me leje? — dëgjohet një zë i hollë e i mekur në fundin e sallës së madhe prej xhami.

— Kush flet atje?

— Jam unë.

— Kush je ti, se nuk të shohim.

— Jam unë... Lireta.

— Ngrehu në këmbë! Çfarë do?

— S'çohem dot. Kam frikë.

— Edhe këtu ke frikë?

— Është kohë shumë e keqe e kam frikë se më merr era. Oh, s'duroj më, më jepni dorën se po fundosem!

— Se mos vetëm ti! Rri aty se s'ta kemi ngenë. Kush e do fjalën?

Aty nga mesi i sallës u ngrit një dorë e cun guar. Dora kishte vetëm një gisht dhe i përngjante më shumë një skeleti.

— Thoni emrin më parë, — thirri dikush nga ata të presidiumit të mbledhjes.

— Si s'më njihni, more të pafytyrë! — u zemërua dora me një gisht. — Dikur mua më keni njohur shumë mirë, ndërsa tani s'më njihni! Si u harruaka kaq shpejt ledi me emrin Stërlinë?

— O, ju qenkeni, ledi! — dëgjohej disa zëra njëherësh. — Na falni, ledi, po ju pse nuk çoheni t'ju shohin të tjerët?

Ledi Stërlina mbledhi të gjitha fuqitë që i kishin mbetur dhe u çua. Ajo u lëkund disa herë dhe pastaj mori pozë. Sytë e të gjithëve u përqendruan sidomos në minifundin e saj të qethur e të shkurtuar deri ku s'mban më. Dikush qeshte të tjerë ulnin sytë për të mos e parë atë skenë, ndërsa ledi Stërlina rrinte midis tyre si një manekin i harruar, në vitrinën e një rrobaqepësie.

— Ulu, ulu, se të panë! — u dëgjuan disa zëra të dyshimtë.

— Kush flet ashtu?! — pyeti ai që drejtonte mbledhjen.

— Unë foli! — u çua një zotëri i pispillosur që u prezantua me emrin Frank.

Ai fliste me një ton që shumëkujt iu duk i guximshëm.

— Mos, u mbani kaq i madh, mësje Frank, — tha ledi Stërlina, gjithashtu me ton ironik prej kokete. — Ti ke guxim të na flasësh këtu jo si Frank, po si Napolon. Pa na thuaj njëherë, çfarë ndodhi, me ty? Në mos gabohem, edhe ti nuk i shpëtove dot asaj epidemisë së tmerrshme me emrin *zhvleftësimus*. Apo jo?

Mësje Franku vari veshët, më saktë, njërin vesh, sepse veshin tjetër ia kishin prerë me kohë, dhe u ul pa e zgjatur më tej. Kush guxon t'i zgjatë llafet me një ledi që del në publik pothuajse e zhveshur fare?

— Herr president! Ju flet Marka. Më lejoni të bëj vetëm një pyetje.

Ajo që po fliste tani kishte një pamje imponozante dhe në kokë mbante një helmetë.

— Këtu të gjithë janë të lirë të flasin, por jo të ankohen. Neve na duhen rrugëdalje e jo pyetje, frau Markë, — tha kryetari i mbledhjes.

— Më parë një pyetje, herr president. Unë vetëm desha të di se kush sundon këtu.

— Ç'doni të thoni ju me këtë? — u hodh kryetari i mbledhjes.

— Dua të them se në këtë stanin tonë s'ka as rregull, as disiplinë dhe secili përpiket t'i nxjerrë gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve, megjithëse që të gjithëve u digjen duart.

— Më qartë, më qartë, frau Markë!

Kësaj radhe foli zotëria më i rëndësishëm në sallë, mister Dollari. Kostumi i tij që i thjeshtë. Një palë pantallona të gjera në fornë thesi, që i vareshin nga qafa deri te këmbët. Pa pritur përgjigje për vërejtjen e tij, mister Dollari u hodh në sulm frontal:

— Qaramanë, ja çfarë jeni ju të gjithë! Asnjëri s'tha një fjalë të mirë, të gjithë derdhën lot, të gjithëve ju qenkan prerë gjunjët e veshët, të gjithë qenkeni në buzë të greminës! Jeni mësuar t'ju mbaj unë dhe tani që mua më kanë mbuluar hallet, pyesni se kush sundon këtu. Unë sundoj këtu, unë dhe asnjë tjetër! S'kam vdekur akoma, more sharlatanë! Mezi paskeni pritur të më dridhen këmbët dhe secili përpiqet të bëjë bisht sa andej-këndej. Tani që jua kam nevojën, të gjithë qenkeni në hall, të gjithë doni të dilni nga vatha ime. Ah, të kisha një grusht sa një mal dhe...

Mister Dollarit iu ngjir zëri, gjë që paralajmëronte krizën astmatike. Grushti i mbeti përpjetë, në një pozë të ngrirë. Dikush vrapoi t'i sillte ujë, por në sallë plasi kacafytja. Secili përpiqej ta ngrinte zërin më lart se të tjerët, po që të gjithë ishin të ngjirur dhe merrnin frymë me vështirësi.

PËRSHTYPJET E PARA

Menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale në Amerikë, korrespondentët u shpërndanë nëpër rrugë për të mësuar përshtypjet e publikut të gjerë. Korrespondenti i «Nju-Jork Tajmsit» ndaloi, në fillim, një shofer taksie:

— Si e vlerësoni ju, si njeri i thjeshtë, presidentin Regan?

— Për mua s'ka asnjë vlerë.

— Sidoqoftë, ju duhet të na thoni diçka, sepse ai tani është presidenti juaj.

— Me gjithë qejf, zotëri, por mua nuk më lejon gruaja të merrem me presidentët.

— Ne çdo përgjigje e paguajmë me dy dollare, kështu që edhe ajo do të jetë dakord.

— Në asnjë mënyrë. Ju thashë se gruaja ma ka ndaluar kategorikisht të merrem me presidentët, sepse, thotë ajo, shoqëria e keqe të prish.

Pas kësaj, korrespondenti iu drejtua një personi tjetër.

— Profesionit?

— Unë jam, si të thuash, thyes bankash; jo prej atyre që kanë emër botëror. I zakonshëm, pa diplomë.

— Si e pritët rizgjedhjen e Reganit?

— Kjo rizgjedhje më ka vënë në dilemë.

— Keni frikë për të ardhmen tuaj?

— Jo, por kjo rizgjedhje ma ka lëkundur mendimin për ta ndryshuar profesionin.

— Çfarë mendoni të bëheni?

— Të hidhem në politikë. Të vë kandidaturën për në kongres ose senat.

— Pse hezitoni, atëherë?

— Të them të drejtën nuk dua ta njollos veten, po, meqë jep më shumë para...

Pak më tutje gazetari u ndesh ballë për ballë me një plak që kishte vënë në kokë një kapelë të sajuar me gazetën «Nju-Jork Tajms».

— Si ju quajnë?

— Tomi Xhef.

— Ku banoni?

— Në Bronks të Nju-Jorkut.

— Aha, banor i rajoneve të varfra. Pikërisht ai që më duhet. Çfarë do t'i kërkonit presidentit Regan me rastin e rizgjedhjes së tij?

— Unë do të dëshiroja që presidenti, me rastin e rizgjedhjes, t'ua ndryshonte emrin rajoneve tona dhe t'i quante ato Izrael apo Salvador.

— Pse?

— Sepse vetëm kështu qeveria do të mendonte edhe për ekzistencën tonë.

Intervistën tjetër korrespondenti i «Nju-Jork Tajmsit» ia mori mësueses në shkollën fillore, Xhoana Kokut.

— Çfarë u thatë nxënësve tuaj kur morët vesh rizgjedhjen e Reganit?

— Të nesërmen në mëngjes unë e hapa orën e mësimit me këto fjalë: «Sot, fërijë të dashur, në do të mësojmë së bashku se si plotësohet anketa e të papunit».

Për ta plotësuar më mirë anketën e tij, korrespondenti u lidh me telefon me ish-profesorin e Universitetit të Xhorxhias, zotin Bërd.

ZBULIMI MË I RRALLË NË BOTË

Unë jam tifozja numër një e Reganit

Margaret Theçer

Meqë është fjala për një dashuri që shkon deri në tifo, ajo në asnjë mënyrë nuk mund të mbetej pa përgjigje! Prandaj nga bregu tjetër i oqeanit erdhi kjo letër plot mirënjohje:

E shtrenjta ledi Margaret!

Është e tepërt të them se fjalët tuaja të zjarrta vijnë si një rreze drite në fundin e një tuneli të errët. Në një botë mosmirënjohëse si kjo jona, ku të gjithë akuzojnë Amerikën për ndërhyrje, u gjend më në fund një zemër bujare që tha: «Amerikanët të mos vijnë si turistë, por të vijnë e të ngulen këtu në Angli.» Sa do të më pëlqente t'i dëgjoja këto fjalë edhe në Nikaragua, në Grenada, në Liban, në Japoni, në Gjirin Persik apo në ato vende të Evropës ku ushtarët tanë kanë shkuar për të mbrojtur kufijtë e lirisë sonë amerikne! O, sikur të kishte kontinenti i vjetër dhe nja njëzet apo tridhjetë ledi si ju! Ja ku po e përsërit edhe një herë para jush, e shtrenjta Margaret: Ne amerikanët jemi gati të luftojmë deri në evropianin e fundit, mjafton që të triumfojnë qëllimet tona! Ju thatë se Britania ishte vendi i parë që pranoi raketat amerikane dhe se ajo luajti rolin e dashit, pas të cilit erdhi kopeja. Unë këtë e kam ditur edhe më parë, por


fjalët tuaja të zemrës, e dashur ledi, sikur ma shlyen atë përshtypje të keqe që më patën krijuar ato demonstratat e mërzitshme e pambarim atje në Grinhem-Komen e gjetkë, kundër vendosjes së raketave tona. E çfarë vlere kanë tani, në fund të fundit, protestat e turmave pa emër e pa numër para asaj që deklaroni ju? Aq më tepër kur shpreheni hapur se jeni tifozja ime. Ata që s'jua duan të mirën kanë shkruar në shtypin anglez se ju jeni manarja ime. Natyrisht, ata mund të thonë ç'të duan, por miqësinë tonë nuk e prishin dot. O perëndi! Tashmë edhe unë kam tifozët e mi, dhe jo të çfarëdoshëm, po një ledi të vërtetë si ju! Kjo më shtyn që, në shenjë mirënjohjeje të pakufishme, t'i propozoj kongresit tonë ta përqafojë Ishullin Britanik një herë e mirë dhe ta përfshijë atë në federatën tonë amerikane si shteti i 51-të. Jo, zonjë, nuk ka përse të më falënderoni, këtë unë e bëj me gjithë dëshirë dhe vetëm për të mirën e Anglisë. Zemërgjerësia duhet shpërblyer me zemërgjerësi. Unë e di se amerikanët në ishullin tuaj plot trazira do të kenë disa vështirësi. por do të bëjmë si do të bëjmë. Ne nuk do të kursehemi. Si fillim do t'ju dërgojmë për guvernator të Londrës një senator mjaft të talentuar, Bob Kenedin, ndërsa në krye të ushtrisë suaj do të vëmë njërin prej gjeneralëve tanë më të shquar, që është mbuluar me lavdi në Luftën Vjetnameze. Dikush këtu te ne ka thënë se Anglia është si ajo gamilja që i ka mbetur koka në vrimën e gardhit atje në Irlandë dhe nuk mund të ecë përpara e as të kthehet prapa. Ne amerikanët nuk do të kursehemi për t'ju dhënë gjithë përvojën tonë të fituar në Indokinë edhe në këtë çështje. Historia tregon se në këto raste ndodh njëra nga të dyja: ose fiton, ose humbet. Unë jam

i bindur se me ndihmën e gjeneralëve tanë ju ose do ta fitoni, ose do ta humbisni këtë luftë, që është edhe jona.

Kështu pra, e dashur ledi, mirupafshim në kongresin amerikan, ku ne do t'ju bëjmë një pritje entuziaste, si përfaqësuesja numër një e provincës, desha të them e shtetit tonë të 51-të».

Para disa kohe një satirik anglez kishte parashikuar se zbulimi gjeografik më i rrallë i këtij shekulli do të bëhej atë ditë, kur marinarët do të hasnin një copë tokë në Oqean, banorët e të cilët të kishin shkruar në muret e shtëpive të tyre parrullën: «Amerikanë, rriini këtu!». Në qoftë se ky ishull do të zbulohet ndonjëherë, thoshte satiriku, ai do të shpallet menjëherë si vend pelegrinazhi.

Pas këtyre deklaratave të zonjës Theçer, duket se ky zbulim tashmë është bërë, veçse jo në oqean, por diku në Evropë. Natyrisht ky ishull nuk është Anglia, por një copë hapësirë brenda mureve të pallatit ku jeton ledi Theçer.



256218
10 18
70
72

NJË INCIDENT DIPLOMATIK

Kryeministri i Mafonisë, zoti Lulu, e kishte zakon të jepte shpesh pritje për diplomatët e huaj dhe gjithmonë ishte i preokupuar që ato të kalonin sa më mirë dhe të gjithë të ftuarit mbe-teshin të kënaqur.

Në pritjen me rastin e festës kombëtare kryeministri Lulu vuri re se njëri nga ambasadorët e ftuar po rrinte i mërzitur. Ai iu afrua atij dhe e pyeti:

— Nuk po më dukeni i gëzuar, zoti ambasador Dobris. Me se mund t'ju shërbejmë?

— Nuk e fsheh, zoti kryeministër, — u përgjigj ambasadori, — me të vërtetë jam pak i mërzitur, sepse gjatë kësaj pritjeje më humbi ora e flori-rit që e kisha kujtim nga martesa e parë.

— Ky është një incident i hidhur diplomatik, zoti Dobris. Po më vjen shumë keq që kjo ndodh pikërisht në festën tonë kombëtare. Dyshoni për ndonjë person këtu rreth jush?

— Më vjen zor ta them, po mua më duket se sahatin ma mori nga xhepi ai zotëria atje në qoshe, me kostum me kuadrate dhe me smoking.

— Ai është ministri im i Drejtësisë, — tha kryeministri.

— Atëherë më falni, ju lutem. Paskam gabuar, shkëlqesi, me siguri është një keqkuptim, — u shfaqësua ambasadori.

— Sidoqoftë, ne do të takohemi edhe një herë gjatë kësaj mbrëmjeje, zoti ambasador, — tha kryeministri dhe u largua.

Pas pak shkëlqesia e tij, zoti Lulu, kthehet me një sahat në dorë.

— Është ora juaj kjo? — pyeti ai ambasadorin Dobris.

— Kjo është një mrekulli, zoti kryeministër, kjo tregon se në shtetin tuaj nuk humbet as maja e gjilpërës dhe se ju keni një organizim të përkryer. Veçse, ju lutem, për kuriozitet, si e gjetët?

— Dyshimi juaj që i drejtë, zoti ambasador. Ju ma dhatë adresën të saktë.

— E çfarë tha ministri i Drejtësisë?

— E çfarë të thoshte? Ai nuk e kuptoi fare kur ia nxora nga xhepi.



BRavo, XHORXH!

Sekretari amerikan i shtetit për punët e jashtme, Xhorxh Shulc, tha se nuk i kujtohej një president tjetër amerikan si Regni, i cili të pajtohej me mendimin e të tjerëve dhe të mos i mbetej hatri kur e kundërshtojë. Dikush e pyeti zotin Shulc nëse dëshironte të përmendte ndonjë rast konkret nga përvoja e tij.

— Po, ja, — tregoi Shulci, — një ditë presidenti më tha: «Ne duhet t'i pakësojmë taksat, qoftë edhe duke vënë në pikëpyetje të ardhmen e Amerikës». Unë iu përgjigja: «Jo, në asnjë mënyrë, jo!». Presidenti më rrahu krahët, megjithëse unë, siç e shikoni, e kundërshtova me ton të vendosur. Dëshironi t'ju sjell raste të tjera?

— Me gjithë qejf do t'ju dëgjonim.

— Para se të nisesha për një turne në Evropë presidenti më thirri e më tha: «Dëgjo këtu! Kam mendimin se popullariteti im në Evropë ka rënë si rezultat i vendosjes së raketave amerikane atje, prandaj...». Unë e ndërpreva menjëherë: «Jo, i thashë, në asnjë mënyrë nuk jam dakord me mendimin tuaj. Në Evropë ju duan të gjithë». «Bravo, Xhorxh, — m'u përgjigj, — me gjithë kundërshtimin që më bën, ti e meriton të jesh përsëri sekretar shteti i kabinetit tim.» Unë kam edhe raste më intime, zotërinj, — tha Shulci. — Ndërsa po hanim mëngjesin në klubin e shtypit, presidenti m'u afrua dhe më tha në vesh: «Me siguri edhe ti je dakord me mua se gruaja ime, Nensi, e tepron ca me konferencat e shtypit dhe me mendimet që jep për qëndrimet e Amerikës ndaj aleatëve të vet». «Në asnjë mënyrë jo, — e kundërshtova unë. — Unë s'jam dakord me ju. Nensi është një politikane e hollë».

— Dhe presidenti nuk u nxeh nga ky kundërshtim juaji?

— Ai më vështroi me lot në sy dhe më tha: «Xhorxh, ti je më i madhi sekretar i shtetit që ka pasur ndonjëherë Amerika.»

DREJTËSIA NË TREKËMBËSH

*Intervistë me ministrin e Drejtësisë dhe të Bur-
gjeve të Afrikës së Jugut.*

Pyetje: Në njërin nga fjalimet tuaja keni thënë se Afrika e Jugut mund të krenohet me zbatimin e drejtësisë në vendin e saj. A mund të na thoni diçka konkrete, sa për ilustrim?

Përgjigje: Para së gjithash, unë mund të them se ne kemi zënë vendin e parë në botë në disa drejtime. Këtë e vërtetojmë me shifra dhe me shembuj mjaft emocionues. Vetëm në njërin nga burgjet e Pretorias, në çdo tri ditë, varet një njeri, natyrisht, zezak. Sipas shifrave, pothuajse gjysma e dënimeve me vdekje në botë zbatohen te ne, në Republikën Jugafrikane. Ju besoj se më kuptoni, që të zësh një vend të tillë, nuk është shaka, sepse, së pari, ne i respektojmë ligjet dhe rregullat, dhe nuk lejojmë që me ligjet tona të bëhet shaka dhe, së dyti, jemi të durueshëm, sepse ne kemi mundësi të varim në trekëmbësh një njeri në ditë, por, sikurse lartpërmenda, ne varim vetëm një herë në tri ditë. A nuk vërteton kjo zemërgjerësinë tonë?

Intervistë me ministrin e Arsimit

Pyetje: Zoti ministër! Kohët e fundit janë dëgjuar zëra për rritjen e numrit të të rinjve zezakë

në shkollat e mesme. Sa të vërtetë janë këta zëra?

Përgjigje: Për fat të keq, zërat kanë një bazë reale. Rritja është tepër e ndjeshme. Për shembull, në çdo njëqind mijë të rinj zezakë mbarojnë shkollën e mesme plot trembëdhjetë veta. Ju e dini se numri trembëdhjetë është një numër ters dhe, në qoftë se ecet me këto ritme, do të vijë një ditë që të kemi një superprodhim intelektual në popullsinë zezake. Pasojat e këtij superprodhimi nuk është nevoja t'i numëroj, sepse vetëkuptohen.

Pyetje: Si mendoni ta frenoni këtë përparim, ta zbritni këtë shifër kaq të lartë, që arrin numrin trembëdhjetë?

Përgjigje: Para së gjithash, me taksën shkollore. Kjo është më demokratike se çdo masë tjetër. Ne kemi marrë një vendim që, të rinjtë afrikanë duhet të paguajnë për shkollën një taksë disa herë më të lartë sesa të ardhurat mujore të një familjeje afrikane. Ndoshta kjo do t'i bëjë njerëzit të mendojnë para se të shkojnë në shkollë. Pastaj ne këtu jemi, mund ta shtojmë përsëri atë, derisa të vënë mend.

Pyetje: Ju personalisht, keni deklaruar se për arsimimin e zezakëve, udhëhiqeni thjesht nga qëllime humanitare. Si mund ta kuptojmë këtë?

Përgjigje: Fare thjesht. Shkencërisht është vërtetuar se njohuritë u sjellin njerëzve (sidomos zezakëve) një numër pasojash negative. Sidomos qëndrimi për një kohë të gjatë në bankat e shkollës, shkakton edhe shtrembërimin e shtyllës kurrizore, edhe keqësimin e pamjes. Ja pra, se ku qëndron edhe thelbi humanitar i masave tona kufizuese.

Intervistë me një shef policie.

Pyetje: Ku e çoni këtë grua zezake të lidhur me pranga?

Përgjigje: Po e heqim nga shtëpia e saj me teneqe e katrama dhe po e çojmë në një shtëpi prej guri.

Pyetje: Po ajo pse nuk dëshiron të shkojë në shtëpinë ku e çoni ju?

Përgjigje: Afrikanët janë një popull i pagdhendur. Nuk e kuptojnë rëndësinë e përparimit. Asaj i pëlqen më shumë shtëpia e saj prej katramaje, sesa godinat tona të siguruara me roja e me tela me gjemba. Ne kemi për detyrë t'u tregojmë atyre qytetërimin tonë. Por ja që nuk e kuptojnë!

Intervistë me një bizensmen amerikan

Pyetje: Ku banoni?

Përgjigje: Në Çikago.

Pyetje: Që kur keni ardhur në Johannesburg?

Përgjigje: Çfarë Johannesburgu? A nuk i thonë Çikago këtu? Këtu edhe uzina, edhe tabelat e dyqaneve janë amerikanë, ndërsa ju më thoni Johannesburg!

Pyetje: Siç duket, ju i ngatërroni këto dy qytete, sepse...

Përgjigje: Ngatërresën e bëni ju, zotëri. Mua këtu më duket vetja tamam në Amerikë, apo s'është kështu?

Pyetje: Po në Port-Elisabet keni qenë ndonjëherë?

Përgjigje: Kam qenë.

Pyetje: Si ju është dukur?

Përgjigje: Detroiti vetë. Bile në fillim m'u krijua përshtypja se isha me të vërtetë në Detroit. Atje mora në telefon byronë e adresave dhe kërkova gjyshen time që jeton në Detroit.

Ky Port-Elisabet ngjan si dy letra bixhozi me Detroitin: po ato firma amerikane, po ato automobilë...

Pyetje: Kjo do të thotë se biznesmenët amerikanë e duan shumë Afrikën e Jugut. Cilat janë arsyet e kësaj dashurie?

Përgjigje: Arsyet janë dy: njëra e ka ngjyre të zezë, tjetra të artë. Arsyeya me ngjyrë të zezë janë zezakët e këtushëm, që na kushtojnë shumë më lirë se zezakët tanë në Amerikë; edhe arsyeya me ngjyrë të artë, gjithashtu, rrjedh nga arsyeya me ngjyrë të zezë, sepse nga i njëjti kapital i investuar këtu rrjedhin më shumë fitime në formën e ajrit të verdhë.

Pyetje: Si e vlerësoni sistemin e aparteidit?

Përgjigje: Për sa u përket fitimeve, nuk e shoh të arsyeshme të jap shpjegime të tjera.

BARAZI KOZMIKE

Meqenëse këtu në planetin Tokë problemet që kanë të bëjnë me përhapjen e bazave ushtarake dhe çarmatimin janë zgjidhur një herë e mirë, dy superfuqitë kanë vendosur të merren tani me bazat ushtarake dhe çarmatimin në planetët e tjerë të hapësirës kozmike. Bisedimet e ardhshme për këto probleme, shtypi amerikan dhe sovjetik i ka pagëzuar me një emër mjaft poetik: lufta e yjeve.

Disa hollësira rreth perspektivave inkurajuese për kozmosin në vitet që vijnë mund të na i japë zëdhënësi i Pentagonit, gjenerali me katër yje, zoti Spiks.

Pyetjes se si e parashikon fazën e parë të bisedimeve, që fillojnë së shpejti, zoti Spiks iu përgjigj pak a shumë me këto fjalë:

Në fillim do të krijojmë disa komisione me përfaqësues të të dyja palëve. Komisionet do të krijojnë nënkomisione me specialistë të armëve të ndryshme, të cilët do të saktësojnë numrin e raketave, të satelitëve dhe platformave që ndodhen aktualisht në orbitë, tipat e tyre, madhësinë, armatimin që mund të mbajnë e të tjera çështje të kësaj natyre.

— Po në qoftë se këto shifra nuk rezultojnë të barabarta për të dyja palët?

— Atëherë pala që ka më pak armë e sate-

litë do ta shtojë numrin e tyre, në mënyrë që të krijohet ekuilibri i forcave.

— Sa kohë do t'ju duhet të merreni vesh për këtë?

— Kjo do të mund të arrihet aty nga fundi i fazës së parë të bisedimeve.

— Po në fazën e dytë?

— Faza e dytë parashikohet të jetë shumë me e rëndësishme se e para. Në këtë fazë të dyja palët do të përpiqen të zhdukin padrejtësinë që u bëhet planetëve të tjerë në raport me Tokën. Ne jemi për barazi kozmike. Detyra jonë është të mos bëjmë dallime midis planetëve, të mos u mohojmë atyre atë, që ia lejojmë Tokës sonë, sepse kjo do të ishte një padrejtësi ndërplanetare. Edhe në qoftë se këtu në Tokë mund të lejohet ndonjë padrejtësi e vogël, padrejtësitë në përmasa ndërplanetare janë krejtësisht të palejueshme. Në një kohë, kur në planetin tonë armët janë përhapur edhe në qoshet më të humbura, si është e mundur t'u mohohet kjo e drejtë planetëve vëllezër të sistemit tonë diellor?

Zoti Spiks ka jo vetëm fantazi kozmike por edhe plane konkrete.

— Së shpejti, — tha ai, — ne do të krijojmë komandën e përbashkët të forcave ushtarake të hapësirës kozmike, e cila do të ketë edhe detyrën e ndërlikohjes me planetët e tjerë.

Kur u pyet nëse janë bërë hapa në këtë drejtim, zoti Spiks tha:

— Para ca kohe ne hymë në lidhje radiofonike me banorët e fqinjit tonë më të afërt, Marsit, dhe u propozuam një traktat të ndihmës reciproke, ku të parashikohet furnizimi me skafandra të blinduara, tanke, aeroplanë dhe artileri bregdetare.

— Keni marrë ndonjë përgjigje për këto propozime?

— Që prej asaj dite, ndërlidhja është prerë dhe nga ana e tyre nuk jepet asnjë sinjal. Ne tani po përpiqemi të rivendosim kontaktet me ta. Për këtë qëllim do të hidhen një sërë raketash për të krijuar një platformë metalike në orbitën e Marsit.

— Deri tani ju folët vetëm për armatimin e kozmosit, — i thamë zotit Spiks, — ndërsa bisedimet e ardhshme thuhet se kanë për qëllim çarmatimin, apo jo?

— Këtë vërejtje naive na e kanë bërë edhe të tjerë. E si është e mundur të bëhet çarmatimi i kozmosit në një kohë kur ende nuk është kryer armatimi i tij?

Me siguri zoti Spiks do ta kishte vazhduar monologun e tij rreth çarmatimit përmes armatimit, por atë e thirrën me urgjencë, pasi në ekranet e llokatorëve ishin dukur disa njolla të errëta, që vërtetohnin se pala kundërshtarë kishin të provuar një armë të re që prishte ekuilibrin e forcave. Gjithçka duhej filluar nga e para!



DOSJA PERSONALE E SHEKSPIRIT

Komisioni i censurës së letërsisë klasike në Teksas të SHBA thirri në raport pedagogët e universitetit dhe zhvilloi me ta këtë bisedë:

— Kemi marrë vesh se nëpër shkollat tona lëviz poshtë e lart njëfarë Shekspiri. E njihni ju këtë person?

— Ai është anglez, zotërinj. Shkrimtar dramaturg.

— Që është anglez, e dimë, po çfarë anglezi? Jeton këtu në Amerikë, apo vjen herë pas here si emigrant?

— Ai ka vdekur zotërinj. Po të jetonte tani, do të ishte të paktën katërqind vjeç.

— Oho, i lashtë qenka! E pse e lexojnë fëmijët tanë këtë Shekspirin katërqindvjeçar? Mos vallë është komunist?

— Nuk besojmë të ketë qenë komunist. Të paktën kështu na duket neve. Historia thotë se emri komunist nuk njihej në kohën e tij.

— Shumë mirë që s'njihej. Ashtu duhet, të mos njihet. Po çfarë shkruan ai?

— Drama, komedi.

— Domethënë ai shkruan edhe komedi? Nuk na thoni, kë përqesh ai me komeditë e tij?

— Kryesisht mbretërit, oborrtarët, shpërdoruesit e pushtetit.

— Kjo do të thotë se ai merret me politikë!

— Jo drejtpërdrejt.

— Atëherë në mënyrë të fshehtë! Kjo është edhe më e rrezikshme.

— Jo dhe aq fshehur, zotërinj. Për shembull, mbretërit që merrte në shenjë, ai i cilësonte me emër.

— Me siguri ai ka parasysh edhe presidentët, apo jo?

— Në kohën e tij kishte mbretër, por pa dyshim aluzion bënte edhe për presidentët.

— E qartë. Ka qenë ndonjëherë ky Shekspiri në Amerikë?

— Nuk është thënë gjë për këtë. Bile dhe datëlindja e origjina e tij janë me shumë pikëpyetje.

— Me pak fjalë gjithçka rreth tij është e dyshimtë. Datëlindjen s'ia dini, a ka qenë apo jo në Amerikë, s'e thoni dot, ndërsa ato komeditë e tij u dashka të lexohen. Sa mirë dini të bëni sehir se si qesh ai Shekspiri juaj me sovranët e kombeve.

— Zotërinj, ç'punë kemi ne me sovranët? Le t'i përqeshë!

— Ashtu thoni ju, ë? Sot qesh me mbretërit, nesër merr nëpër gojë presidentët, pasnesër vë në lojë senatorët...

— Ju garantojmë, zotërinj censorë, se ai nuk do të shkruajë më. Ka bërë ç'ka bërë deri tani, më tej nuk do ta lejojmë të shkruajë, sidomos kundër senatorëve tanë.

— Ju garantoni për këtë?

— Garantojmë se ai nuk do ta përmendë kurrë Amerikën.

— Domethënë ai e përshkruan botën pa Amerikën? Ashtu e shikon botën ai? E shikoni, zotërinj shkencëtarë, se çfarë rreziku paraqit ky Shekspiri për Amerikën? Si mund të ekzistojë bota pa Amerikën?

— Amerika sigurisht ka ekzistuar, zotërinj, po ai nuk e ka përmendur në shkrimet e veta.

— Ju e pranoni vetë se Amerika ka ekzistuar, ndërsa Shekspiri nuk e përfillte, e quante të paqenë.

— Megjithatë ai duhet ta ketë pasur parasysh edhe Amerikën, pavarësisht se nuk e ka përmendur me emër.

— Aq më keq. Kjo do të thotë se në njëfarë mënyrë ai është tallur edhe me presidentin tonë, apo jo?

— Ai mund të mos e ketë njohur fare presidentin tonë.

— E çfarë shkrimtari është ai që nuk njih presidentin amerikan? Ndërsa ju e lejoni të vërdalliset nëpër Amerikë!

— Ai s'ka ardhur vetë, zotërinj. E kanë thirrur të tjerët.

— Kush?

— Është vështirë të thuhet se kush e thirri i pari.

— Domethënë shkenca jonë del përsëri e pa fuqishme për t'i përcaktuar gjërat.

— Kjo është ndoshta më e vështirë se çdo gjë tjetër.

— Megjithatë duhet të gjendet. Ne kemi teknikën më të përparuar në botë.

— Është fshehur atje ku s'e kap dot.

— Të kontrollojmë shenjat e gishtërinjve të tij në dosjen personale.

— Dosja e Shekspirit me siguri ekziston diku në zyrat e policisë sonë, po shenjat e gishtërinjve si zor të jenë aty. Katërqind vjet më parë nuk qe bërë zakon të merreshin shenjat e gishtërinjve të shkrimtarëve.

— Kjo është skandaloze. Ne mbajmë nëpër shkollat e bibliotekat tona librat e një njeriu që s'i kemi marë akoma as shenjat e gishtërinjve? Të ndalohet! Ku vemi ne kështu?

— Këtu keni shumë të drejtë, zotërinj të censurës. Me të vërtetë, ku po vemi ne kështu?

SKICA



— Xhon, kam marrë vesh se ju flisni lart e poshtë se gjoja nuk mund të jetoni me rrogën që ju jap unë. Është e vërtetë?

— Po, bos, unë kam thënë se...

— Po në qoftë se jua heq fare rrogën, a mund të jetoni?

— Jo, por...

— E keni parë veten ndonjëherë në pasqyrë?

— Çdo mëngjes. Kur rruhem.

— Dhe nuk keni vënë re se ngjyra juaj anon nga ana tjetër?

— Si mund të anojë ngjyra nga ana tjetër, zotëri?

— Për shembull, mund të anojë nga zezaku. Apo jo?

— Unë s'jam zezak, zotëri, as unë, as babai.

— Atëherë gjyshi. Mos doni të thoni se nuk jeni as mulat?

— Po kjo...

— Kjo do të thotë se ju jeni vetëm përgjysmë i bardhë.

— Unë s'ju kuptoj, zotëri.

— Pikërisht pse s'kuptoni, ju kam thirrur të bëjmë këtë bisedë të përzemërt, Xhon.

— Po ç'lidhje ka kjo me rrogën time?

— Përderisa jeni vetëm gjysmë i bardhë, vetëkuptohet, Xhon. Ju, në ato mbledhjet tuaja të punëtorëve, thoni se gjërat janë të lidhura... Apo jo?

*

* * *

Si çdo mbrëmje, kryefamiljari Xhimi Dogsi bëri kontrollin e zakonshëm. Pasi mbylli derën me shul lëshoi qenin në korridor dhe rrymën elektrike në të gjithë telat që rrethonin dritaret, pyeti:

— Të gjithë jeni prezent?

— Të gjithë, me përjashtim të gjyshes, u përgjigj djali i madh, Biteri.

— Ku është ajo?

— Gjyshja po jep shpjegime në zyrën e policisë. Ajo mbeti si e vetmja dëshmitare pas një grabitjeje në autobus.

— Po ju, si e kaluat në shkollë sot? — iu drejtua Xhimi dy djemve.

— Edhe ne mirë kaluam, por... tre banditë na detyruan të gjithë në klasën tonë të ngremë duart përpjetë dhe, si na kontrolluan, na morën ç'kishim në xhepa. Pastaj u larguan, — shpjegoi Redi i vogël.

— Dhe vetëm kaq? Po ty, Robert, të ka ndodhur gjë?

— Sot unë s'kam parë asnjë bandit.

— Kjo do të thotë se dita e sotme ka qenë e mbarë: duket sikur të gjithë jeni shëndoshë e mirë, apo jo?

— Ne harruam mamanë, — u hodh Betsi. — Ajo duhej të ishte kthyer që prej dy orësh.

— E si do të kthehet ajo? Brava e derës është me korent!

— Ju shkoni e flini, — i qetëson Xhimi dy fëmijët, — unë do të marr pistoletën me gaz dhe bulldogun e do të dal të kërkoj Rotildën. Ndofta edhe ajo kthehet shëndoshë e mirë, atëherë dita e sotme do të mbyllet me sukses.,

* * *

— Zoti president! Sipas ligjit amerikan, unë, si zgjedhës, kam paguar pesë dollarë për fushatën elektorale, pra, për zgjedhjen tuaj. Besoj se tani që u ulët në kolltukun e Shtëpisë së Bardhë kam të drejtën të kërkoj diçka nga qeveria juaj, si për shembull punë.

— Ju keni plotësisht të drejtë dhe unë do të bëj çmos që ata pesë dollarë t'jua kthej ndonjë ditë, por cdo gjë sipas radhës. Ju duhet ta dini se ka të tjerë që kanë paguar një milion dollarë për zgjedhjen time dhe ne akoma nuk i kemi plotësuar si duhet as dëshirat e tyre.

— Unë kam edhe një diplomë, zoti president. Mund të bëj një punë të kualifikuar.

— Pikërisht për punë të kualifikuar s'kemi nevojë. Po të ishit pa dije e pa kulturë, ndryshe do të ishte.

— Në qoftë se është kështu, atëherë unë jam gati ta flak diplomën dhe t'i harroj të gjitha ç'kam mësuar.

— Po ta bënit këtë, unë do të kisha mundësi t'ju ndihmoja menjëherë, por kjo s'bëhet kollaj.

— Ja, që tani, zoti president.

— O, ju lutem, Ju diplomën e keni marrë pas shumë vjet studimesh, prandaj, edhe për të harruar, do të duhen disa vjet.

— Atëherë zoti president, unë po filloj që tani

të harroj gjithçka që kam mësuar dhe, kur të vijë në kolltukun tuaj një president tjetër, ndoshta do të jem bërë i përshtatshëm për një punë çfarëdo!

— Okej!

— Unë mendoj se bomba jonë me neutron është shpikja më e madhe dhe më e leverdishme e këtij shekulli. Ajo zhdok vetëm njerëzit, ndërsa të gjitha pasuritë na i lë të paprekura.

— Edhe unë jam dakord me ty, por ama edhe ajo bomba me neutron e ka një defekt që më bën të shqetësohem.

— Defekt?!

— Po, po, defekt, dhe shumë të madh. Thuhet se ajo është bombë qorre dhe i vret të gjithë, duke përfshirë edhe sërën tonë.

— Atëherë, sipas jush, duhet të mendojmë për të shpikur një bombë tjetër, e cila, kur të pëlcasë, të vrasë vetëm grevistët, komunistët, aktivistët sindikalë dhe punëtorët emigrantë.

— Kjo do të ishte mrekullia vetë.

— Dhe ju mendoni se ajo do të jetë një bombë e përsosur?

— Pa dyshim. Ku ke parë ti një bombë që t'i zgjedhë njerëzit me kokrra dhe të jetë në gjendje të bëjë dallime midis gjithë asaj turme që i del përpara?

— Kjo do të jetë me të vërtetë e mrekullueshme, por ama edhe këtu më lind një pyetje: po të vriten të gjithë ata që përmende ti, atëherë kush do të punojë për ne?

— Me të vërtetë, ja një problem i pazgjidhur!

Avokati anglez Stiven Skot, si njohës i shkëlqyer i të gjitha vidave të drejtësisë angleze, mban një rekord të rrallë: ai ka mundur të nxjerrë të pafajshëm të gjithë klientët e tij, qofshin ata vrasës, thyes bankash ose personalitete të larta të përziera në skandale shtetërore.

Një ditë Skoti thirri në zyrë sekretaren e vet dhe e urdhëroi t'i shkruante një letër avokatit Luis Biç.

— Si ta filloj letrën, sër? — pyeti sekretarja.

— Atë po mendoj edhe unë: si t'i drejtohem... Po, shkruaj: «I nderuari sër!»

— Ç'«i nderuar» është ai, zoti Skot, — vërejti sekretarja, — ai është një mashtrues që e njeh e gjithë Londra; skandalet e mbuluara prej tij vazhdojnë të bëjnë jehonë!

— Keni të drejtë, mis, — tha Skoti, — më mirë shkruani: «I dashur koleg!»

Një fëmijë me një kapelë kashte allameksikane në kokë bridhte nëpër rrugicat e ngushta të Tel-Avivit me një tufë gazetash nën sjetull. Ai thërriste:

— Sensacion! Një ngjarje e pabesueshme! Njëzet veta të mashtruar!

Një burrë i shkuar në moshë afrohet e blen gazetën. Ai e hap atë shpejt e shpejt dhe pastaj i thërret gazetashitësit:

— Ej, ti, djalosh, këtu s'gjej asgjë nga ato që thua ti.

Mirëpo ndërkohë shitësi i gazetave ishte larguar dhe dëgjoheshin vetëm të bërtiturat e tij:

— Sensacion, sensacion! Njëzet e një veta të mashtruar!

— Ma hodhi, qerratai! — tha burri.

— Nuk jeni i vetëm, zotëri, — i përgjigjet një kalimtar, — jemi miliona që po na e hedhin!

*

* *

Ç'është ai arkivol, zoti Xhekson?

— Arkivol si të gjitha arkivolet, zoti Smith.

— Kë varrosin kështu?

— Bashkimin tonë Jugafrikan!

— S'po ju kuptoj, zoti Xhekson. Si mund të futet e gjithë republika jonë në disa arkivole?

— Keni të drejtë, zoti Smith. Ju jetoni të qetë atje në Londër dhe vini nganjëherë më të rrallë këtu në Johaneshburg. Po mos u mërzitni. Ky është një varrim simbolik dhe asgjë tjetër. Zakon i vjetër afrikan. Kështu bëjnë ata në të gjitha festat tona.

*

* *

Shefi i redaksisë së jashtme të gazetës «Nju-Jork Tajms» thërret në zyrë korrespondentin që merret me veprimtarinë e Shtëpisë së Bardhë:

— Ti ishe në konferencën e shtypit të presidentit Regan që u mbajt para një ore?

— Si urdhëron, isha!

— Ç'u tha ndonjë gjë e re?

— Asgjë.

— Mrekulli. Për numrin që del nesër na

shkruani një koment, jo më të gjatë se gjashtë apo shtatë faqe.

— Unë... ju thashë, ai nuk tha asgjë.

— Si, nuk foli fare?

— Foli, po nuk tha asgjë të re.

— Në qoftë se ai nuk tha asgjë, kjo do të thotë se nuk duhet thënë asgjë, prandaj dhe ju shkruani dhe mos thoni asgjë. E qartë?

Fshatari italian Bruno Paskuale i kërkoi borxhin që i kishte dhënë bashkëfshatarit të tij, Betino Domenikos.

— Kur të më vijë xhaxhai nga Amerika, patjetër do t'jua kthej borxhin, — iu përgjigj Domenikoja.

— Ka një vit që po m'i thoni këto fjalë, prandaj unë nuk besoj më tek asnjë xhaxha nga Amerika, — nguli këmbë Paskualja i zemëruar.

— Që të më besoni, ja, po ju tregoj letrën e tij të fundit. Na, lexojeni. Mbrëmë e mora.

— E çfarë shkruan në të?

— Më kërkon t'i dërgoj para për rrugën.

Piktori Çarl Smithi ishte në kulmin e euforisë krijuese, kur në dhomë hyri pronari i shtëpisë.

— Shikojeni, zotëri, çfarë tabloje! — i tha Smithi pronarit të shtëpisë. — Do të kalojnë edhe disa vite dhe njerëzit do të vijnë në këtë dhomë

e do të thonë: «Këtu ka punuar piktori i madh Çarl Smith».

— Këtë do ta thonë që nesër, zoti Smith, në qoftë se sot, deri në mbrëmje, ju nuk do të më paguani qiranë e dhomës! — u përgjigj pronari.

*

* * *

— Ju keni shkruar në autobiografinë tuaj se jeni i ndershëm dhe se nuk keni marrë asnjë ryshfet gjatë gjithë jetës suaj? — pyeti pronari i bankës kandidatën që ishte paraqitur për punë.

— Po! — u përgjigj kandidati dhe mezi e fshehu kënaqësinë e tij, duke menduar se po i buzëqeshte fati.

— Pra ju pohoni vetë se kjo është karakteristika juaj e vërtetë?

— Po! — përsëriti kandidati për nëpunës. — Unë jam gati t'ju sjell shumë dëshmi, që vërtetojnë se kjo është karakteristikë ime e vërtetë.

— Dhe me të tilla cilësi ju dashkeni të vini e të punoni në bankën time?!

*

* * *

— Herman, si sillen ata ushtarët amerikanë atje te ju, në Gjermani?

— Si të dehur!

— Po kur nuk janë të dehur?

— Esëll s'i kam parë ndonjëherë!

- Të mrekullueshme këto afreske, Paskuale!
- Ashtu janë vërtet, Betino, po një biznesmen amerikan mbeti i pakënaqur kur i pa.
- Pse?
- Sepse, tha ai, për t'i transportuar në Amerikë, duhet t'i marrësh me gjithë faqen e murit.

— Dhoma në spitalin tonë kushton për njëzet e katër orë 175 dollarë. Do të paguani plus për analizat dhe ilaçet. Si thoni, do të merrni edhe shtrat?

- Jo, do të fle në dysheme.
- Atëherë do të merrni vetëm dyshek?
- Jo, do të fle drejt në çimento...
- Me siguri do të ftohemi dhe...
- Kjo do të jetë në leverdinë tuaj. Do të marr plus një plevit!

— Unë gjithmonë dëgjoj të thuhet se ne portugezët jemi atlantistë, zoti Peres, por asnjëherë nuk e kam vrarë mendjen se ç'do të thotë kjo.

— Kjo do të thotë, i dashur Korvalho, se ne i përkasim oqeanit Atlantik dhe, po të dojë, oqeani na merr me vete.

— E ku na çon?

— Në bregun tjetër, në Amerikë.

— Po amerikanët i kemi këtu, ç'të vemi ne atje?

— Pikërisht sepse kanë ardhur ata këtu, ne duhet të shkojmë gjetkë.

— Xho, kush të ka rrahur e sakatosur kësh-tu?

— E pësova nga plazhi.

— E ç'punë kishte plazhi me ty?

— Në plazh u nxiva aq shumë, sa më morën për zezak!

— Më falni, ju lutem, kjo është hyrja numur 13 e Pentagonit?

— Kjo është. Nga vini ju?

— Nga Arabia Saudite.

— Aha, nga nafta. Më siguri ju dëshironi të takoni gjeneralin Tomson.

— Po, gjeneralin Tomson.

— Atë që merret me shitjen e armëve me shumicë?

— Pikërisht atë.

— Kaloni në korridorin nga e djathta: në zyrën numër një do të takoni gjeneralin Tomson që merret me kontratat deri në një milion dollarë. Në zyrën numër dy do të takoheni me gjeneralin Tomson që merret me kontratat deri në një miliard dollarë. Në zyrën numër tre do të takoheni me gjeneralin Tomson që merret me formulimin e kontratave të shitjes së armëve që arrijnë në një trilion dollarë e lart.

— Xhon, i bëre detyrat?

— Ato po bëj, baba!

— Pa më thuaj njëherë, çfarë detyrash ke sot në lëndën e ekonomisë shtëpiake?

— Sot mësuesi na dha si detyrë të harrojmë gjithçka shkruhet e flitet për çmimet dhe inflacionin.

— Shumë bukur paska menduar ai mësuesi juaj, po atë detyrë duhet të ma kishte dhënë edhe mua.

*

*

*

11. — Mëre vesh? Vdiq milioneri Dillton.

— I shkreti milioner! Kishte llogaritur të jetonte pambarim, por ja..

— Ai dinte ta kthente kohën në parë, por s'mundti t'i kthente paratë në kohë, — tha Alberti.

*

*

12. — Dugllas, kam vendosur të shkoj të mbytem, po s'mundem.

— Sigurisht s'mundesh. Kush është ai që dëshiron të mbytet?

— Mua dëshira s'më mungon, por nuk më lejojnë. Meqë unë paguaj taksë të larta, sapo ta marrin vesh mbytjen time, ata të financës do të japin menjëherë alarmin dhe do të vijnë të më shpëtojnë.

— Tani, të dashur nxënës, ju do të na tregoni se çfarë patë dje në ekspozitën e artit abstrakt. Fol ti, Hejs!

— Unë nuk kuptova gjë, zoti mësues.

— Po ti, Klark?

— As unë nuk kuptova gjë, zoti mësues.

— Debs, ti nuk e kuptove përmbajtjen e ndonjë pikturë?

— Po, zoti mësues. Unë kuptova qartë një pikturë në fund të sallës, e cila thoshte: «Dalje».

— Më gjeni një senator që nuk shitet.

— Senatorin Bulldog.

— E pse nuk shitet ai?

— Sepse e kanë blerë me kohë.

— Si shpjegohet që senatori Merf e humbet shpesh fytyrën e vet?

— Sepse ka disa të tilla.

— E ardhmja e djalit tuaj është e shkëlqyer.

— Po ai është pa punë.

— Uhë flas në qoftë se do të gjente punë.

*

*

— Interesant, Uiston! Zakonisht para galerisë së arteve është qetësi e madhe, ndërsa sot njerëzit qenkan vënë në radhë.

— Me siguri, është liruar vendi i shërbyesit.

*

*

— Bill, me se po merreni këto kohët e fundit?

— Jam duke shkruar një artikull kundër realizmit socialist.

— Pse, e njihni ju realizmin socialist?

— Jo, unë njoh një kryeredaktor reviste që paguan shumë mirë për artikuj të tillë.

*

*

— Alo! Ju jeni drejtori i CIA-s?

— Unë.

— Dijeni se ju jeni kaq i urryer, sa kurrkush nuk dëshiron t'ju japë as dorën.

— As që merakosem për këtë. Shenjat e gishtërinjve tuaj i kam në kasafortat e mia.

*

*

— Tom, pse thua që Anglia është gjysmë-ishull?

— Ashtu është, sër, se gjysmën tjetër të ishullit e kanë amerikanët për baza.

— Është zbuluar një skandal i madh.

— Ku?

— Në parlament.

— Po dallaveraxhinjtë ku vajtën?

— U fshehën.

— Ku?

— Në parlament.

— E ke lexuar ndonjëherë revistën «Amerika»?

— Jo.

— Aty tregohet se sa mirë jetohet te ne, në Amerikë.

— Unë s'kam asnjë cent për ta blerë.

— Në bandën tonë pranuar edhe një ish-senator.

— Mos! Ti paske luajtur. Ai do të na vjedhë të gjithë!

— Herr Fric! Ju nuk keni frikë të ecni i vetmuar nëpër rrugët e qytetit?

— Unë asnjëherë nuk eci vetëm, herr Schmid.

Pas meje gjithmonë vëzhgojnë agjentët e policisë sekrete!

* *

— Më thoni sinqerisht: a keni shumë nevojë për ndihmën amerikane? — i pyeti ambasadori amerikan disa fshatarë të Salvadorit.

— O perëndi! Këtë vit edhe pa të ne patëm breshër e shtrëngatë, — iu përgjigjën fshatarët.

* * *

— I dashur Bill, e lexove gazetën?

— Ti e di se unë asnjëherë nuk e lexoj atë.

— Tmerr i vërtetë! Gjithë ato humbje në Olster.

— Llafë! Unë për shembull, në Olster kam një firmë që më jep vetëm fitime.

* *

— Kolonel Jezhov! Përse ushtarët tanë luftojnë aq keq në Afganistan?

— Sepse nuk e dinë qëllimin e luftës, gjeneral.

— Pse nuk ua tregoni?

— Po t'ua tregojmë, atëherë nuk do të luftojnë fare.

* * *

— Mua kjo më revoltton, — u ankohet zonja Theçer këshilltarëve të saj. — Të gjithë demonstrojnë e thonë se jemi në rrezik, por asnjëri nuk demonstroi e nuk mbledh ndihma për shpëtimin tonë.

* * *

— Ti, zakonisht nuk e lexon gazetën, Bill. Ç'të qenka tekur sot?

— Një histori mjaft interesante. Këtu shkruajnë se në grabitjen e ditëve të fundit, që u bë në bankën «Stenli e Co», përveç policëve, paskan marrë pjesë edhe kriminelë të tjerë.

* * *

— Xhejms, kam dëgjuar se statujën e Venerës së lashtësisë nuk e lanë të hynte në Nju-Jork. A është e vërtetë?

— Edhe unë ashtu kam dëgjuar.

— Vallë, cila do të jetë arsyeja?

— Ma merr mendja se kjo duhet shpjeguar me një të metë të madhe fizike të Venerës.

— Si the, paska të meta fizike Venera? Po unë kam dëgjuar se ajo është vetë përsosmëria.

— E megjithatë ajo ka një të metë të madhe fizike: është pa duar. Askush nuk e di me saktësi se ku i ka humbur.

— Ë megjithatë ajo është Venera e pazëvendësueshme, qoftë edhe pa duar...

— Ashtu thua ti, por ec e pyet policët e Byrosë Federale të Hetimeve, të cilët, po të mos kesh duar, nuk të lejojnë të hysh në Amerikë.

— Ç'u duhen duart e Venerës policëve të FBI-së?

— Në qoftëse Venera nuk ka duar, atëherë si do t'ia marrin shenjat e gishtërinjve?

* * *

— Si ju duket ky portret?

— I kujt është?

— Është portreti i bankierit Bllomberg.

— Po sikur nuk ngjan.

— E njihni ju bankierin Bllomberg?

— Jo, nuk e njoh.

— Atëherë nga e dini se portreti nuk i ngjan origjinalit?

— Dhe pyesni? Çfarë bankieri qenka ky, që i mban duart në xhepat e tij?

* * *

*Zyrës së Policisë Ndërkombëtare (interpol),
diku në Evropë!*

Kam marrë vesh se ju keni krijuar njëfarë interpoli ose polici ndërkombëtare që u marrka me zbulimin e krimeve. Unë që po ju shkruaj jam një person që kam kryer një varg krimesh që

s'kanë të numëruar. Si rezultat kam grumbulluar një sasi të madhe parash. Ju lutem, më njoftoni telegrafisht se me çfarë lloj valute i marrin ryshfetet krerët e organizatës suaj.

— Doktor! Sa kohë mund të zgjatë kurimi i sëmundjes sime?

— Kjo varet nga gjendja e kuletës suaj.

— Zotëri! Meqenëse nxitoj, a ka mundësi të më lejoni të furnizohem me benzinë para jush?

— Do t'jua plotësoja dëshirën me gjithë qejf, por kam frikë se, kur të më vijë radha, benzina do të jetë shtrenjtuar përsëri.

— Po të ishit ju kryeministër, zoti Kuk, si do t'ia shpjegonit popullit rritjen lart e më lart të çmimeve në spitale?

— Unë do t'u thosha zgjedhësve se ngritjet e vazhdueshme të çmimeve të shërbimit shëndetësor tregojnë se në vendin tonë vlerësohet gjithnjë e më shumë jeta e njeriut.

— Zonjë, si bashkëshorte e senatorit Bigs, emri i të cilit përmendet shpesh në shtypin amerikan, keni mundësi të na thoni diçka për jetën e tij personale?

— Bashkëshorti im nuk ka jetë personale: e gjithë jeta e tij i është kushtuar politikës.

— Atëherë na thoni diçka për fëmijët tuaj.

— Një djalë e kam këshilltar në ushtrinë izraelite, djalin e dytë e kam oficer në korpusin e marinës, që ka shkuar për të vendosur paqen në Liban, vëllai i burrit tim është komandant i njëjës nga bazat amerikane në Spanjë, ndërsa nipin e kam inspektor në ushtrinë amerikane në Korenë e Jugut.

— Mund të na thoni, përse burri juaj ka ardhur në Evropë?

— Ai do të zhvillojë disa leksione për mosndërhyrjen amerikane në punët e brendshme të vendeve të tjera.

*
*
*

— Me të vërtetë e pakuptueshme.

— Çfarë?

— Autobusët rrinë nëpër stacione, trenat s'luajnë nga vendi, aeroplanët s'fluturojnë, mjekët dhe infermierët nëpër spitale s'pushojnë, ndërsa radioja thotë se lëvizja s'pushon.

— Ndofta radioja e ka fjalën për lëvizjen greviste!

*
*
!

— Përse, vallë, më paguajnë si anëtar i Dhomës së Lordëve, kur unë gjatë njëzet e pesë vjetve s'kam folur asnjëherë?! — vriste mendjen lordi anglez Ashot.

— Kjo është krejt e natyrshme, — i tha atij

lordi tjetër, Endinburgu. — Në Dhomën tonë të Lordëve zbatohet parimi i njohur prej kohësh: heshtja është flori...

— S'di si të veproj, të bëhem në fillim politikan dhe pastaj akrobat, apo të bëhem më parë akrobat e pastaj politikan? — pyeti të atin djali i ish-kryeministrit të Anglisë.

— Sigurisht, më parë duhet të bëhesh akrobat, — e këshilloi i ati. — Këtë e them nga përvoja.

Profesori polak Bogosllav Danilloviçi atë ditë mbeti pa drekë. Ai u kthye vonë nga klubi, ku kishte mbajtur një leksion për ateizmin shkencor.

— Ku është Bozhena? — pyeti profesori të bijën.

— Mami nuk është kthyer akoma nga kisha, baba.

— Aha, harrova. Po ti, pse nuk na paske përgatitur ndonjë send për të ngrënë?

— Edhe unë sapo erdha. Ishim në ekskursion te varri i shën Mërisë.

— Edhe Mihaili akoma s'ka ardhur nga shkolla?

— Ai shkoi të zërë radhën për kulaçe, se nesër është nata e Zonjës së Bekuar...

Punëtori Alen Savini vendosi të siguronte me kohë djalin e porsalindur. Sapo u kthye nga zyra

e gjendjes civile, ai shkoi në zyrat e regjistrimit të të papunëve.

— Si quheni? — e pyetën.

— Debs e quajnë.

— Ku banon?

Savini tregoi adresën.

— Sa kohë ka që kërkon punë?

— Sot, për herë të parë.

— Atëherë do t'i duhet të presë! — shpjegoi nëpunësi i regjistrimit.

— S'ka gjë. Mund të presë edhe ca.

— Sa vjeç?

— Pesëditësh.

Nëpunësi hoqi syzet dhe e vështroi Alenin me habi.

— Ti pesëditësh?!!

— Jo unë, po djali im, që ka lindur pesë ditë më parë.

— Kjo nuk është zyra e gjendjes civile, po zyra që regjistron të papunët, i nderuari qytetar!

— Edhe djali im Debs për punë ka ardhur, zotëri. Derisa të rritet, ndoshta i vjen radha...



Avokati anglez Dig Xheksoni mori këtë letër nga shkolla e djalit të tij:

«Me keqardhje ju njoftojmë se djali juaj Bengu kohët e fundit ka mundur të mashtrojë disa herë mësuesit e tij. Nuk dimë nëse këtë ves ai e ka edhe në shtëpi, prandaj...».

Të nesërmen avokat Xheksoni dërgoi këtë letër në shkollë:

«Njoftimi juaj më gëzoi pa masë. Këtë punë ai ka filluar ta bëjë edhe me prindërit, madje në

mënyrë mjaft të stërholluar, thuajse profesionale. Kjo më lë të shpresoj se Bengu im do të bëhet me siguri një dëshmitar i përkryer.»

— Çfarë kishte pacienti?

— Vetëm pesëqind dollarë, — iu përgjigj doktor Kuku kolegut.

— Ju pyeta se çfarë sëmundje kishte, Kuk.

— Më vjen keq, i dashur Xhejms. Kur them pesëqind dollarë, ju e kuptoni se është fjala vetëm për një apendicit.

Lordi anglez Stonen ka vënë re se, sa herë që ngjitet në tribunën e Dhomës së Lordëve për të mbajtur fjalim, gjysma e lordëve flenë, ndërsa gjysma tjetër sapo janë çuar nga gjumi dhe drejtohen për në restorantin aty përmbri.

Megjithatë kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë se Dhoma e Lordëve i ngjan një hoteli. Në hotel paguajnë për të fjetur, në Dhomën e Lordëve paguhen për të fjetur.

Në sportelin e hotelit jugafrikan «Hollivud» bie zilja e telefonit.

— Çfarë urdhëroni?

— Ju lutem, më rezervoni një vend për nesër mbrëma.

— Duhet të vini vetë në sportel.

— E pse jo me telefon? Në reklamën e hotelit tuaj është shkruar...

— Neve nuk na duhet se çfarë është shkruar. Po nuk erdhët këtu, ne nuk kemi se si të sigurohemi që ju nuk jeni zezak

Në redaksinë e gazetës spanjolle «Periskop» vajti një letër me këtë përmbajtje: «Sapo të hapësh televizorin, të dalin përpara vrasje, të qëllura me thikë e me revole, gangsterë, grabitje, të arrestuar. Po na prishen fëmijët. A nuk mund të bëhet ndonjë gjë për të kufizuar dhunën në televizor?»

Pas disa ditësh, autori i kësaj letre, qytetari Alvares, mori këtë përgjigje përmes gazetës: «Ne e kuptojmë shqetësimin tuaj, por e vetmja mënyrë për ta kufizuar disi dhunën në televizor është të blini një aparat me ekran më të vogël, nga ato të firmës «Teksas».

— Gjatë kontrolleve që bëmë në një bazë ku fabrikohen parà false, sapo zbuluam njëqind mijë dollarë krejt të rinj, — i raporton në telefon polici, Xhoni Smithi, shefit të vet, Bidell Klimit.

— Bravo, zoti Smith, çfarë keni ndër mend të bëni me ta?

— Tani po nisem t'jua sjell juve, zoti shef.

— S'ka nevojë të vish vetë, zoti Smith. Me

një shumë aq të madhe në xhep është tepër e rrezikshme të lëvizësh nëpër qytet, ti e di.

— Atëherë, si të veproj?

— Si është cilësia e tyre? A janë tërësisht para të vërteta?

— Kopje të përpikta. Asnjë bankë nuk do të mund t'i dallojë.

— Atëherë m'i dërgo me mandapostë! — urdhëroi shefi i policisë.

Miliarderi Rokfeler bëri një vizitë nëpër vendet e Amerikës Latine dhe kudo mbajti fjalime për ndihmën që duhet të japin vendet e pasura në favor të vendeve të pazhvilluara. Një ditë, si hyri në një restorant luksoz, kamerieri shkoi menjëherë dhe u përkul para tij:

— Çfarë urdhëroni, shkëlqesi?

— Vetëm një vezë të zier! — tha Rokfeleri.

Kamerieri shprehu habi dhe nuk po largohej.

— Ju thashë, vetëm një vezë! — theksoi miliarderi me ton të prerë.

Pas pak kamerieri solli vezën e zier në një pjatë dhe e pyeti miliarderin aq kursimtar:

— Shkëlqesi! Ta derdhim ujin ku u zie veza, apo...

Miliarderi e vëshitroi me inat.

— Çfarë dëshironi të thoni me këtë?

— Asgjë, shkëlqesi. Ndoshta dëshironi t'ua dhuroni ujin ku u zie veza vendeve të varfra për fondin e ndihmës, — u përgjigj kamerieri me mirësjellje.

— Xhim! E dëgjove kryeministrin mbrëmë në Televizor?

— E dëgjova dhe e pashë, Bush.

— Ai tha se qeveria e tij nuk vepron në asnjë mënyrë nën presionin amerikan.

— Shumë mirë e tha. Ashtu është me të vërtetë.

— Edhe ti je dakord me të?

— Plotësisht dakord. Amerikanët s'kanë nevojë t'i bëjnë asnjë presion, sepse ai bën gjithçka kërkojnë amerikanët.

— Ju do të më tregoni mua të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Asgjë mos të më fshihni, — i tha avokati klientit të tij Aldo Kokut, në qelinë e burgut «Gudbaj». — Kjo është në interesin tuaj.

— Ju betohem, zoti avokat, se unë do t'ju tregoj të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, — përgjigjet i burgosuri.

— Atëherë më thuaj: është e vërtetë, ajo që thuhet në aktakuzë se ti ke vjedhur njëqind mijë dollarë?

— Betohem se nuk kam vjedhur asgjë, — përgjigjet Koku. — Gjithçka është sajuar për të mbuluar një vjedhje që e kanë bërë të tjerët.

— Atëherë unë nuk mund t'ju marr në mbrojtje, — tha avokati dhe u ngrit të ikte.

— Si?! A ka gjë më të lehtë se të mbrosh një të pafajshëm? Unë mund ta dokumentoj se nuk kam vjedhur, ju betohem, kam dhe dëshmitarë...

— Mua nuk më interesojnë as dokumentet,

as betimet tuaja, zotëri, — tha avokati. — Në qoftë se ti nuk ke vjedhur, me çfarë do të më paquash?

— Pse nuk flet, Bertold?
— Kam emocione, Brunilda.
— Çfarë ka ndodhur?
— Më në fund po realizohet ëndrra jote për të banuar në një shtëpi të kushtueshme.
— Ke gjetur ndonjë thesar?
— Thesar nuk kam gjetur, por kam lexuar gazetat. Ti nuk i lexon gazetat, Brunilda, prandaj nuk i di gjërat.

— E çfarë thonë ato gazetat?
— Ato thonë se pasnesër do të ngrihen qirrat e shtëpive edhe me një të katërtën dhe tani e tutje ne do të banojmë në një shtëpi më të kushtueshme. Natën e mirë, Brunilda.
— E çfarë nate e mirë? Mua nuk më zë gjumi.
— Pse kështu?
— Edhe unë kam emocione, Bertold. Mendoj për shtëpinë e kushtueshme!

— Henri, ti tani u rrite, ke menduar se çfarë do të bëhesh në të ardhmen?

— Kardiolog, baba!
— S'jam dakord, — tha babai, — e pse kardiolog?

— Ti vetë më ke thënë se doktorët fitojnë para të madhe.

— Kjo është e vërtetë, po pse pikërisht kardiolog e jo stomatolog? Ti tashmë e di se njeriu ka vetëm një zemër, ndërsa dhëmbë..

— Këtë nuk e kisha menduar, baba!

PËRMBAJTJE

Ministri i drejtësisë	108
Shprehja e simpatisë	12
Kongresi botëror i anekdotave	21
Përgjigjja	25
Kjo ka ndodhur në Lavira	30
Ëndërr në shkallë evropiane	35
Minjtë nën jastëk	40
Çdo ligj ka dhe përjashtime	44
Kolombi në «Tokën e re»	46
Në kabinetin e milionerit.. ..	53
Duel në ekranin blu	57
Ngjashmëria	59
Tartabiqet nën tryezë	61
Grindje në gjirin e familjes	66
Nastradini në Jerusalem	68
Litëri	72
Dita jubilarë	74
Pamje e çuditshme	77
Muzeu i figurinave prej parafine	80
Monologët e rinj	83
Mister Kuku — shitblerës idesh	86
Njëzet e pesë herë dhëndër	91
A dëshironi të jetoni?	95
Kauboj i vërtetë	98
Fshatari dhe kali	100
Traktoristë me pasaportë diplomatike	103
Pantallonat e pleshtit	106
Numri 13	109
Arti kërkon sakrificë	113
Shtrati i zonjës B	117
Prova	120

Dashuri reciproke	123
Qeverisja e robotëve	126
Amerika e nëndheshme	130
Në kërkim të ushtrisë së vdekur	133
Përvoja e senatorit Kuk	136
Nesër do t'ju pyes për Salvadorin	139
Kush e hëngri historinë?	141
Fyerja e Beginit	143
A do ta sulmojnë Marsianët Tokën?	145
Midis anekdotës dhe realitetit	148
Ledi Stërlna	151
Përshtypjet e para	155
Zbulimi më i rrallë në botë	158
Një incident diplomatik	161
Bravo, Xhorxh!	163
Drejtësia në trekëmbësh	165
Barazi kozmike	169
Dosja personale e Shekspirit	173
Skica	176

Mirrored Y

Mirrored text: Niveli i ...


Mirrored text: I ...

Mirrored text: 204 ...

Mirrored text: (R.m.) dhe

Mirrored text: (11-7-89) 883-7

M 78



De

Mirrored text: Formati 48x38 (6 3/8x4 3/4) 2204-82

Mirrored text: KOMBINATI POLIGRAFIC SHQIPTARIS

Mirrored text: Tiranë, 1982